

Albania declares Iran a state sponsor of terrorism

 intellinews.com/albania-declares-iran-a-state-sponsor-of-terrorism-432087

March 17, 2026



/ Niko Peleshi via Facebook

By bne IntelliNews March 17, 2026

Albania's parliament adopted a resolution on March 17 declaring Iran a "terrorism sponsor state", citing alleged support for armed groups and cyberattacks, in a vote boycotted by the opposition.

Ties between Tirana and Tehran have been strained for years. Albania hosts more than 2,000 Iranian dissidents from the Mujahedin-e-Khalq group, a factor widely seen as contributing to tensions. Tirana has been a firm supporter of US and Israeli action against Iran,

Lawmakers approved the measure with 79 votes in favour, none against and one abstention, during an extraordinary session convened outside the chamber's normal schedule.

The resolution, posted on Facebook by Albania's parliament, states that "credible reports and international assessments have repeatedly documented the involvement of the authorities of the Islamic Republic of Iran in the financing, training, arming and management of non-state armed groups and organisations declared as terrorist entities in some regions".

It further alleges that Iranian state institutions, including the Islamic Revolutionary Guard Corps (IRGC), have supported and coordinated "activities that destabilise countries in the Middle East and beyond".

Albanian lawmakers also pointed to cyber threats, noting that the country had been "the object of hostile actions in cyberspace, including the severe cyber attack on Albanian state institutions in 2022" as well as more recent attempts targeting parliamentary systems.

The resolution formally "declares the Islamic Republic of Iran as a Terrorism Sponsor State and as a state that uses terrorist tools in pursuit of its foreign policy objectives" and calls for stronger international coordination against what it described as state-sponsored terrorism.

It also urges the government to intensify cooperation with allies, support international accountability efforts and designate both the IRGC and Hezbollah as terrorist organisations.

Parliament speaker and Socialist MP Niko Peleshi confirmed the move, saying: "Today, at the plenary session, the Assembly of Albania adopted the Resolution 'To declare the Islamic Republic of Iran as a state sponsoring terrorism and as a state that uses terrorist tools'."

The vote was held without the participation of opposition Democratic Party lawmakers, who accused the government of breaching parliamentary rules.

Parliamentary group leader Gazment Bardhi said the opposition had decided not to attend what he called "an illegitimate session called in open contradiction to the assembly's procedure".

"This is not a normal parliamentary session, but a meeting called for the personal agenda of the prime minister and the speaker of the assembly," Bardhi wrote on Facebook, adding that the chamber had become "a decor for government propaganda".

In 2022, Albania severed diplomatic relations with Iran and expelled its diplomats following a large-scale cyberattack on government systems, which authorities attributed to Tehran. Since then, additional cyber incidents have targeted public infrastructure, including digital services and municipal systems.

The resolution noted Albania's commitments as a Nato member and candidate for European Union membership, and reaffirms its "unwavering devotion to international peace, democratic values and the protection of civilians from acts of terror".

It also calls on "democratic countries, international organisations and Albanian partners to review coordinated measures against state-sponsored terrorism and strengthen international cooperation" to address such threats.

Statement by the High Representative on behalf of the EU on the alignment of certain countries with Council Decision (CFSP) 2026/421 of 19 February 2026 amending Decision (CFSP) 2025/1577 updating the list of persons, groups and entities covered by Common Position 2001/931/CFSP on the application of specific measures to combat terrorism

On 19 February 2026, the Council adopted Decision (CFSP) 2026/421¹.

That Decision added one entity to the list of persons, groups and entities involved in terrorist acts and subject to restrictive measures under Common Position 2001/931/CFSP on the application of specific measures to combat terrorism².

Albania, Bosnia and Herzegovina, Iceland, Liechtenstein, Moldova (Republic of), Montenegro, North Macedonia, Serbia and Ukraine align themselves with this Council Decision.

They will ensure that their national policies conform to this Council Decision.

The European Union takes note of this commitment and welcomes it.

¹ OJ L, 2026/421, 19.02.2026, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2026/421/oj>

² OJ L 344, 28.12.2001, p. 93, ELI: <http://data.europa.eu/eli/compos/2001/931/oj>

Press office - General Secretariat of the Council of the EU

Rue de la Loi 175 - B-1048 BRUSSELS - Tel.: +32 (0)2 281 6319

press@consilium.europa.eu - www.consilium.europa.eu/press

REPUBLIC OF ALBANIA

PARLIAMENT

RESOLUTION

On designating the Islamic Republic of Iran as a State Sponsor of Terrorism and a State that employs terrorist means.

The Parliament of Albania,

Whereas the Republic of Albania is strongly committed to the principles of the United Nations Charter, international law, and the preservation of international peace and security;

Whereas terrorism in all its forms and manifestations constitutes one of the most serious threats to international peace, security, and democratic societies;

Whereas credible reports and international assessments have repeatedly documented the involvement of the authorities of the Islamic Republic of Iran in the financing, training, arming, and directing of non-state armed groups and organizations designated as terrorist entities in several regions;

Whereas the Islamic Republic of Iran, through its state institutions, including the Islamic Revolutionary Guard Corps (IRGC) and its affiliated structures, has supported and coordinated activities that destabilize countries in the Middle East and beyond; Given that the Republic of Albania has itself been the target of hostile actions in cyberspace, including the severe cyberattack against Albanian state institutions in 2022—attributed to structures linked to the Islamic Republic of Iran—as well as recent attempts to launch cyberattacks against the systems of the Parliament of Albania;

Given that acts of violence and aggression, including cyberattacks against state institutions, critical infrastructure, and sovereign states, constitute violations of international law and may amount to forms of terrorism;

Given that the systematic use of intimidation, armed proxy groups, and hybrid tools to spread fear and cause destabilization is incompatible with the norms of peaceful international relations;

Given that the Republic of Albania, as a NATO member and a candidate country for European Union membership, anchors its foreign and security policy in the principles of democratic solidarity, the rule of law, and the preservation of international peace and stability; Given that the Albanian people and institutions remain committed to the fight against terrorism in all its forms and to holding accountable those who sponsor or commit acts of terror;

The Parliament of Albania:

1. Condemns in the strongest terms the actions of the Government of the Islamic Republic of Iran that support, enable, or carry out acts of terrorism, hybrid operations, and destabilizing activities in various regions of the world, and expresses full solidarity with friendly countries of the Arabian Gulf and with Turkey, which have been targeted by terrorist activity sponsored by the Government of the Islamic Republic of Iran.
2. Also condemns the cyberattacks carried out against the institutions of the Republic of Albania, including the 2022 attack on state infrastructure and recent attempts to interfere with the systems of the Parliament of Albania.
3. Designates the Islamic Republic of Iran as a State Sponsor of Terrorism and as a state that employs terrorist means in pursuit of its foreign policy objectives.
4. Condemns the activities of the Islamic Revolutionary Guard Corps (IRGC) and its affiliated entities for their role in supporting terrorist organizations, proxy armed forces, and destabilizing operations.
5. Calls upon the Government of the Republic of Albania to:
 - strengthen national and international measures to combat state-sponsored terrorism and cyber threats;
 - cooperate closely with allied and partner countries in preventing and combating the financing of terrorism and activities linked to Iranian state structures;
 - support initiatives within international organizations aimed at ensuring accountability for acts of terrorism, cyber-attacks, and violations of international law;
 - immediately designate the Islamic Revolutionary Guard Corps (IRGC) as a terrorist organization;

- also designate Hezbollah as a terrorist proxy organization of the Islamic Republic of Iran, joining the United States of America, Germany, the Netherlands, a number of EU member states, and other countries that have previously adopted this designation.

6. Calls upon democratic countries, international organizations, and Albania's partners to consider coordinated measures against state-sponsored terrorism and to strengthen international cooperation in the fight against these threats.

7. Reaffirms Albania's unwavering commitment to international peace, democratic values, and the protection of civilians from acts of terror.

8. Directs that this Resolution be transmitted to the Government.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

R E Z O L U T Ë

Për shpalljen e Republikës Islamike të Iranit si Shtet Sponsor i Terrorizmit dhe Shtet që përdor mjete terroriste.

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke qenë se Republika e Shqipërisë është fuqimisht e përkushtuar ndaj parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara, të drejtës ndërkombëtare dhe mbrojtjes së paqes dhe sigurisë ndërkombëtare;

Duke qenë se terrorizmi në të gjitha format dhe shfaqjet e tij përbën një nga kërcënimet më serioze ndaj paqes ndërkombëtare, sigurisë dhe shoqërive demokratike;

Duke qenë se raporte të besueshme dhe vlerësime ndërkombëtare kanë dokumentuar në mënyrë të përsëritur përfshirjen e autoriteteve të Republikës Islamike të Iranit në financimin, trajnimin, armatosjen dhe drejtimin e grupeve dhe organizatave të armatosura jo-shtetërore të shpallura si entitete terroriste në disa rajone;

Duke qenë se Republika Islamike e Iranit, përmes institucioneve të saj shtetërore, përfshirë Gardën Revolucionare Islamike (IRGC) dhe strukturat e lidhura me të, ka mbështetur dhe koordinuar aktivitete që destabilizojnë vende në Lindjen e Mesme dhe më gjerë;

Duke qenë se Republika e Shqipërisë ka qenë vetë objekt i veprimeve armiqësore në hapësirën kibernetike, përfshirë sulmin e rëndë kibernetik ndaj institucioneve shtetërore shqiptare në vitin 2022, i atribuar strukturave të lidhura me Republikën

Islamike të Iranit, si dhe përpjekjet e ditëve të fundit për sulme kibernetike ndaj sistemeve të Kuvendit të Shqipërisë;

Duke qenë se aktet e dhunës dhe të agresionit, përfshirë sulmet kibernetike kundër institucioneve shtetërore, infrastrukturës kritike dhe shteteve sovrane përbëjnë shkelje të së drejtës ndërkombëtare dhe mund të përbëjnë forma të terrorizmit;

Duke qenë se përdorimi sistematik i frikësimit, i grupeve të armatosura proxy, si dhe i mjeteve hibride për të përhapur frikë dhe destabilizim është i papajtueshëm me normat e marrëdhënieve paqësore ndërkombëtare;

Duke qenë se Republika e Shqipërisë, si anëtare e NATO-s dhe vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, ka në themel të politikës së saj të jashtme dhe të sigurisë parimet e solidaritetit demokratik, shtetit të së drejtës dhe mbrojtjes së paqes dhe stabilitetit ndërkombëtar;

Duke qenë se populli dhe institucionet shqiptare mbeten të përkushtuara në luftën kundër terrorizmit në të gjitha format e tij dhe në mbajtjen përgjegjëse të atyre që sponsorizojnë ose kryejnë akte terrori;

Kuvendi i Shqipërisë:

1. Dënon me termat më të ashpër veprimet e Qeverisë së Republikës Islamike të Iranit që mbështesin, mundësojnë ose kryejnë akte terrorizmi, operacione hibride dhe aktivitete destabilizuese në rajone të ndryshme të botës si dhe shpreh solidaritetin e plotë me vendet mike të Gjirit **Arabik** dhe me Turqinë, të cilat janë shënjestuar nga aktiviteti terrorist i sponsorizuar nga Qeveria e Republikës Islamike të Iranit.
2. Dënon gjithashtu sulmet kibernetike të kryera kundër institucioneve të Republikës së Shqipërisë, përfshirë sulmin e vitit 2022 ndaj infrastrukturës shtetërore dhe përpjekjet e fundit për ndërhyrje në sistemet e Kuvendit të Shqipërisë.

3. Shpall Republikën Islamike të Iranit si Shtet Sponsor të Terrorizmit dhe si shtet që përdor mjete terroriste në ndjekje të objektivave të tij të politikës së jashtme.
4. Dënon aktivitetet e Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) dhe entiteteve të lidhura me të për rolin e tyre në mbështetjen e organizatave terroriste, forcave të armatosura përfaqësuese dhe operacioneve destabilizuese.
5. I bën thirrje Qeverisë së Republikës së Shqipërisë që :
 - të forcojë masat kombëtare dhe ndërkombëtare për të luftuar terrorizmin e sponsorizuar nga shtetet dhe kërcënimet kibernetike;
 - të bashkëpunojë ngushtë me vendet aleate dhe partnere në parandalimin dhe luftimin e financimit të terrorizmit dhe aktiviteteve të lidhura me strukturat shtetërore iraniane;
 - të mbështesë nismat në organizatat ndërkombëtare që synojnë përgjegjshmërinë për aktet e terrorizmit, sulmet kibernetike dhe shkeljet e së drejtës ndërkombëtare.
 - të shpallë menjëherë Gardën Revolucionare Islamike (IRGC), si organizatë terroriste,
 - të shpallë gjithashtu Hezbollah si një organizatë terroriste proxy të Republikës Islamike të Iranit, duke iu bashkuar Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Gjermanisë, Hollandës dhe një numri shtetesh anëtare të BE-së si dhe vende të tjera, të cilat e kanë ndërmarrë më parë këtë përcaktim.
6. U bën thirrje vendeve demokratike, organizatave ndërkombëtare dhe partnerëve të Shqipërisë që të shqyrtojnë masa të koordinuara kundër terrorizmit të sponsorizuar nga shtetet dhe të forcojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në luftën kundër këtyre kërcënimeve.

7. Rikonfirmon përkushtimin e palëkundur të Shqipërisë ndaj paqes ndërkombëtare, vlerave demokratike dhe mbrojtjes së civilëve nga aktet e terrorit.
8. Udhëzon që kjo Rezolutë t'i përcillet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, qeverive aleate, Organizata e Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë përkatës.



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 60

Tiranë – E mërkurë, 25 mars 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 24/2026, datë 20.2.2026	Për shërbimin e jashtëm në Republikën e Shqipërisë.....	4251
Dekret i Presidentit nr. 142, datë 17.3.2026	Për shpallje ligji.....	4269
Vendim i Kuvendit nr. 43/2026, datë 5.3.2026	Për mosmiratimin në parim të projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, ‘Për taksat kombëtare’”, i ndryshuar.....	4269
Vendim i Kuvendit nr. 44/2026, datë 5.3.2026	Për mosmiratimin në parim të projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 68/2017, ‘Për financat e vetëqeverisjes vendore’”, i ndryshuar.....	4270
Vendim i Kuvendit nr. 46/2026, datë 12.3.2026	Për kërkesën e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për dhënien e autorizimit nga Kuvendi për arrestimin/heqjen e lirisë së deputetes Belinda Balluku nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit personal.....	4270
Rezolutë e Kuvendit datë 17.3.2026	Për shpalljen e Republikës Islamike të Iranit si shtet sponsor i terrorizmit dhe shtet që përdor mjete terroriste.....	4270
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 155, datë 19.3.2026	Për emërim në detyrë.....	4272
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 156, datë 19.3.2026	Për propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të një anëtari për Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.....	4272
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 157, datë 19.3.2026	Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës për Hapje dhe Dialog.....	4272

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 158, datë 19.3.2026	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Bashkia Himarë tek Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, të pasurisë me nr. 68/119/15, e ndodhur në zonën kadastrale 1739, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 433, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, të ndryshuar.....	4274
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 159, datë 19.3.2026	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri për ekzekutimin dhe vjeljen e gjobave”.....	4278
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 160, datë 19.3.2026	Për një ndryshim në vendimin nr. 858, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	4279
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 161, datë 19.3.2026	Për përcaktimin e kriterëve dhe të masës së kompensimit të ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, kur emërohet ose komandohet në detyrë jashtë vendbanimit të tij.....	4280
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 162, datë 19.3.2026	Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2027–2029.....	4281
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 165, datë 19.3.2026	Për autorizimin e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, për rindërtimin e xhamisë në qytetin e Shijakut.....	4285
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 166, datë 19.3.2026	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave publike në fshatrat Podgorie, Sovjan, Pojan, Zëmbllak dhe Vloçisht”, Bashkia Maliq.....	4287
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 167, datë 19.3.2026	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim i rrugës ‘Bexhet Hyti’ në zonën kadastrale 2654”, Bashkia Elbasan.....	4288
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 168, datë 19.3.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 20, datë 17.1.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Lidhja e Rrugës Transballkanike me Portin Detar Vlorë’”, të ndryshuar.....	4291
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 169, datë 19.3.2026	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikonstruktion trotuari perimetral, shkolla 9-vjeçare “Ndre Mjeda”, Bashkia Shkodër”.....	4293

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 19.3.2026	Për miratimin e rregullave të përgjithshme për programimin e inspektimeve e të metodologjisë së vlerësimit të riskut dhe përcaktimin e periudhës maksimale të inspektimeve vjetore dhe të mënyrës së llogaritjes së tyre.....	4295
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 172, datë 19.3.2026	Për disa ndryshime në vendimin nr. 457, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave për pjesëmarrje në Qendrën e Trajnimeve në Fushën e Pronësisë Industriale, si dhe përcaktimin e tarifave përkatëse dhe masën e shpërblimit të lektorëve”, të ndryshuar.....	4301
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 173, datë 19.3.2026	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të provimit të shtetit dhe provimeve të tjera të digjitalizuara.....	4301
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 174, datë 19.3.2026	Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, të periodicitetit, të metodologjisë dhe të llojeve të masave për vlerësimin e përmbushjes së kushteve dhe të kriterëve të funksionimit të instituteve dhe njësive të veçanta të kërkimit shkencor, të cilat financohen nga fonde publike	4303
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 175, datë 19.3.2026	Për përcaktimin e kategorizimit në pagë dhe shpërblimit për punën në bazë të cilësisë e të rëndësisë së rezultateve të kërkimit shkencor të personelit të instituteve dhe të njësive të veçanta të kërkimit shkencor publik.....	4305
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 185, datë 19.3.2026	Për disa ndryshime në vendimin nr. 526, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje”.....	4307
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Punëve të Brendshme dhe i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 36, datë 27.2.2026	Për përcaktimin e rregullave, trajtimit, administrimit dhe shpërndarjes së të dhënave personale të mbledhura nga policia.....	4307

**LIGJ**
Nr. 24/2026**PËR SHËRBIMIN E JASHTËM NË**
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:****KREU I**
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**Neni 1**
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim rregullimin e veprimtarisë dhe organizimin e Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Objekti

Objekt i këtij ligji janë:

- a) përcaktimi i funksioneve dhe i mënyrës së organizimit të Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë;
- b) rregullimi i marrëdhënieve të Shërbimit të Jashtëm me institucionet kushtetuese, qendrore dhe vendore, në funksion të zbatimit të politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë;
- c) procedurat e vendosjes dhe të ndërprerjes së marrëdhënieve diplomatike;
- ç) funksionimi i misioneve diplomatike dhe posteve konsullore;
- d) procedurat e emërimit të kreut të misionit diplomatik, postit konsullor, personelit të tyre dhe konsullit të nderit;
- dh) procedura e emërimit, statusi i diplomatit dhe sistemi i karrierës diplomatike;
- e) pozita juridike, ekonomike dhe sociale e anëtarëve të familjes së diplomatit.

Neni 3**Baza ligjore e funksionimit të Shërbimit të**
Jashtëm

Shërbimi i Jashtëm i Republikës së Shqipërisë e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Kushtetutën, marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, ligjin për nëpunësin civil, ligjin për shërbimin e jashtëm, si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore, të miratuara në zbatim të tyre.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Diplomat karriere” është nëpunësi civil, i cili pranohet në Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ligj dhe gëzon statusin e diplomatit të karrierës në Shërbimin e Jashtëm.
2. “Diplomat” është çdo person, i cili bëhet pjesë e Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ligj dhe gëzon statusin e diplomatit për sa kohë është pjesë e tij.
3. “Gradë diplomatike personale” është rangi që mban diplomati i karrierës në sistemin e gradave diplomatike.
4. “Gradë diplomatike/konsullore emërimi” është grada diplomatike dhe konsullore me të cilën emërohet diplomati në misionet diplomatike dhe postet konsullore.
5. “Nëpunës civil” është çdo punonjës i Shërbimit të Jashtëm, i cili gëzon statusin e nëpunësit civil, por nuk gëzon statusin e diplomatit ose diplomatit të karrierës.
6. “Ministria” është ministria përgjegjëse për punët e jashtme.
7. “Ministri” është ministri përgjegjës për punët e jashtme.
8. “Mision diplomatik” është institucioni i përfaqësimit të Republikës së Shqipërisë në shtetin pritës ose pranë një organizate ndërkombëtare.
9. “Post konsullor” është institucioni i përfaqësimit të Republikës së Shqipërisë, i cili ushtron funksione konsullore brenda rrethit të tij konsullor.
10. “Anëtar, bashkëpunëtor dhe i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit” kanë të njëjtin kuptim me



përkufizimet e bëra në legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

11. “Anëtarë të familjes së diplomatit” janë bashkëshorti/ja, fëmijët deri në moshën 23 vjeç, fëmijët me aftësi ndryshe pa kufizim moshe, si dhe personat e tretë në kujdestarinë e tij/saj ligjore.

12. “Personeli teknik, administrativ dhe mbështetës” janë të punësuarit në administratën e ministrisë, misionin diplomatik dhe postin konsullor, të cilët kryejnë funksione teknike administrative dhe mbështetëse.

13. “I dërguar i posaçëm” është diplomati i ngarkuar me një mision të posaçëm diplomatik dhe/ose për një çështje specifike.

14. “Rreth konsullor” është territori në shtetin pritës brenda të cilit ushtrohen funksionet konsullore.

Neni 5

Parimet e Shërbimit të Jashtëm

Shërbimi i Jashtëm është pjesë përbërëse e Shërbimit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe vepron në bazë të parimeve të profesionalizmit, meritës, integritetit, paanësisë politike, transparencës, shërbimit ndaj publikut, vazhdimësisë së karrierës, përgjegjësisë, si dhe korrektësisë në zbatimin e legjislacionit.

Neni 6

Funksionet e Shërbimit të Jashtëm

1. Shërbimi i Jashtëm realizon politikën e jashtme të Republikës së Shqipërisë në raport me shtetet e tjera, organizatat ndërkombëtare, subjektet e tjera të së drejtës ndërkombëtare, në përputhje me programin e qeverisë.

2. Shërbimi i Jashtëm nëpërmjet veprimtarisë së tij:

a) shpreh dhe mbron interesat kombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare;

b) nxit bashkëpunimin e Republikës së Shqipërisë me shtetet e tjera, organizatat ndërkombëtare, si dhe subjektet e tjera të së drejtës ndërkombëtare;

c) zhvillon marrëdhënie politike, ekonomike, sociale dhe kulturore me shtete të tjera;

ç) ofron shërbime konsullore sipas rrethit konsullor për shtetasit shqiptarë që jetojnë dhe gjenden jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë;

d) mbron të drejtat dhe interesat e shtetasve shqiptarë, si dhe të drejtat kombëtare të popullsisë shqiptare që jeton jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë;

dh) bashkërendon veprimtarinë me jashtë të institucioneve qendrore dhe vendore;

e) nxit dhe realizon plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

KREU II

MARRËDHËNIET E SHËRBIMIT TË JASHTËM ME INSTITUCIONET KUSHTETUESE, QENDRORE DHE VENDORE

Neni 7

Bashkëpunimi me Presidentin e Republikës

1. Ministri informon Presidentin e Republikës për çështje të rëndësishme të marrëdhënieve ndërkombëtare brenda detyrave dhe përgjegjësisë të veta.

2. Me kërkesë të Presidentit të Republikës ose me nismën e tij, ministri jep mendime dhe bën propozime për veprimtaritë ndërkombëtare që kryhen nga Presidenti i Republikës.

Neni 8

Bashkëpunimi me Kuvendin

1. Ministri informon Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për çështje të politikës së jashtme me nismën e tij ose me kërkesë të Kuvendit.

2. Ministri i propozon Këshillit të Ministrave të paraqesë përpara Kuvendit çështje të rëndësishme të politikës së jashtme për të cilat është e nevojshme që të mbahet qëndrim nga Kuvendi.

3. Kuvendi, sipas rastit, informon ministrinë për çështje të rëndësishme në interes të politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë.



Neni 9

Bashkëpunimi me Kryeministrin

1. Ministri informon dhe i paraqet Kryeministrit propozime për çështje që lidhen me përcaktimin dhe zbatimin e politikës së jashtme.

2. Ministri i raporton Kryeministrit për mënyrën e bashkëveprimit ndërinstitucional në funksion të realizimit të politikës së jashtme.

3. Kryeministria, sipas rastit, informon ministrinë për çështje të rëndësishme në interes të politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë.

Neni 10

Bashkëpunimi me ministrinë, institucionet në varësi të Kryeministrit dhe ministrave, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore

1. Ministrinë, institucionet në varësi të Kryeministrit dhe ministrave, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e politikës së jashtme në bashkëpunim të ngushtë me ministrinë.

2. Ministrat dhe drejtuesit e institucioneve të tjera shtetërore, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, ndërmarrin veprime, kryejnë dhe presin vizita në nivel ndërkombëtar, mbajnë qëndrime dhe bëjnë deklarata që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me jashtë, pasi të kenë marrë më parë miratimin dhe rekomandimin e ministrisë.

3. Drejtuesit e organeve të njësisë të vetëqeverisjes vendore ndërmarrin veprime, presin vizita në nivel ndërkombëtar, mbajnë qëndrime dhe bëjnë deklarata që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me jashtë, pasi të jenë konsultuar më parë me ministrinë dhe të kenë marrë udhëzimet e saj.

4. Subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni komunikojnë zyrtarisht nëpërmjet ministrisë me misionet diplomatike të Republikës së Shqipërisë të akredituara jashtë vendit dhe me misionet diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

5. Subjektet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni informojnë ministrinë për veprimtarinë e kryer prej tyre në fushën e marrëdhënieve me jashtë jo më vonë se 15 ditë kalendrike nga data e kryerjes së veprimtarisë.

6. Me propozimin e ministrit, Këshilli i Ministrave miraton rregullat e veprimtarisë me jashtë të ministrave, institucionet në varësi të Kryeministrit dhe ministrave, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Neni 11

Bashkërendimi ndërinstitucional

1. Me qëllim bashkërendimin në zbatimin e politikës së jashtme, ministri emëron koordinatore pranë strukturave të Kuvendit, Presidentit, Kryeministrit dhe ministrave kryesore që mbulojnë marrëdhëniet ndërkombëtare në marrëveshje me titullarët e këtyre institucioneve.

2. Koordinatorët emërohen nga diplomatët e karrierës për një kohëzgjatje jo më shumë se dy vjet, me të drejtë rinovimi, dhe janë pjesë e strukturës dhe organikës së ministrisë.

3. Detyrat e koordinatoreve përcaktohen me marrëveshje ndërmjet ministrisë dhe institucionit pranë të cilit emërohet koordinatori.

KREU III

NJOHJA E SHTETIT, QEVERISË, VENDOSJA DHE NDËRPRERJA E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE

Neni 12

Njohja e shtetit tjetër

Njohja e shtetit tjetër bëhet me miratim të Kuvendit pas propozimit të Këshillit të Ministrave, me iniciativë të ministrit.

Neni 13

Njohja e qeverisë, vendosja dhe ndërprerja e marrëdhënieve diplomatike

Njohja e qeverisë së një shteti tjetër, vendosja dhe ndërprerja e marrëdhënieve diplomatike me shtetet e tjera miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.



KREU IV
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONET E
SHËRBIMIT TË JASHTËM

Neni 14
Strukturat e Shërbimit të Jashtëm

Shërbimi i Jashtëm i Republikës së Shqipërisë përbëhet nga ministria, misionet diplomatike dhe postet konsullore.

Neni 15
Ministria

1. Ministria është institucioni drejtues i Shërbimit të Jashtëm që harton, përpunon, bashkërendon dhe zbaton politikën e jashtme të Republikës së Shqipërisë në përputhje me interesat kombëtare.

2. Përveç funksioneve të përgjithshme të Shërbimit të Jashtëm, ministria:

a) bashkërendon qëndrimet zyrtare për çështje të politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë me institucionin e Presidentit, Kuvendin, Këshillin e Ministrave, institucionet e tjera shtetërore;

b) komunikon me misionet diplomatike dhe postet konsullore të shteteve të tjera, si dhe me misionet e organizatave ndërkombëtare e subjektet e tjera të së drejtës ndërkombëtare, të akredituara në Republikën e Shqipërisë në përputhje me praktikën diplomatike;

c) drejton dhe bashkërendon veprimtarinë e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore të Republikës së Shqipërisë;

ç) ndjek procedurat për lidhjen e akteve ndërkombëtare, si dhe anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare sipas legjislacionit në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare;

d) depoziton marrëveshjet origjinale ndërkombëtare, të lidhura sipas legjislacionit në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë;

dh) përpunon, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin e veprimtarisë së Shërbimit të Jashtëm;

e) ushtron mbrojtjen diplomatike në formën dhe kufijtë e lejuar nga e drejta ndërkombëtare.

Neni 16
Ministri

1. Ministri drejton dhe përfaqëson Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë.

2. Në ushtrimin e përgjegjësisë dhe kompetencave të tij, ministri siguron zbatimin e programit të qeverisë për politikën e jashtme.

Neni 17
Zëvendësministri

1. Zëvendësministri zëvendëson në mungesë ministrin në drejtimin e ministrisë dhe zbatimin e programit të Këshillit të Ministrave.

2. Qëllimi i punës së zëvendësministrit është t'i sigurojë ministrit bashkëpunim për çështje të caktuara të politikës së jashtme, sipas detyrave të ngarkuara prej tij.

Neni 18
Sekretari i Përgjithshëm

1. Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë është nëpunësi më i lartë civil dhe i karrierës diplomatike në Shërbimin e Jashtëm. Ai siguron zbatimin e ligjshmërisë, miradministrimin dhe ruajtjen e vijimësisë në veprimtarinë e Shërbimit të Jashtëm.

2. Sekretari i Përgjithshëm ndihmon ministrin në hartimin dhe realizimin e objektivave të politikës së jashtme, duke bashkërenduar punën e strukturave të Shërbimit të Jashtëm.

3. Sekretari i Përgjithshëm përzgjidhet në këtë detyrë nga ministri pas konkurrimit të hapur nga radhët e diplomatëve të karrierës, me gradë diplomatike personale jo më të ulët se “Ministër këshilltar”.

4. Procedurat e përzgjedhjes së sekretarit të Përgjithshëm përcaktohen në rregulloren e Shërbimit të Jashtëm.

Neni 19
Struktura e ministrisë

Struktura dhe organika e ministrisë miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, në funksion të përmbushjes së prioritetëve dhe



objektivave të politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë.

Neni 20

Protokolli i Shtetit

1. Në strukturën e ministrisë bën pjesë Protokoll i Shtetit, i cili ka këto detyra:

a) bashkërendimin e të gjithë veprimtarisë kryesore protokollare të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe ministrit për veprimtarinë e tyre brenda dhe jashtë vendit;

b) bashkërendimin e veprimtarisë protokollare të anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe të drejtuesve të institucioneve të larta qendrore;

c) bashkërendimin dhe zbatimin e programit të vizitave të delegacioneve të huaja të nivelit të lartë;

ç) vendosjen e komunikimit dhe mbikëqyrjen e realizimit të privilegjeve dhe imuniteteve diplomatike për misionet diplomatike dhe postet konsullore të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

2. Mënyra e funksionimit të Protokollit të Shtetit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Neni 21

Akademia Diplomatike

1. Akademia Diplomatike, në vijim “AD”, është qendër e zhvillimit të karrierës diplomatike. AD-ja nuk i nënshtrohet legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë.

2. AD-ja ofron formim profesional të avancuar për diplomatët dhe për çdo individ tjetër, vendas apo të huaj, që përmbush kriteret për të ndjekur programet studimore dhe trajnuese që ajo ofron.

3. AD-ja ka si mision organizimin e kurseve të kualifikimit dhe të testeve periodike për diplomatët e karrierës, duke kontribuar në avancimin e karrierës së tyre dhe zhvillimin e aftësive të nevojshme profesionale.

4. Në ushtrimin e funksioneve të saj AD-ja:

a) lehtëson studimin shkencor në fushën e diplomacisë për anëtarët e Shërbimit të Jashtëm nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të programeve të përbashkëta studimore me njësi të tjera akademike dhe shkencore brenda dhe jashtë vendit;

b) përgatit dhe i paraqet ministrit raporte, analiza, vlerësime dhe parashikime për çështje të politikës së jashtme me interes për shtetin shqiptar;

c) organizon vetë ose në bashkëpunim me struktura të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, aktivitete, seminare dhe konferenca për politikën ndërkombëtare dhe marrëdhëniet me jashtë;

ç) përgatit dhe zhvillon trajnimin e dedikuar të cilit i nënshtrohet kreu i misionit diplomatik, kreu i postit konsullor dhe diplomatët e emëruar në misionin diplomatik dhe postin konsullor përpara marrjes së mandatit;

d) organizon dhe administron programet e kualifikimit dhe testimet periodike të detyrueshme për të gjithë diplomatët, me qëllim avancimin e karrierës së tyre dhe zhvillimin e aftësive profesionale në përputhje me standardet dhe kërkesat e shërbimit diplomatik. Kreu i AD-së i propozon Komisionit të Karrierës Diplomatike dhe Disiplinës kandidatët të cilët kualifikohen për t’iu nënshtroar testimit për gradën “Atashe”.

5. AD-ja mund të ofrojë kundrejt pagesës kurse trajnimi specifike në fushën e diplomacisë, protokollit apo marrëdhënieve ndërkombëtare ndaj palëve të treta.

6. AD-ja organizohet dhe funksionon si institucion në varësi të ministrit, me personalitet juridik publik dhe buxhet të vetin. Kreu i Akademisë Diplomatike emërohet nga ministri.

7. Me propozimin e ministrit, Këshilli i Ministrave miraton rregullat për organizimin, funksionimin dhe financimin e AD-së.

Neni 22

Komisioni i Karrierës Diplomatike dhe Disiplinës

1. Komisioni i Karrierës Diplomatike dhe Disiplinës, në vijim “KKDD”, vlerëson dhe i propozon ministrit:

a) dhënien e gradës diplomatike për diplomatët e karrierës sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe të rregullores së Shërbimit të Jashtëm;

b) dhënien e masave disiplinore për diplomatët për kryerjen e shkeljeve të rënda ose shumë të rënda.

2. KKDD-ja ngrihet me urdhër të ministrit në muajin janar të çdo viti kalendarik dhe përbëhet nga pesë anëtarë, nga të cilët katër janë diplomatë karriere me gradë personale diplomatike të lartë dhe drejtori i burimeve njerëzore.



3. KKDD-ja drejtohet nga diplomati me gradën diplomatike personale më të lartë. Nëse në KKDD bëjnë pjesë më shumë se një diplomat me gradën më të lartë të njëjtë, Komisioni drejtohet nga diplomati që e gëzon këtë gradë më gjatë se të tjerët. Në rastet kur kohëzgjatja në gradë është e njëjtë, komisioni drejtohet nga diplomati me gjininë më pak të përfaqësuar.

4. KKDD-ja mbledhet:

a) për aplikimet për gradat diplomatike personale në muajin mars të çdo viti,

b) për shqyrtimin e ecurisë disiplinore për shkeljet e rënda dhe shumë të rënda, rast pas rasti.

5. KKDD-ja e ushtron veprimtarinë deri në zëvendësimin nga KKDD-ja pasardhëse.

6. Mënyra e funksionimit të KKDD-së përcaktohet në rregulloren e Shërbimit të Jashtëm.

Neni 23

Komisioni i Apelimit

1. Komisioni i Apelimit, në vijim “KA”, ka për detyrë shqyrtimin e ankesave ndaj vlerësimit të KKDD-së, sipas pikës 1 të nenit 22 të këtij ligji.

2. KA ngrihet me urdhër të ministrit në të njëjtën kohë me KKDD-në dhe përbëhet nga tre anëtarë, që janë Sekretari i Përgjithshëm, një diplomat karriere me gradë personale diplomatike të lartë, me kushtin të mos jenë anëtar i KKDD-së, si dhe drejtuesi i drejtorisë përgjegjëse për shqyrtimin e ankesave administrative në ministri.

3. KA-ja drejtohet nga sekretari i Përgjithshëm dhe e ushtron veprimtarinë deri në zëvendësimin nga KA-ja pasardhëse.

4. KA-ja i propozon ministrit lënien në fuqi të vendimit ose ndryshimin e tij.

5. Vendimi i dhënë nga ministri mund të ankimohet në gjykatën përkatëse që shqyrton mosmarrëveshjet administrative.

6. Mënyra e funksionimit të KA-së përcaktohet në rregulloren e Shërbimit të Jashtëm.

Neni 24

Përfaqësimi diplomatik dhe konsullor

1. Përfaqësimi diplomatik i Republikës së Shqipërisë jashtë vendit realizohet nga misionet diplomatike dhe postet konsullore në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike

të vitit 1961 dhe Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të vitit 1963.

2. Misioni diplomatik është:

a) ambasada;

b) misioni pranë organizatave ndërkombëtare;

c) misioni i posaçëm;

ç) misioni i përbashkët me shtetet e treta;

d) zyra e interesit;

dh) zyra ekonomike dhe qendra kulturore.

3. Post konsullor është:

a) konsullata e përgjithshme;

b) konsullata;

c) nënkonsullata;

ç) zyra konsullore;

d) konsullata e nderit.

Neni 25

Hapja dhe mbyllja e misionit diplomatik dhe postit konsullor

1. Misioni diplomatik dhe posti konsullor i Republikës së Shqipërisë hapen dhe mbyllen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

2. Struktura e misionit diplomatik dhe e postit konsullor miratohen me urdhër të ministrit.

3. Me qëllim ushtrimin e veprimtarisë së misionit diplomatik dhe konsullor, ministri mund t'i propozojë Këshillit të Ministrave blerjen e pasurive të paluajtshme në shtetin pritës. Kriteret që duhet të përmbushë pasuria e paluajtshme dhe procedurat që ndiqen për blerjen përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 26

Ambasada

1. Ambasada është strukturë e Shërbimit të Jashtëm, që e ushtron veprimtarinë në një shtet tjetër dhe ka këto funksione kryesore:

a) përfaqëson Republikën e Shqipërisë dhe mban marrëdhëniet zyrtare me shtetin pritës ku është akredituar;

b) mbron të drejtat dhe interesat e ligjshme të Republikës së Shqipërisë, shtetasve dhe subjekteve ligjore të saj;

c) zbaton detyrat në fushën e politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë, duke respektuar legjislacionin e shtetit pritës;



ç) nxit marrëdhënie bashkëpunimi me interes të ndërsjellë në të gjitha fushat ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shtetit pritës;

d) bashkëpunon me delegacionet e Republikës së Shqipërisë në bisedimet që zhvillohen në shtetin pritës ose organizatën ndërkombëtare, merr pjesë në bisedime me qeverinë e shtetit pritës ose organizatën ndërkombëtare, si dhe në veprimtari e konferenca ndërkombëtare;

dh) ndjek dhe i dërgon ministrisë informacion për situatën politike dhe ekonomike apo për situatën në fusha të tjera me interes në shtetin pritës, si dhe informacion për zhvillimet me interes në organizatën ndërkombëtare ku është akredituar;

e) informon autoritetet e shtetit pritës apo organizatën ndërkombëtare ku është akredituar për zhvillimet në Republikën e Shqipërisë.

2. Ambasada mund të kryejë në shtetin pritës funksione konsullore sipas përcaktimeve të këtij ligji. Funksionet konsullore ushtrohen nga diplomatë të ngarkuar për veprimtarinë konsullore.

Neni 27

Misioni pranë organizatave ndërkombëtare

Misioni pranë organizatave ndërkombëtare është strukturë e Shërbimit të Jashtëm dhe ka këto funksione kryesore:

a) përfaqëson Republikën e Shqipërisë dhe mban marrëdhëniet zyrtare me organizatat ndërkombëtare ku është akredituar;

b) mbron të drejtat dhe interesat e ligjshëm të Republikës së Shqipërisë, shtetasve dhe subjekteve ligjore të saj në raport me organizatat ndërkombëtare ku është akredituar;

c) zbaton detyrat në fushën e politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë, duke respektuar legjislacionin e shtetit pritës;

ç) nxit marrëdhënie bashkëpunimi me interes të ndërsjellë në të gjitha fushat ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe organizatës ndërkombëtare;

d) bashkëpunon me delegacionet e Republikës së Shqipërisë në bisedimet që zhvillohen në organizatën ndërkombëtare, merr pjesë në bisedime me organizatën ndërkombëtare, si dhe në veprimtari e konferenca ndërkombëtare;

dh) ndjek dhe i dërgon ministrisë informacion për zhvillimet me interes në organizatën ndërkombëtare ku është akredituar;

e) informon autoritetet e organizatës ndërkombëtare ku është akredituar për zhvillimet në Republikën e Shqipërisë.

Neni 28

Misioni i posaçëm

1. Misioni i posaçëm është misioni i përkohshëm, që përfaqëson Republikën e Shqipërisë në një shtet tjetër ose organizatë ndërkombëtare me pëlqimin e tyre për të negociuar ose për të kryer detyra të posaçme.

2. Misioni i posaçëm mund të jetë edhe një njësi ose formacion i krijuar për të punuar në një detyrë ose aktivitet të vetëm të përcaktuar në ministri.

3. Misioni i posaçëm drejtohet nga i dërguari i posaçëm, i cili emërohet nga ministri.

4. I dërguari i posaçëm duhet të plotësojë kërkesat për pranimin në Shërbimin e Jashtëm.

5. Mënyra e krijimit, përbërja, funksionet dhe trajtimi financiar i misionit të posaçëm dhe të dërguarit të posaçëm përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Neni 29

Misioni i përbashkët

1. Misioni i përbashkët është misioni diplomatik ose posti konsullor, i krijuar në marrëveshje me një ose më shumë shtete të tjera, i akredituar në një shtet të tretë ose pranë një organizate ndërkombëtare.

2. Marrëveshja për ngritjen e misionit të përbashkët lidhet në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

3. Mënyra e krijimit, përbërja, funksionet dhe trajtimi financiar i misionit të përbashkët përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Neni 30

Zyra e interesit

1. Zyra e interesit përfaqëson interesat e Republikës së Shqipërisë në një shtet të tretë me të cilin nuk ka marrëdhënie diplomatike.

2. Në shtetet me të cilat Republika e Shqipërisë nuk ka marrëdhënie diplomatike, zyra e interesit ndjek zhvillimet ekonomike dhe nxit bashkëpunimin ekonomik me shtetin pritës.



3. Hapja, funksionimi dhe mbyllja e zyrës së interesit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Neni 31

Zyra ekonomike dhe qendra kulturore

1. Zyra ekonomike dhe qendra kulturore përfaqësojnë interesat ekonomike dhe kulturore të Republikës së Shqipërisë në një shtet tjetër me të cilin ka marrëdhënie diplomatike.

2. Zyra ekonomike dhe qendra kulturore e ushtrojnë aktivitetin në varësi të kreut të misionit diplomatik, të akredituar në shtetin pritës.

3. Zyra ekonomike dhe qendra kulturore hapen me marrëveshje me shtetin pritës. Funksionimi dhe mbyllja e zyrës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Neni 32

Posti konsullor

1. Posti konsullor i Republikës së Shqipërisë është strukturë e Shërbimit të Jashtëm, që vepron në mënyrë të përhershme në një shtet të huaj dhe ushtron funksione konsullore në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të vitit 1963 dhe me këtë ligj.

2. Posti konsullor është sipas rastit: konsullata e përgjithshme, konsullata, nënkonsullata, zyra konsullore dhe konsulli i nderit.

3. Posti konsullor i ushtron funksionet në rrethin e tij konsullor brenda kufijve të lejuar nga e drejta ndërkombëtare, në marrëveshje me shtetin pritës dhe nën autoritetin e kreut të ambasadës ose kreut të postit konsullor të akredituar në shtetin pritës.

4. Posti konsullor mund të kryejë funksione të tjera përveç funksioneve konsullore për të cilat autorizohet nga ministri në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Shërbimet konsullore që ofrohen nga posti konsullor, procedurat dhe tarifat për ofrimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Neni 33

Konsullata e Përgjithshme

1. Konsullata e Përgjithshme është posti më i lartë i përfaqësimit konsullor në rrethin konsullor të përcaktuar në marrëveshje me shtetin pritës.

2. Funksionet kryesore të Konsullatës së Përgjithshme janë:

a) mbron interesat dhe të drejtat e Republikës së Shqipërisë, të shtetasve ose personave juridikë të saj, të cilët ndodhen në rrethin e saj konsullor, brenda kufijve të lejuar nga e drejta ndërkombëtare në shtetin pritës;

b) ofron shërbime konsullore në prezencë fizike dhe në distancë;

c) zhvillon marrëdhëniet me shtetin pritës në fushat e ekonomisë, tregtisë, kulturës, arsimit, shkencës dhe informacionit;

ç) informon ministrinë për zhvillimet ekonomike, tregtare, kulturore dhe shkencore në shtetin pritës.

3. Konsullata e Përgjithshme e bashkërendon aktivitetin e saj me ambasadën në vendin e akreditimit.

Neni 34

Konsullata, nënkonsullata, zyra konsullore

1. Konsullata, nënkonsullata dhe zyra konsullore janë poste konsullore të cilat funksionojnë në varësi të ambasadës ose Konsullatës së Përgjithshme në vendin pritës. Funksionet e tyre parashikohen në nenin 33, pika 2, shkronjat “a” dhe “b”, të këtij ligji.

2. Postet konsullore, të parashikuara në këtë nen, mund të kryejnë funksione të tjera për të cilat autorizohen nga ministri në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 35

Konsullata e Nderit

1. Konsullata e nderit është një post konsullor që përfaqëson Republikën e Shqipërisë në vendin pritës për të ushtruar disa funksione konsullore në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të vitit 1963, me këtë ligj dhe me aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

2. Konsullata e nderit drejtohet nga Konsulli i Përgjithshëm i Nderit ose Konsulli i Nderit dhe



është në varësi të kreut të misionit diplomatik në shtetin ku është akredituar.

3. Konsulli i Përgjithshëm i Nderit dhe Konsulli i Nderit emërohen dhe lirohen nga ministri.

4. Mandati i Konsullit të Përgjithshëm të Nderit dhe Konsullit të Nderit është katërvjeçar me të drejtë rinovimi.

5. Konsullatat e nderit ushtrojnë këto funksione kryesore:

a) mbrojtja e interesave të qytetarëve dhe subjekteve shqiptare në vendin pritës;

b) nxitja e marrëdhënieve tregtare, ekonomike, kulturore dhe shkencore me vendin pritës;

c) ofrimi i mbështetjes për qytetarët shqiptarë, duke përfshirë çështjet e shëndetit, këshillat ligjorë dhe njoftimet me natyrë konsullore;

ç) ofrimi i informacioneve në vendin pritës për zhvillimet e brendshme ekonomike, tregtare ose kulturore në Republikën e Shqipërisë dhe anasjelltas.

6. Konsullata e Përgjithshme e Nderit mund të kryejë funksione të tjera për të cilat autorizohet nga ministri në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Procedurat e hapjes dhe funksionimit të konsullatave të nderit dhe emërimit të konsullit të përgjithshëm përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 36

Përfaqësimi diplomatik nga/për vendet e treta

1. Këshilli i Ministrave mund të lidhë marrëveshje me qeverinë e një shteti tjetër për të përfaqësuar dhe për të mbrojtur interesat e shtetit e të shtetasve të Republikës së Shqipërisë në një shtet të tretë ku Republika e Shqipërisë nuk ka mision diplomatik. Marrëveshjet i nënshtrohen ratifikimit nga Kuvendi i Shqipërisë.

2. Këshilli i Ministrave mund të lidhë marrëveshje me qeverinë e një shteti tjetër për të hapur pranë misionit diplomatik të këtij të fundit një zyrë interesi.

3. Këshilli i Ministrave mund të lidhë marrëveshje me qeverinë e një shteti tjetër për të përfaqësuar interesat diplomatike të shtetit palë në marrëveshje apo edhe interesat e shtetasve të tij në një shtet të tretë.

Neni 37

Kreu i misionit diplomatik

1. Misioni diplomatik drejtohet nga ambasadori ose i ngarkuari me punë.

2. Ambasadori emërohet dhe lirohet nga Presidenti i Republikës jo më vonë se 30 ditë pas propozimit të Kryeministrit.

3. Ministri i paraqet Kryeministrit propozimin për emërimin dhe lirim të ambasadorit.

4. Përpara emërimit të ambasadorit nga Presidenti i Republikës, komisioni parlamentar përgjegjës për politikën e jashtme organizon seancë dëgjimore me kandidatin për ambasador dhe i përcjell Presidentit të Republikës opinionin për kandidaturën e propozuar.

5. Mandati i kreut të misionit diplomatik është katërvjeçar. Kreu i misionit diplomatik nuk mund të ushtrojë më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme në krye të misionit diplomatik dhe postit konsullor.

6. Kreu i misionit diplomatik, i cili është diplomat karriere, pas përfundimit të mandatit apo mandateve të njëpasnjëshme punon pranë ministrisë për një periudhë kohe prej jo më pak se gjysma e mandatit/kohëzgjatja që ka qëndruar në misionin diplomatik apo postin konsullor.

7. Kreu i misionit diplomatik në rastin kur përfaqësimi diplomatik është në nivelin e të ngarkuarit me punë të përhershëm (*charge d'affaires*) emërohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit.

8. Në kushtet e mungesës së përkohshme të kreut të misionit, drejtimi i misionit diplomatik dhe funksionet e të ngarkuarit me punë i kalojnë si rregull diplomatit me gradën më të lartë, përveç rasteve kur vendoset ndryshe nga ministri.

Neni 38

Përzgjedhja e kreut të misionit diplomatik

1. Kreu i misionit diplomatik përzgjidhet ndërmjet diplomatëve të karrierës me gradë të lartë, jo më pak se këshilltar.

2. Në raste të veçanta, bazuar në interesat e politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë, ministri i propozon Kryeministrit kandidatura për kreun e misionit diplomatik jashtë sistemit të karrierës diplomatike, personalitete të shquara në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, të së drejtës, ekonomisë, kulturës, shkencës apo të shoqërisë civile, me lidhje ose marrëdhënie dobiprurëse me shtetin pritës.

3. Kandidati për kre të misionit diplomatik, i përzgjedhur sipas pikës 2 të këtij neni, duhet të



plotësojë kërkesat për pranim në Shërbimin e Jashtëm të parashikuara në nenin 45 të këtij ligji.

4. Të drejtat dhe detyrimet e kreut të misionit diplomatik, të përzgjedhur sipas pikës 2 të këtij neni, përcaktohen në rregulloren e Shërbimit të Jashtëm.

Neni 39

Funksionet e kreut të misionit diplomatik

1. Kreu i misionit diplomatik ushtron këto funksione kryesore:

a) përfaqëson Republikën e Shqipërisë dhe vepron në emër të saj në shtetin pritës ose organizatat ndërkombëtare;

b) negocion dhe nënshkruan instrumente diplomatike me miratimin e ministrit;

c) jep deklarata dhe mban qëndrime në emër të Republikës së Shqipërisë, në bazë të udhëzimeve të ministrisë;

ç) kryen çdo funksion tjetër të përcaktuar nga Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike e vitit 1961.

2. Kreu i misionit diplomatik kryen funksione dhe veprimtari të tjera për të cilat autorizohet nga ministri, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Kreu i misionit diplomatik ka autoritet mbi të gjithë personelin civil dhe ushtarak, që bën pjesë në strukturën e misionit diplomatik. Ai drejton, udhëzon, kontrollon dhe vlerëson të gjithë veprimtarinë zyrtare të personelit të misionit diplomatik.

4. Kreu i misionit diplomatik është përgjegjës për miradministrimin e burimeve financiare të misionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Kreu i misionit diplomatik mban përgjegjësi të drejtpërdrejtë disiplinore për moszbatimin e përpiktë të udhëzimeve që i drejtohen nga organet eprore përkatëse të ministrisë.

6. Kreu i misionit diplomatik bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e posteve konsullore, të parashikuara në nenet 34 dhe 35 të këtij ligji, të Republikës së Shqipërisë në shtetin pritës.

Neni 40

Akreditimi i kreut të misionit diplomatik

1. Kreu i misionit diplomatik i Republikës së Shqipërisë mund të akreditohet në një ose disa shtete të tjera, përveç shtetit në të cilin ai është rezident.

2. Kreu i misionit diplomatik mund të akreditohet në një ose disa organizata ndërkombëtare, të cilat i kanë selitë e tyre në shtetin e akreditimit.

3. Në shtetet ku Republika e Shqipërisë nuk ka përfaqësim diplomatik mund të akreditohen ambasadorë jorezidentë. Për emërimin e ambasadorëve jorezidentë zbatohen të njëjtat kushte, kritere dhe procedura që zbatohen për ambasadorët që emërohen në krye të misioneve diplomatike.

Neni 41

Kreu i postit konsullor

1. Posti konsullor drejtohet nga Konsulli i Përgjithshëm ose, sipas rastit, konsulli.

2. Konsulli i Përgjithshëm emërohet dhe lirohet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit. Përzgjedhja e kreut të postit konsullor bëhet sipas së njëjtës procedurë me të cilën bëhet përzgjedhja e kreut të misionit diplomatik, nga radhët e diplomatëve të karrierës, me gradë diplomatike personale jo më pak se “Këshilltar”.

3. Kreu i postit konsullor mund të përzgjidhet edhe nga jashtë sistemit të karrierës diplomatike sipas kërkesave për pranim në Shërbimin e Jashtëm të përcaktuara në nenin 45 të këtij ligji.

4. Kreu i postit konsullor është në varësi të drejtpërdrejtë të ministrit dhe i ushtron funksionet në përputhje me legjislacionin për shërbimet konsullore dhe këtë ligj, si dhe në bazë të udhëzimeve të strukturave përkatëse të ministrisë.

5. Mandati i kreut të postit konsullor është katërvjeçar. Kreu i postit konsullor nuk mund të ushtrojë më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme në krye të postit konsullor dhe misionit diplomatik.

6. Kreu i postit konsullor, i cili është diplomat karriere, pas përfundimit të mandatit apo mandateve të njëpasnjëshme, punon pranë ministrisë për një periudhë kohe prej jo më pak se gjysma e mandatit/kohëzgjatja që ka qëndruar në misionin diplomatik apo postin konsullor.

7. Kreu i postit konsullor drejton veprimtarinë konsullore në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të vitit 1963, me legjislacionin në fuqi për shërbimet konsullore dhe me këtë ligj.

8. Kreu i postit konsullor drejton, udhëzon, kontrollon dhe vlerëson të gjithë veprimtarinë zyrtare të personelit të postit konsullor.



9. Kreu i postit konsullor është përgjegjës për miradministrimin e burimeve financiare të konsullatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

10. Kreu i postit konsullor mban përgjegjësi të drejtpërdrejtë disiplinore për moszbatimin e përpiktë të udhëzimeve që i drejtohen nga organet e prapë përkatëse të ministrisë.

Neni 42

Personeli i misioneve diplomatike dhe posteve konsullore

1. Personeli i misioneve diplomatike dhe posteve konsullore përbëhet nga diplomatët e karrierës, diplomatët e emëruar sipas përcaktimeve të pikës 3 të këtij neni, personeli administrativ, personeli teknik dhe i shërbimit.

2. Në personelin e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore mund të përfshihen edhe nëpunës të emëruar nga ministri në bazë të një marrëveshjeje me ministrinë ose institucionet e tjera shtetërore për të kryer detyra në fushën ekonomike, juridike, kulturore, shkencore, të mbrojtjes, sigurisë dhe në çdo fushë tjetër për një kohë të përcaktuar. Gjatë kohës së shërbimit në misionin diplomatik ose postin konsullor këta nëpunës gëzojnë të njëjtin status me diplomatët dhe, pas përfundimit të këtij shërbimi, rikthehen në pozicionin e mëparshëm ose në një pozicion të barasvlershëm me të. Procedurat për emërimin dhe trajtimin financiar të këtyre nëpunësve rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit. Shpenzimet për këtë kategori nëpunësish përballohen nga institucioni dërgues.

3. Ministri mund të emërojë në misionet diplomatike dhe postet konsullore ekspertë jashtë radhëve të diplomatëve të karrierës, me gradë emërimi jo më të lartë se “Sekretar i Parë”. Këta ekspertë duhet të zotërojnë njohuri dhe ekspertizë sipas specifikave të pozicionit të emërimit, ose të kenë eksperiencë në organizatat ndërkombëtare publike. Gjatë kohës së shërbimit në misionin diplomatik ose postin konsullor këta nëpunës gëzojnë të njëjtin status me diplomatët. Të drejtat dhe detyrimet e këtyre punonjësve do të përcaktohen në rregulloren e Shërbimit të Jashtëm.

4. Ministri mund të emërojë si këshilltarë të jashtëm në fushën ekonomike dhe kulturore pranë misioneve diplomatike shtetas shqiptarë rezidentë në shtetin pritës. Mandati i këtyre këshilltarëve do të

jetë për një periudhë katërvjeçare dhe jo më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme. Gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit si këshilltarë të jashtëm të emëruar sipas kësaj pike ata nuk gëzojnë statusin e diplomatit, si dhe nuk përfitojnë pagë dhe trajtim financiar. Funksionet dhe kushtet e parashikuara në këtë pikë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Në përbërje të misionit diplomatik pranë organizatave ndërkombëtare, në rastet e anëtarësimit apo kryesimit të organeve kryesore të këtyre organizatave, përveç ambasadorit të emëruar nga Presidenti i Republikës, ministri mund të emërojë diplomatë me gradën “Ambasador *ad hoc*”, të cilët ushtrojnë funksionet e zëvendësreut të misionit, nën autoritetin e kreut të misionit diplomatik.

6. Mandati i diplomatëve të emëruar në përbërje të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore është katërvjeçar. Diplomatat e emëruar nuk mund të ushtrojnë më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme në misionet diplomatike dhe postet konsullore.

7. Pas përfundimit të mandatit, diplomati i karrierës, i emëruar në misionin diplomatik apo postin konsullor punon pranë ministrisë për një periudhë kohe prej jo më pak se gjysma e mandatit/kohëzgjatjes që ka qëndruar në misionin diplomatik apo postin konsullor.

8. Personat e emëruar sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni duhet të plotësojnë kërkesat për pranimin në Shërbimin e Jashtëm sipas nenit 45 të këtij ligji.

9. Personeli teknik, administrativ dhe i shërbimit, në misionet diplomatike dhe postet konsullore emërohet në detyrë sipas parashikimeve të nenit 67 të këtij ligji.

10. Rregullat për punësimin e personelit administrativ, teknik dhe të shërbimit përcaktohen në rregulloren e Shërbimit të Jashtëm.

11. Personeli administrativ, teknik dhe i shërbimit mund të përbëhet nga shtetas të vendit pritës, si dhe shtetas të Republikës së Shqipërisë ose shtetas të një vendi të tretë, që kanë leje qëndrimi në shtetin pritës. Kontrata e punësimit nuk mund të tejkalojë afatin e lejes së qëndrimit dhe duhet të respektojë legjislacionin e brendshëm të vendit pritës.

12. Përcaktimi i nevojës për rekrutim të personave me banim në shtetin pritës dhe procedura e kontraktimit të punës apo shërbimit nga të tretë në shtetin pritës sipas nevojave të misionit diplomatik



dhe postit konsullor përcaktohen në rregulloren e Shërbimit të Jashtëm.

Neni 43

Imunitetet dhe privilegjet

1. Kreu dhe personeli i misionit diplomatik dhe postit konsullor, të akredituar në misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë, si dhe anëtarët e familjeve të tyre gëzojnë imunitetet dhe privilegjet që garantohen nga aktet e së drejtës ndërkombëtare apo nga marrëveshjet dypalëshe të lidhura me shtetin pritës.

2. Me kërkesë të autoriteteve të shtetit të akreditimit, ministri mund të heqë imunitetin e subjekteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

KREU V

PERSONELI I SHËRBIMIT TË JASHTËM

Neni 44

Kategorizimi i personelit të Shërbimit të Jashtëm

Personeli i Shërbimit të Jashtëm përbëhet nga:

- a) diplomatët;
- b) nëpunësit civilë;
- c) personeli teknik, administrativ dhe i shërbimit.

Neni 45

Kërkesat për pranimin në Shërbimin e Jashtëm

Në Shërbimin e Jashtëm pranohen personat që plotësojnë kërkesat e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil, si dhe kërkesat e mëposhtme:

a) të mos bëjnë pjesë në asnjë parti apo shoqatë politike;

b) të mos kenë qenë persona në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm, anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 dhe të mos figurojnë në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit sipas legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

c) të plotësojnë kriteret për t'u pajisur me certifikatë sigurie personeli (CSP) sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar;

ç) të zotërojnë në bazë të vërtetimit përkatës të paktën dy gjuhë të huaja, një prej të cilave të jetë gjuha angleze dhe një ndër gjuhët zyrtare të OKB-së ose të Bashkimit Evropian;

d) të përfundojnë trajnimin e dedikuar të Akademisë Diplomatike.

Neni 46

Pranimi në Shërbimin e Jashtëm

1. Pranimi në Shërbimin e Jashtëm bëhet nëpërmjet rekrutimit me konkurrin të hapur në përputhje me procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për nëpunësin civil, me këtë ligj dhe me aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Personat e rekrutuar janë kandidatë për t'u pranuar në Shërbimin e Jashtëm dhe i nënshtrohen periudhës së provës. Gjatë periudhës së provës, përveç kryerjes së ciklit të detyrueshëm të trajnimit sipas ligjit për nëpunësin civil, kandidati i nënshtrohet ciklit të detyrueshëm të trajnimit në të gjitha strukturat kryesore të ministrisë, sipas programit të përcaktuar nga Akademia Diplomatike.

3. Gjatë periudhës së provës kandidati duhet të pajiset me certifikatën e sigurisë dhe të ketë përfunduar me sukses procedurën e vërtetimit të pastërtisë së figurës, sipas përcaktimeve të nenit 48 të këtij ligji.

4. Pas përfundimit të periudhës së provës dhe plotësimit të kërkesave sipas nenit 21, pika 4, shkronja "d" të këtij ligji, dhe pikës 3 të këtij neni, kandidati i cili kalon me sukses testimin e organizuar nga KKDD-ja bëhet pjesë e sistemit të karrierës diplomatike dhe merr gradën "Atashe". Nëse kandidati nuk plotëson kërkesat sipas kësaj pike ose nuk kalon me sukses testimin, marrëdhënia e punës në Shërbimin e Jashtëm përfundon.

5. Përfundim nga pikat 2 dhe 4 të këtij neni, bëjnë personat që kanë eksperiencë në organizatat ndërkombëtare publike, të cilët i nënshtrohen rekrutimit me konkurrin të hapur në përputhje me procedurat e përcaktuara në legjislacionin për nëpunësin civil dhe në të njëjtën kohë testimit të organizuar nga KKDD-ja për t'u bërë pjesë e sistemit të karrierës diplomatike.

6. Procedura e testimit sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni përcaktohet në Rregulloren e Shërbimit të Jashtëm.



Neni 47

Transferimi, lëvizja paralele, ngritja në detyrë

1. Transferimi i diplomatëve nga ministria në misionet diplomatike dhe postet konsullore dhe anasjelltas, si dhe në rastet e ristrukturimit të ministrisë bëhet me urdhër të ministrit.

2. Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë bëhen me urdhër të ministrit, mbështetur në vlerësimin e punës së diplomatit, në përputhje me pozicionet vakante në strukturën e miratuar.

3. Procedurat e kryerjes së transferimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë përcaktohen në rregulloren e Shërbimit të Jashtëm.

Neni 48

Verifikimi i sigurisë dhe pastërtisë së figurës

1. Personeli diplomatik, teknik dhe administrativ në Shërbimin e Jashtëm i nënshtrohet verifikimit të sigurisë dhe pastërtisë së figurës, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi dhe këtij ligji.

2. Përmbushja e kriterëve mbi bazën e të cilave vlerësohet lëshimi i certifikatës së sigurisë së personelit është kusht për vijimin e marrëdhënies në Shërbimin e Jashtëm.

3. Në rast të refuzimit apo revokimit të certifikatës së sigurisë së personelit, punonjësi përjashtohet nga Shërbimi i Jashtëm.

4. Procedura e verifikimit të pastërtisë së figurës përcaktohet në rregulloren e Shërbimit të Jashtëm.

KREU VI

STATUSI I DIPLOMATIT TË KARRIERËS

Neni 49

Zhvillimi i karrierës diplomatike

1. Pas konfirmimit si nëpunës civil, nëpunësi bën betimin dhe fiton statusin e diplomatit të karrierës dhe gradën diplomatike “Atashe”.

2. Ceremonia e betimit bëhet pranë Komisionit të Karrierës Diplommatike dhe Disiplinës. Formula e betimit është si më poshtë:

“Betohe me përpara flamurit kombëtar, në nderin dhe bindjen time, se do të zbatoj Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe do t’u shërbej interesave të popullit dhe atdheut tim. Betohe!”.

3. Diplomati i karrierës emërohet në pozicione drejtuese në ministri në përputhje me hierarkinë e gradave diplomatike si më poshtë:

- | | |
|----------------------------|---|
| a) përgjegjës sektori | Me gradën jo më të ulët se “Sekretar i parë”. |
| b) drejtor | Me gradën jo më të ulët se “Këshilltar”. |
| c) drejtor i Përgjithshëm | Me gradën jo më të ulët se “Ministër këshilltar”. |
| ç) sekretar i Përgjithshëm | Me gradën jo më të ulët se “Ministër këshilltar”. |

Neni 50

Punësimi jashtë Shërbimit të Jashtëm

1. Diplomati i karrierës mund të punësohet në pozicione që mbulojnë marrëdhëniet me jashtë në institucionet kushtetuese dhe administratën shtetërore pas marrëveshjes përkatëse ndërmjet ministrisë dhe këtyre institucioneve. Kjo periudhë konsiderohet vijim i pandërprerë i statusit të diplomatit.

2. Diplomati i karrierës mund të punësohet në organizatat ndërkombëtare publike në të cilat Republika e Shqipërisë është anëtare apo kandidate për anëtarësim për periudha të përkohshme pas miratimit nga ministri dhe me marrëveshje ndërmjet ministrisë dhe diplomatit në fjalë. Kjo periudhë konsiderohet vijim i pandërprerë i statusit të diplomatit.

3. Periudha e punësimit në detyrat e përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni merret në konsideratë për efekt të llogaritjes së afatit kohor të nevojshëm për përfitimin e gradave diplomatike personale.

4. Me mbarimin e detyrës në institucionet e përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, diplomati i karrierës ka të drejtë të rikthehet në Shërbimin e Jashtëm në përputhje me marrëveshjet përkatëse.

5. Procedurat e punësimit, të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, përcaktohen në rregulloren e Shërbimit të Jashtëm.

6. Ministria njofton Departamentin e Administratës Publike për punësimet e parashikuara në këtë nen.



Neni 51

Emërimi dhe mbarimi i detyrës në misionet diplomatike dhe postet konsullore

1. Diplomatët e karrierës emërohen në misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë nga ministri, pasi kanë marrë gradën diplomatike “Sekretar i tretë”.

2. Diplomatët e karrierës, të cilët mbajnë gradë diplomatike personale nga “Sekretar i tretë” deri në “Sekretar i parë” emërohen në misionet diplomatike dhe postet konsullore me një gradë emërimi më të lartë se grada diplomatike personale.

3. Ministri urdhëron transferimin dhe emërimin e diplomatit të karrierës në një pozicion tjetër në Shërbimin e Jashtëm tre muaj para datës së transferimit.

4. Procedurat e emërimit dhe mbarimit të detyrës në misionet diplomatike ose postet konsullore përcaktohen në rregulloren e Shërbimit të Jashtëm.

Neni 52

Mbarimi i parakohshëm i funksionit dhe transferimi i kreut dhe personelit të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore

1. Ministri urdhëron mbarimin e parakohshëm të funksionit ose transferimin e kreut të misionit diplomatik apo postit konsullor, si dhe të çdo anëtarit të personelit të misionit diplomatik ose postit konsullor për arsyt e mëposhtme:

- a) kur një gjë e tillë kërkohet nga shteti pritës;
- b) kur ai ose anëtarët e familjes së tij kryejnë veprime që janë në kundërshtim me politikën e jashtme, cenojnë marrëdhëniet me shtetin pritës dhe imazhin e shtetit shqiptar;
- c) për shkelje të rënda të dispozitave të këtij ligji ose të akteve të tjera në fuqi;
- ç) për nevoja pune të Shërbimit të Jashtëm;
- d) në bazë të kërkesës së vetë diplomatit kur kërkesa miratohet nga ministri;
- dh) kur mbush moshën për pension;
- e) kur gjendja e paaftësisë shëndetësore është provuar se pengon në mënyrë të përhershme përmbushjen e detyrave të tij.

2. Ministri për rastet e parashikuara në shkronjat “ç” dhe “d” të pikës 1 të këtij neni urdhëron fillimin e procedurave të mbarimit të detyrës së diplomatit jo më pak se tre muaj nga data e emërimit në një pozicion në Shërbimin e Jashtëm.

Neni 53

Përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin e Jashtëm

Përveç rasteve të parashikuara në legjislacionin për nëpunësin civil, diplomati përfundon marrëdhënien e tij të punës në Shërbimin e Jashtëm kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) largohet me masë disiplinore;
- c) provohet se ka qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm, anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 dhe figuron në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë;
- ç) i hiqet ose i refuzohet përtëritja e certifikatës së sigurisë së personelit (CSP) sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 54

Gradat diplomatike dhe konsullore

1. Diplomatët gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre në Shërbimin e Jashtëm marrin grada diplomatike ose konsullore.

2. Gradat diplomatike në Shërbimin e Jashtëm janë:

- a) “Ambasador”;
- b) “Ministër fuqiplotë”;
- c) “Ministër këshilltar”;
- ç) “Këshilltar”;
- d) “Sekretar i parë”;
- dh) “Sekretar i dytë”;
- e) “Sekretar i tretë”;
- ë) “Atashe”.

3. Gradat konsullore në Shërbimin e Jashtëm janë:

- a) “Konsull i përgjithshëm”;
- b) “Konsull”;
- c) “Zëvendëskonsull”;
- ç) “Agjent konsullor”.



Neni 55

Dhënia e gradave diplomatike personale

1. Diplomatët e karrierës i marrin gradat diplomatike personale njëra pas tjetrës. Kriteret në dhënie e një grade diplomatike janë:

- a) plotësimi i afateve të parashikuara në nenin 56 të këtij ligji;
- b) vlerësimi i punës;
- c) kualifikimet profesionale brenda ose jashtë vendit;
- ç) kalimi me sukses i testimit të parashikuar në pikën 4 të këtij neni.

2. Grada “Atashe” përfitohet me konfirmimin e statusit të diplomatit të karrierës sipas nenit 46, pika 4, të këtij ligji.

3. Gradat nga “Sekretar i tretë” deri “Ministër fuqplotë” propozohen nga KKDD-ja sipas përcaktimeve të parashikuara në rregulloren e Shërbimit të Jashtëm.

4. Grada diplomatike personale “Këshilltar” përfitohet pas kalimit me sukses të testimit nga KKDD-ja dhe trajnimit përkatës të organizuar nga AD-ja. Mënyra e kryerjes së këtij testimi përcaktohet në rregulloren e Shërbimit të Jashtëm.

5. Për përfitimin e gradës “Ministër këshilltar”, përveç kushteve të pikës 1 të këtij neni, kandidati duhet të ketë të paktën 3 vjet përvojë në poste drejtuese, si dhe të ketë shërbyer të paktën një herë në Misionin diplomatik apo postin konsullor.

6. Për përfitimin e gradës “Ministër fuqplotë”, përveç kushteve të pikës 1 të këtij neni, kandidati duhet të ketë të paktën 6 vjet përvojë në poste drejtuese, si dhe të ketë shërbyer të paktën një herë në pozicionin e kreut të misionit diplomatik apo postit konsullor.

7. Diplomatët e përfitojnë gradën “Ambasador” pasi të kenë fituar njëra pas tjetrës të gjitha gradat diplomatike sipas këtij ligji dhe të kenë ushtruar detyrën e kreut të misionit diplomatik ose postit konsullor të paktën tre herë, por jo më pak se 10 vjet gjithsej.

8. Ministri, bazuar në propozimin e KKDD-së, i propozon Presidentit të Republikës dhënie e gradës personale “Ambasador” diplomatit të karrierës që përmbush kriteret e parashikuara në pikën 7 të këtij neni.

9. Numri maksimal i ambasadorëve, ministrave fuqplotë dhe ministrave këshilltarë përcaktohet në rregulloren e Shërbimit të Jashtëm.

Neni 56

Afatet për përfitimin e gradave diplomatike

1. Periudha minimale për kalimin e diplomatit të **karrierës** nga një gradë në një tjetër më të lartë është:

- | | |
|--|--|
| a) nga “Atashe” në “Sekretar i tretë” | 2 vjet; |
| b) nga “Sekretar i Tretë” në “Sekretar i dytë” | 3 vjet dhe 5 vjet nga marrja e gradës “Atashe”; |
| c) nga “Sekretar i dytë” në “Sekretar i parë” | 3 vjet dhe 8 vjet nga marrja e gradës “Atashe”; |
| ç) nga “Sekretar i parë” në “Këshilltar” | 4 vjet dhe 12 vjet nga marrja e gradës “Atashe”; |
| d) nga “Këshilltar” në “Ministër këshilltar” | 4 vjet dhe 16 vjet nga marrja e gradës “Atashe”; |
| dh) nga “Ministër këshilltar” në “Ministër fuqplotë” | 4 vjet dhe 20 vjet nga marrja e gradës “Atashe”; |
| e) nga “Ministër fuqplotë” në “Ambasador” | 4 vjet dhe 24 vjet nga marrja e gradës “Atashe”. |

2. Përjashtim nga afatet e pikës 1 të këtij neni, bëhet për diplomatët e pranuar sipas nenit 46, pika 5, të këtij ligji, që kanë eksperiencë në organizatat ndërkombëtare publike, të cilëve periudha e punës në këto organizata u njihet për efekt të përlogaritjes së gradës diplomatike personale.

Neni 57

Barasvlera e gradave

Në poste dhe detyra konsullore diplomatët emërohen me grada konsullore. Kalimi nga grada diplomatike në atë konsullore bëhet duke respektuar barasvlerën e gradave si më poshtë:

- | | |
|---------------------------|----------------------------------|
| a) Konsull i Përgjithshëm | “Ministër këshilltar”; |
| b) Konsull | “Sekretar i parë ose i dytë”; |
| c) Zëvendëskonsull | “Sekretar i dytë ose i tretë”; |
| d) Agjent konsullor | “Sekretar i tretë” ose “Atashe”. |



Neni 58 Të drejtat

Përveç të drejtave të parashikuara nga ligji për nëpunësin civil, diplomati i karrierës ka të drejtë:

- a) të gëzojë statusin e diplomatit të karrierës;
- b) të përfitojë gradë diplomatike personale;
- c) të mbajë funksione në ministri, në misionet diplomatike ose postet konsullore në përputhje me gradën diplomatike personale;
- ç) të përfitojë nga imunitetet dhe lehtësitë që i jep statusi i diplomatit, në përputhje me aktet dhe të drejtën ndërkombëtare, gjatë periudhës kur është i emëruar në misionin diplomatik ose postin konsullor;
- d) të përfitojë nga kualifikimet dhe trajnimet e ofruara nga ministria, nga AD-ja ose institucionet e tjera në bashkëpunim ose me pëlqimin e ministrisë;
- dh) të përfitojë trajtim financiar në përputhje me statusin e tij;
- e) të mbajë dhe të përdorë pasaportë diplomatike gjatë ushtrimit të funksioneve zyrtare.

Neni 59 Detyrimet

Përveç detyrimeve të parashikuara nga ligji për nëpunësin civil, diplomati ka detyrimet e mëposhtme:

- a) të mbrojë interesat e shtetit dhe të shtetasve ose personave juridikë shqiptarë në shtetin ose organizatën ku është akredituar dhe kryen funksionet e tij;
- b) të ushtrojë me ndershmëri dhe korrektësi funksionet dhe detyrat e ngarkuara në përputhje me Kushtetutën, me aktet ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë, me këtë ligj, si dhe me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore;
- c) të mbajë përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e veprimeve gjatë kryerjes së detyrës dhe, kur nuk është i bindur për ligjshmërinë e urdhrave dhe të vendimeve që zbaton, të njoftojë nivelet urdhërdhënëse dhe nivelet eprorë të këtyre të fundit;
- ç) të mos bëjë pjesë në asnjë parti, organizatë ose shoqatë politike dhe të mos marrë pjesë në veprimtaritë e organizuara prej tyre;
- d) të mbajë në të gjitha rrethanat një qëndrim moral të denjë dhe të paqortueshëm;
- dh) të mos bëjë deklarime publike që bien ndesh me politikën e jashtme të shtetit shqiptar;

e) të respektojë ligjet e shtetit ku është akredituar dhe të mos përfshihet në veprimtari, të cilat mund të vlerësohen si ndërhyrje në punët e brendshme të këtij shteti;

ë) të ushtrojë veprimtarinë e tij në vendin ku është akredituar në përputhje me imunitetet dhe privilegjet që gëzon si anëtar i trupit diplomatik;

f) të mos ushtrojë në shtetin ku është akredituar veprimtari tregtare ose çdo veprimtari tjetër fitimprurëse për llogari të tij, familjarëve të tij ose personave të tretë;

g) të zbatojë rregullat për informacionin e klasifikuar edhe pas largimit nga Shërbimi i Jashtëm, si dhe të sigurojë ruajtjen e të dhënave dhe të informacioneve që i janë besuar;

gj) të shmangë çdo konflikt ndërmjet interesit të tij privat dhe interesit publik në ushtrimin e detyrës në shërbimin civil në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi.

Neni 60 Trajtimi financiar i personelit të Shërbimit të Jashtëm

1. Paga bruto e diplomatëve të karrierës, të cilët punojnë në ministri, caktohet në bazë të gradës diplomatike personale dhe funksionit që ata kryejnë.

2. Paga bruto e diplomatit të emëruar pranë misioneve diplomatike dhe posteve konsullore përcaktohet në bazë të gradës diplomatike të emërimit.

3. Diplomati i emëruar në misionin diplomatik apo postin konsullor përfiton kompensim financiar bazuar në nivelin e jetesës në shtetin pritës.

4. Diplomati i emëruar në misionin diplomatik apo postin konsullor përfiton kompensim financiar kur:

- a) ushtron detyrën në zona të klasifikuara me rrezikshmëri të lartë;
- b) ushtron funksione/detyra të veçanta, me natyrë apo rëndësi specifike.

5. Ministria mbulon shpenzimet për sigurimet e detyrueshme sipas legjislacionit në fuqi, shpenzimet për sigurimin bazë të shëndetit në vendin pritës, si dhe sigurimin e jetës së diplomatit dhe anëtarëve të familjes në rastet kur diplomati e ushtron funksionin në zona të klasifikuara me rrezikshmëri të lartë, për sa kohë vazhdon situata e rrezikshmërisë së lartë.

6. Diplomati të emëruar në misionin diplomatik apo postin konsullor i mbulohet nga ministria



shpenzimet për transportin, akomodimin dhe disa shpenzime të tjera të domosdoshme në realizimin e funksionit të tij.

7. Paga bruto e diplomatit sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, kompensimi financiar sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni, përcaktimi i zonave të klasifikuara me rrezikshmëri të lartë, kohëzgjatja e tyre, funksionet/detyrat specifike sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni, si dhe rregullat dhe standardet për realizimin e shpenzimeve sipas pikës 6 të këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 61

Trajtimi i familjeve të personelit të misionit diplomatik dhe postit konsullor

1. Anëtarët e familjes së diplomatit gëzojnë të drejtën e mbajtjes së pasaportës diplomatike.

2. Ministria mbulon shpenzimet për sigurimin e shëndetit për anëtarët e familjes së diplomatit.

3. Bashkëshortit/es që shoqëron diplomatin në detyrë në misionin diplomatik ose postin konsullor, koha e qëndrimit jashtë shtetit i njihet për efekt të vjetërsisë në punë. Për këtë periudhë, bashkëshorti /ja e diplomatit përfiton pagesën e kontributeve të sigurimeve të detyrueshme, të llogaritur mbi bazën e pagës që merrte përpara se t'i bashkohej diplomatit në këtë detyrë. Në rastet kur bashkëshorti/ja nuk ka qenë në marrëdhënie pune, si pagë referuese do të merret paga minimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Bashkëshorti/ja e diplomatit, që e shoqëron atë në detyrë në misionin diplomatik ose postin konsullor dhe që përgjatë mandatit të diplomatit nuk përfiton të ardhura punësimi, përfiton shpërblim mujor me vlerën 50 për qind të pagës së gradës “Atashe”, të emëruar në vendin pritës. Çdo fëmijë deri në 23 vjeç, që jeton me diplomatin në shtetin pritës, përfiton shpërblim mujor me vlerën 20 për qind të pagës së gradës “Atashe”, të emëruar në vendin pritës, me përjashtim të rasteve kur është në marrëdhënie pune.

5. Ministria mbulon sigurimin e shëndetit në udhëtim për anëtarët e familjes së diplomatit.

6. Bashkëshorti/ja dhe fëmijët madhorë, që shoqërojnë diplomatin e emëruar në misionin diplomatik ose postin konsullor, kanë të drejtë të punësohen në shtetin pritës në rastet kur ky punësim parashikohet me marrëveshje dypalëshe që Republika e Shqipërisë ka lidhur me shtetin pritës

ose kur lejohet nga shteti në fjalë. Diplomati njofton kreun e misionit diplomatik ose postit konsullor për këtë. Kreu i misionit diplomatik ose postit konsullor njofton ministrinë për këtë punësim. Bashkëshorti /ja dhe fëmijët madhorë të punësuar nuk përfitojnë shpërblimin e parashikuar në pikën 4 të këtij neni.

7. Bashkëshorti/ja, që në kohën e emërimit të diplomatit në detyrë në misionin diplomatik ose postin konsullor është i/e punësuar në shërbimin civil, pezullohet nga shërbimi civil për kohëzgjatjen e qëndrimit të bashkëshortit/es në misionin diplomatik ose postin konsullor. Në përfundim të afatit, përveçse kur vendoset përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, ai/a jo rikthehet në pozicionin e mëparshëm të punës ose në rast se pozicioni i mëparshëm është i plotësuar përfundimisht, ai/a jo transferohet në një vend tjetër të së njëjtës kategori. Në rast se kjo është e pamundur, ai/a jo regjistrohet në një listë, e cila administrohet nga njësia përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil. Qëndrimi në këtë listë vazhdon deri në sistemimin në një pozicion të rregullt në shërbimin civil.

8. Pika 7 e këtij neni zbatohet edhe për rastet e tjera kur marrëdhëniet e punësimit të bashkëshortit/es së diplomatit me institucionin publik rregullohen nga legjislacioni i ndryshëm nga ai për nëpunësin civil.

9. Personeli administrativ teknik dhe i shërbimit i misionit diplomatik ose postit konsullor, si dhe anëtarët e familjeve të tyre, që nuk janë personel vendas, pajisen me pasaportë shërbimi dhe përfitojnë të drejtat e parashikuara në pikat 2, 3, 5, 6 dhe 7 të këtij neni.

10. Ministria mbulon financimin e arsimit për parashikollor dhe parauniversitar të fëmijëve të diplomatëve të emëruar në misionin diplomatik ose postin konsullor, si dhe të personelit teknik, administrativ dhe të shërbimit që nuk bën pjesë në kategorinë e parashikuar në nenin 42, pika 11, të këtij ligji. Financimi i këtij arsimit bëhet në rastet kur:

a) arsimi publik në vendin ku është akredituar misioni diplomatik ose posti konsullor është me pagesë; ose

b) gjuha e arsimit në shkollat publike nuk është anglisht, frëngjisht, italisht ose gjermanisht.

11. Mënyra, kriteret dhe masa e financimit, të parashikuara në këtë nen, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.



Neni 62

Humbja e jetës së diplomatit apo anëtarëve të familjes së tij

Nëse gjatë ushtrimit të detyrës diplomati apo anëtarë të familjes së tij humbin jetën, ministria mbulon plotësisht shpenzimet e transportit dhe të ceremonisë së varrimit.

KREU VII

PEZULLIMI, PËRGJEGJËSIA DHE MASAT DISIPLINORE

Neni 63

Pezullimi

1. Diplomati pezullohet nga marrëdhënia me Shërbimin e Jashtëm për shkaqet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil, si dhe kur ndaj tij ka filluar një procedim penal nga shteti pritës.

2. Në rastin kur çështja penale pushohet ose kur me vendim gjyqësor të formës së prerë personi deklarohet i pafajshëm, nëpunësi rikthehet në Shërbimin e Jashtëm dhe njëkohësisht rifiton statusin, pagën dhe çdo të drejtë tjetër të ndërprerë që nga çasti i pezullimit.

Neni 64

Përgjegjësia disiplinore

1. Diplomati, si dhe çdo nëpunës civil i Shërbimit të Jashtëm përgjigjet për shkeljet e kryera gjatë ushtrimit të funksionit dhe realizimit të detyrave të ngarkuara në përputhje me rregullat e përcaktuara nga legjislacioni për nëpunësin civil, ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Përveç parashikimeve të legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil, konsiderohet shkelje shumë e rëndë mospërmbyllja e detyrimeve të diplomatit të parashikuara në nenin 59 të këtij ligji.

3. Përgjegjësia disiplinore e çdo nëpunësi civil të Shërbimit të Jashtëm përcaktohet sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil.

4. Përgjegjësia disiplinore e diplomatit përcaktohet nga KKDD-ja, që i propozon ministrit dhënien e masës disiplinore në përputhje me legjislacionin në fuqi për nëpunësin civil, këtë ligj dhe aktet nënligjore të tij.

5. Procedurat e dhënies së masave disiplinore përcaktohen në legjislacionin në fuqi për nëpunësin civil.

Neni 65

Masat disiplinore

1. Masat disiplinore ndaj diplomatit jepen në përputhje me shkeljet e parashikuara në legjislacionin në fuqi për nëpunësin civil.

2. Përveç masave disiplinore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil, ndaj diplomatit që kryen shkelje shumë të rënda apo të rënda mund të merren edhe këto masa:

a) për shkelje shumë të rënda, largim nga Shërbimi i Jashtëm;

b) për shkelje të rënda:

i. pezullim nga e drejta e ngritjes në gradë për një periudhë deri në 2 vjet;

ii. rënie në gradë.

KREU VIII

NËPUNËSIT CIVILË DHE PERSONELI TEKNIK, ADMINISTRATIV DHE I SHËRBIMIT

Neni 66

Statusi i nëpunësve civilë

1. Nëpunësit civilë në ministri, që nuk gëzojnë statusin e diplomatit, kryejnë detyra në sektorët e auditit dhe të financës, të marrëdhënieve juridike të brendshme dhe përfaqësimit gjyqësor, të administrimit të pasurive të paluajtshme, përpunimit të të dhënave, ndërlidhjes, komunikimit, teknologjisë së informacionit, në çështje administrative. Për këta nëpunës zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Nëpunësi civil në ministri, përveç rasteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil, e ndërpret marrëdhënien e punës kur gjendet në kushtet e parashikuara në shkronjat “c” dhe “ç” të nenit 53 të këtij ligji.

3. Nëpunësi civil në ministri ka të drejtë që gjatë ushtrimit të funksioneve të tij të përdorë pasaportë shërbimi.



Neni 67

Statusi i personelit teknik, administrativ dhe të shërbimit

1. Personel teknik, administrativ dhe i shërbimit në ministri konsiderohet kategoria e punonjësve, të cilët kryejnë detyra në sektorët ndihmës, të mirëmbajtjes dhe të mbështetjes, statusi i të cilëve rregullohet sipas dispozitave të Kodit të Punës.

2. Personeli teknik dhe personeli i shërbimit në ministri kanë të drejtë që gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre të përdorin pasaportë shërbimi.

**KREU IX
DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 68

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 10, pika 6; 12; 13; 19; 20, pika 2; 21, pika 7; 25, pikat 1 dhe 3; 28, pika 5; 29, pika 3; 30, pika 3; 31, pika 3; 32, pika 5; 33, pika 5; 35, pika 7; 42, pikat 2 dhe 4; 60, pika 7, dhe 61, pika 11, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri të miratojë aktet nënligjore në zbatim të nenit 25, pika 2, të këtij ligji.

3. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të gjithë diplomatët në shërbim duhet t'i nënshtrohen një procedure transparente, konkurruese dhe objektive vlerësimi profesional të bazuar në performancën në Shërbimin e Jashtëm, integritetin etiko-profesional dhe kualifikimet në përputhje me procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për nëpunësin civil, këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

4. Diplomatëve të karrierës, të cilët nuk kanë përfituar në kohën e duhur gradat personale, u përlllogaritet për efekt të marrjes së gradës personale periudha kohore nga marrja e gradës “Atashe” ose plotësimi i afatit për marrjen e kësaj grade. Kjo dispozitë aplikohet vetëm një herë në mbledhjen e parë të KKDD-së pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas parashikimeve të nenit 22, pikat 1, shkronja “a” dhe nenit 55, pika 4, të këtij ligji.

Neni 69

Shfuqizime

Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë” dhe ligji nr. 8372, datë 9.7.1998, “Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike ose konsullore” shfuqizohen.

Neni 70

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.2.2026.

Shpallur me dekretin nr. 142, datë 17.3.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET**Nr. 142, datë 17.3.2026****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 24/2026, “Për Shërbimin e Jashtëm në Republikën e Shqipërisë”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

**VENDIM
Nr. 43/2026**

**PËR MOSMIRATIMIN NË PARIM TË
PROJEKTLIGJIT “PËR NJË NDRYSHIM
NË LIGJIN NR. 9975, DATË 28.7.2008,
“PËR TAKSAT KOMBËTARE”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, e 83, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 38, pika 6, e 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin në parim të projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, ‘Për taksat kombëtare’”, i ndryshuar, nismë deputeti.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 5.3.2026.

VENDIM
Nr. 44/2026**PËR MOSMIRATIMIN NË PARIM TË
PROJEKTLIGJIT “PËR NJË NDRYSHIM
NË LIGJIN NR. 68/2017, ‘PËR
FINANCAT E VETËQEVERISJES
VENDORE’”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, e 83, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 38, pika 6, e 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin në parim të projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 68/2017, ‘Për financat e vetëqeverisjes vendore’”, i ndryshuar, nismë deputeti.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 5.3.2026.

KRYETAR
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 46/2026**PËR KËRKESËN E PROKURORISË SË
POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT
DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR PËR
DHËNIEN E AUTORIZIMIT
NGA KUVENDI PËR ARRESTIMIN/
HEQJEN E LIRISË SË DEPUTETES
BELINDA BALLUKU NËPËRMJET
ZËVENDËSIMIT TË MASËS SË
SIGURIMIT PERSONAL**

Në mbështetje të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, nenit 288, të Kodit të Procedurës Penale dhe të nenit 118, pikat 4, dhe 5, nenit 55, të Rregullores së Kuvendit, me rekomandim të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për dhënie e autorizimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për arrestimin/heqjen e lirisë së deputetes Belinda Balluku nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit personal.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 12.3.2026.

REZOLUTË**PËR SHPALLJEN E REPUBLIKËS
ISLAMIKE TË IRANIT SI SHTET
SPONSOR I TERRORIZMIT DHE
SHTET QË PËRDOR MJETE
TERRORISTE**

Duke qenë se Republika e Shqipërisë është fuqimisht e përkushtuar ndaj parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara, së drejtës ndërkombëtare dhe mbrojtjes së paqes dhe sigurisë ndërkombëtare;



Duke qenë se terrorizmi në të gjitha format dhe shfaqjet e tij përbën një nga kërcënimet më serioze ndaj paqes ndërkombëtare, sigurisë dhe shoqërive demokratike;

Duke qenë se raporte të besueshme dhe vlerësime ndërkombëtare kanë dokumentuar në mënyrë të përsëritur përfshirjen e autoriteteve të Republikës Islamike të Iranit në financimin, trajnimin, armatosjen dhe drejtimin e grupeve dhe organizatave të armatosura joshtetërore të shpallura si entitete terroriste në disa rajone;

Duke qenë se Republika Islamike e Iranit përmes institucioneve të saj shtetërore, përfshirë Gardën Revolucionare Islamike (IRGC) dhe strukturat e lidhura me të, ka mbështetur dhe koordinuar aktivitete që destabilizojnë vende në Lindjen e Mesme dhe më gjerë;

Duke qenë se Republika e Shqipërisë ka qenë vetë objekt i veprimeve armiqësore në hapësirën kibernetike, përfshirë sulmin e rëndë kibernetik ndaj institucioneve shtetërore shqiptare në vitin 2022, i atribuar strukturave të lidhura me Republikën Islamike të Iranit, si dhe përpjekjet e ditëve të fundit për sulme kibernetike ndaj sistemeve të Kuvendit të Shqipërisë;

Duke qenë se aktet e dhunës dhe të agresionit, përfshirë sulmet kibernetike kundër institucioneve shtetërore, infrastrukturës kritike dhe shteteve sovranë përbëjnë shkelje të së drejtës ndërkombëtare dhe mund të përbëjnë forma të terrorizmit;

Duke qenë se përdorimi sistematik i frikësimit, i grupeve të armatosura *proxy*, si dhe i mjeteve hibride për të përhapur frikë dhe destabilizim është i papajtueshëm me normat e marrëdhënieve paqësore ndërkombëtare;

Duke qenë se Republika e Shqipërisë, si anëtare e NATO-s dhe vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, ka në themel të politikës së saj të jashtme dhe të sigurisë parimet e solidaritetit demokratik, shtetit të së drejtës dhe mbrojtjes së paqes dhe stabilitetit ndërkombëtar;

Duke qenë se populli dhe institucionet shqiptare mbeten të përkushtuara në luftën kundër terrorizmit në të gjitha format e tij dhe në mbajtjen përgjegjëse të atyre që sponsorizojnë ose kryejnë akte terrori,

Kuvendi i Shqipërisë:

1. Dënon me termat më të ashpër veprimet e Qeverisë së Republikës Islamike të Iranit që mbështesin, mundësojnë ose kryejnë akte

terrorizmi, operacione hibride dhe aktivitete destabilizuese në rajone të ndryshme të botës, si dhe shpreh solidaritetin e plotë me vendet mike të Gjirit Arabik dhe me Turqinë, të cilat janë shënjestuar nga aktiviteti terrorist i sponsorizuar nga Qeveria e Republikës Islamike të Iranit.

2. Dënon sulmet kibernetike të kryera kundër institucioneve të Republikës së Shqipërisë, përfshirë sulmin e vitit 2022 ndaj infrastrukturës shtetërore dhe përpjekjet e fundit për ndërhyrje në sistemet e Kuvendit të Shqipërisë.

3. Shpall Republikën Islamike të Iranit si shtet sponsor të terrorizmit dhe si shtet që përdor mjete terroriste në ndjekje të objektivave të tij të politikës së jashtme.

4. Dënon aktivitetet e Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) dhe entiteteve të lidhura me të për rolin e tyre në mbështetjen e organizatave terroriste, forcave të armatosura përfaqësuese dhe operacioneve destabilizuese.

5. I bën thirrje qeverisë së Republikës së Shqipërisë, që:

- të forcojë masat kombëtare dhe ndërkombëtare për të luftuar terrorizmin e sponsorizuar nga shtetet dhe kërcënimet kibernetike;

- të bashkëpunojë ngushtë me vendet aleate dhe partnere në parandalimin dhe luftimin e financimit të terrorizmit dhe aktiviteteve të lidhura me strukturat shtetërore iraniane;

- të mbështesë nismat në organizatat ndërkombëtare që synojnë përgjegjshmërinë për aktet e terrorizmit, sulmet kibernetike dhe shkeljet e së drejtës ndërkombëtare;

- të shpallë menjëherë Gardën Revolucionare Islamike (IRGC) si organizatë terroriste,

- të shpallë, gjithashtu, Hezbollah si një organizatë terroriste *proxy* të Republikës Islamike të Iranit, duke iu bashkuar Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Gjermanisë, Holandës dhe një numri shtetesh anëtare të BE-së, si dhe vende të tjera, të cilat e kanë ndërmarrë më parë këtë përcaktim.

6. U bën thirrje vendeve demokratike, organizatave ndërkombëtare dhe partnerëve të Shqipërisë që të shqyrtojnë masa të koordinuara kundër terrorizmit të sponsorizuar nga shtetet dhe të forcojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në luftën kundër këtyre kërcënimeve.

7. Rikonfirmon përkushtimin e palëkundur të Shqipërisë ndaj paqes ndërkombëtare, vlerave



demokratike dhe mbrojtjes së civilëve nga aktet e terrorit.

8. Udhëzon që kjo rezolutë t'u përcillet qeverisë së Republikës së Shqipërisë, qeverive aleate, Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë përkatës.

Miraturar në datën 17.3.2026.

KRYETAR
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 155, datë 19.3.2026

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Anisa Ruseti emërohet zëvendësministër i Punëve të Brendshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 156, datë 19.3.2026

PËR PROPOZIMIN KUVENDIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
TË NJË ANËTARI PËR KËSHILLIN
MBIKËQYRËS TË BANKËS
SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "b", të pikës 2, të nenit 44, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të kandidaturës së znj. Olta Rushaj, si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 157, datë 19.3.2026

PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E QENDRËS PËR
HAPJE DHE DIALOG

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës për Hapje dhe Dialog, "COD" (shkurtesa e emrit në anglisht "Center for Openness and Dialogue"), si një institucion juridik publik, në varësi të Kryeministrit, me seli në Tiranë.

2. COD-i është institucion buxhetor dhe financohet nga:

- a) buxheti i shtetit;
- b) burime të tjera të ligjshme.

3. COD-i ka për mision promovimin dhe zhvillimin e një shoqërie të hapur dhe të institucioneve më pranë qytetarëve, shoqërisë civile dhe aktorëve të fushës së shkencës dhe artit, i cili realizohet nëpërmjet mbështetjes së projekteve dhe programeve përkatëse.

II DETYRAT FUNKSIONALE TË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
QENDRËS PËR HAPJE DHE DIALOG



COD-i, për të realizuar misionin, përcaktuar në pikën 3, të kreut I, të këtij vendimi, kryen detyrat e mëposhtme:

a) Bashkëpunon me ministrinë e linjës, institucionet e varësisë, shoqërinë civile, përfaqësitë e huaja, institucionet ndërkombëtare të shkencës, të arsimit, të artit dhe të kulturës për mbështetjen dhe promovimin e një imazhi të ri për vendin tonë dhe rajonin, si simbole të bashkëjetesës paqësore e udhërrëfyes në ndërtimin e saj.

b) Realizon dhe financon projekte inovative të studentëve, studiuesve, artistëve, kuratorëve, gazetarëve e aktivistëve të shoqërisë civile, për sigurimin e mjeteve e të mundësive për ndikimin e politikave publike dhe krijimin e një dialogu të gjerë që siguron institucione të hapura, transparente e më pranë qytetarëve.

c) Zbaton dhe kontribuon në strategjitë dhe politikat e qeverisë në mbështetje të studiuesve, artistëve, qendrave të ekselencës, qendrave të hulumtimit dhe komunikimit.

ç) Zbaton strategjitë qeveritare dhe kontribuon në promovimin dhe institucionalizimin e dialogut ndërmjet grupeve sociale, kulturore, etnike, fetare dhe politike, si pjesë përbërëse e kulturës demokratike në rajon.

d) Në kuadër të strategjive qeveritare, krijon dhe zhvillon instrumente mbështetëse, si dhe nxit e mbështet nisma inovative në fushën e dialogut, bashkëpunimit dhe bashkëjetesës.

dh) Vlerëson dhe ofron mbështetje teknike për hartimin, rishikimin dhe sigurimin e përputhshmërisë së strategjive qeveritare me misionin e përcaktuar në shkronjën “a” të kësaj pike.

e) Nxiti dhe promovon bashkëpunimin me sektorin privat për mbështetjen e misionit të përcaktuar në pikën 3, të kreut I, të këtij vendimi, si dhe për zhvillimin e iniciativave inovative në fushën e artit, shkencës dhe kërkimit.

ë) Zhvillon dhe koordinon bashkëpunime dypalëshe dhe shumëpalëshe me institucione të sektorit publik dhe privat, vendës dhe të huaj, në funksion të realizimit të misionit të përcaktuar në pikën 3, të kreut I, të këtij vendimi.

f) Kontribuon në krijimin dhe zhvillimin e kushteve për bashkëpunim profesional dhe shkëmbim ekspertize ndërmjet politikëbërësve, akademikëve, ekspertëve ndërkombëtarë dhe personaliteteve të fushës së artit dhe kulturës, në

funksion të realizimit të misionit të përcaktuar në pikën 3, të kreut I, të këtij vendimi.

g) Kontribuon, në përputhje me misionin e institucionit, në hartimin dhe përmirësimin e politikave dhe kuadrit ligjor në fushën e artit, arsimit, rinisë dhe mbështetjes së grupeve vulnerabël.

III ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I QENDRËS PËR HAPJE DHE DIALOG (COD)

1. COD-i e shtrin veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në formën e drejtorisë së përgjithshme, në nivel qendror.

2. COD-i drejtohet nga drejtori i përgjithshëm i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e tij, përfaqëson qendrën në marrëdhënie me të tretët dhe përgjigjet përpara Kryeministrit.

3. Drejtori i përgjithshëm emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga Kryeministri.

4. Drejtori i përgjithshëm duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të ketë diplomë të nivelit “Master shkencor” apo “Master profesional” të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vjet akademikë, në një nga degët e arsimit të lartë;

ç) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna;

d) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

5. Drejtori i përgjithshëm lirohet nga detyra kur:

a) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor apo merr formë të prerë vendimi gjyqësor për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar;

b) plotëson kushtet për pension pleqërie;

c) i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike me vendim gjyqësor të formës së prerë;

ç) nuk përmbush objektivat strategjike të institucionit;

d) gjendet në një situatë konflikti të vazhdueshëm interesi;

dh) ristrukturohet institucioni;

e) jep dorëheqjen nga detyra.

6. Drejtori i përgjithshëm shkarkohet nga detyra, kur:

a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;



b) kryen shkelje të rënda gjatë detyrës;

c) ka performancë të dobët në ushtrimin e detyrës;

ç) kryen veprimtari që krijon konflikt interesash, në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesave;

d) mungon në detyrë, pa shkaqe të arsyeshme, për më shumë se 30 (tridhjetë) ditë në vijim/radhazi.

7. Struktura dhe organika e COD-it miratohen nga Kryeministri, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

8. Funksionimi i COD-it përcaktohet nëpërmjet rregullores së brendshme e cila përgatitet nga drejtori i përgjithshëm dhe miratohet nga Kryeministri, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm.

9. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të përgjithshëm, nëpunësve dhe punonjësve administrativë të COD-it rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

10. COD-i ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare. Stema e COD-it përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet: “Republika e Shqipërisë, Kryeministria, Qendra për Hapje dhe Dialog”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

11. Vula e COD-it ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. COD-i vijon funksionimin si pjesë e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje deri në fillimin e funksionimit të plotë të tij, moment në të cilin COD-i merr përsipër në mënyrë të pavarur ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi të përcaktuara me këtë vendim.

2. Ngarkohen Kryeministria, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje dhe Qendra për Hapje dhe Dialog (COD) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 158, datë 19.3.2026

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË
SË ADMINISTRIMIT, NGA BASHKIA
HIMARË TEK MINISTRIA E
EKONOMISË DHE INOVACIONIT,
TË PASURISË ME NR. 68/119/15, E
NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE
1739, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR. 433, DATË 8.6.2016, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË
BASHKIVE TË PYJEVE DHE
KULLOTAVE PUBLIKE, SIPAS LISTAVE
TË INVENTARIT DHE AKTUALISHT
NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË
MJEDISIT E TË ISH-KOMUNAVE/
BASHKIVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Bashkia Himarë tek Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, të pasurisë me nr. 68/119/15, e ndodhur në zonën kadastrale 1739, me sipërfaqe totale 2555 m², sipas kartelës së pasurisë dhe hartës kadastrale, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi hiqet nga inventari i pronave të paluajtshme publike të përcaktuara në vendimin nr. 433, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, të ndryshuar.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Bashkia Himarë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 1739008140

(Nga ____ , Në ____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 1739, Lloji i Pasurisë: KULLOTE, Nr. i Pasurisë: 68/119/15, Sipërfaqja Totale 2555 m2,
(Nga të Cilat Truall 0 m2; Ndërtesë 0 m2)

Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-136-(115-D), Numri i Pemëve: 0,
Adresa e Pasurisë: Bashkia HIMARE, Rruga GJILEK, Ndërtesa Nr. __, SH/K __, Apartamenti Nr. __

Vlera e Pasurisë:

Fillestare 1 Leke (Akti Nr. 1, Dt. 26/11/2025), Rivlerësim __ (Akti Nr. __, Dt. ____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: SHTET, Nr. Identifikimi/NIPT R0000000SH, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia __, Rruga __, Ndërtesa Nr. __, SH/K __, Apartamenti Nr. __

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Regjistrim i bashkimit, ose ndarjes të pasurisë së paluajtshme, Nr. 1, Datë: 26/11/2025

Regjistruar: Nr. 00002632, Datë: 26/11/2025

*Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. __, me Kod Unik ____

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: __, Nr. __, Datë: ____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: ____

Regjistruar: Nr. __, Datë: ____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: _____, Emërtimi i Aktit: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi: kjo pasuri vjen nga ndarja e pasuris 68/119

DREJTORI
Albion Koçi

Arten
Nelaj

Digitally signed by:
Arten Nelaj
Date: 2026.03.10
08:37:13 +02'00'

Albion
Koci

Digitally signed by:
Albion Koci
Date: 2026.03.10
08:38:11 +02'00'



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Vlorë
Date: 2026/03/10 20:38:57 +02'00'
H60804113C2026031020384942ASHK

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)



REPUBLIKA E SHQIPERISE AGJENCIA SHTETERORE E KADASTRES	
FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE	
ZONA KADASTRALE : 1739	KODI UNIK : 1739008140
NUMRI I PASURISË : 68/119/15	INDEX I HARTES : K-34-136-(115-C)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

Digitally signed by: Vanessa Bylo Date: 2025.12.05 03:26:15 +02'00'	Digitally signed by: Arten Nelaj Date: 2025.12.05 03:30:30 +02'00'	Digitally signed by: Erisad Jusufaj Date: 2025.12.05 06:14:07 +02'00'
---	--	---

DREJTORI :	Data e lëshimit : Nr Serial :	SHPJEGUES :
	Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Vlorë Date: 2025/12/05 15:27:37 +02'00' M01917011 D2025120515273050014	PARCELA NDERTESA

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Vlorë)

**VENDIM****Nr. 159, datë 19.3.2026****PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË
DHËNAVE SHTETËRORE “REGJISTRI
PËR EKZEKUTIMIN DHE VJELJEN
E GJOBAVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri për ekzekutimin dhe vjeljen e gjobave” të Sistemit të Qendëruar të Mbledhjes së Gjobave.

2. Institucioni administrues i bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri për ekzekutimin dhe vjeljen e gjobave” është Inspektorati i Përgjithshëm.

3. Të dhënat që përmban Regjistri për Ekzekutimin dhe Vjeljen e Gjobave ndahen në të dhëna parësore dhe në të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore:

i. Numri unik i identifikimit të gjobës.

b) Të dhëna dytësore:

i. Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile për të dhënat, si më poshtë:

- Emri;
- Emri i babait;
- Mbiemri;
- Numri personal;
- Datëlindja;
- Vendlindja;
- Gjinia;
- Shtetësia;
- Vendbanimi;
- Vendqëndrimi.

ii. Sistemi elektronik i gjobave të Policisë së Shtetit:

- Data;
- Ora;
- Adresa ku është vënë gjoba;
- Shkeljet ligjore;
- Vlera e gjobës;
- Masat plotësuese (heqje pikësh, heqje patente, pezullim patente).

iii. Sistemi e-Inspektimi:

- Institucioni (Inspektorati Qendror dhe ai vendor);

- Numri i vendimit përfundimtar (numër çështjeje);

- Data e vendimit;

- Subjekti;

- Shkelja ligjore;

- Dënimi administrativ gjobë (kryesore plotësues);

- Vlera e gjobës;

- Statusi i gjobës.

iv. Sistemi elektronik e-DPSHTRR për të dhënat që lidhen me të dhënat teknike të mjetit, duke përfshirë:

- numrin e regjistrimit;

- numrin e identifikimit të mjetit;

- llojin/tipin e mjetit;

- markën;

- emërtimin tregtar;

- ngjyrën;

- numrin e serisë së lejes së qarkullimit dhe të certifikatës së pronësisë;

- dokumentacionin vërtetues të gjendjes së mjetit.

v. Regjistri elektronik i tatimpaguesve i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për të dhënat e tatimpaguesit:

- NIPT-i.

vi. Regjistri tregtar për të dhënat, si më poshtë:

- Emri i subjektit;

- NUIS;

- Aktiviteti;

- Data e regjistrimit;

- Statusi i subjektit;

- Përshkrimi i objektit;

- Adresa e subjektit;

- Adresa elektronike e subjektit;

- Numri i kontaktit të subjektit;

- Administratori.

4. Regjistri për Ekzekutimin dhe Vjeljen e Gjobave, si bazë të dhënash, funksionon, administrohet e ndërvepron me bazat e tjera të të dhënave, në përputhje me pikën 9 të këtij vendimi.

5. Të dhënat e mbledhura nga Regjistri për Ekzekutimin dhe Vjeljen e Gjobave mund të përdoren për analiza dhe vlerësime. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave realizohet në përputhje me parimet e kriteret e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.



6. Të dhënat e Regjistrit për Ekzekutimin dhe Vjeljen e Gjobave përditësohen periodikisht nga struktura përgjegjëse, sa herë është e nevojshme apo ka ndryshime të këtyre të dhënave.

7. Përdoruesit e bazës së të dhënave janë të përcaktuar në 4 nivele:

- a) lexues;
- b) institucion shtetëror;
- c) administrator;
- ç) auditues.

8. Për çdo veprim në Regjistrin për Ekzekutimin dhe Vjeljen e Gjobave lidhur me aksesin, ndryshimin, korrigjimin, përhapjen e të dhënave personale, duhet të sigurohet gjurmueshmëria, me qëllim garantimin e konfidencialitetit e të integritetit, disponueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e sistemeve dhe të shërbimeve të përpunimit.

9. Baza e të dhënave të Regjistrit për Ekzekutimin dhe Vjeljen e Gjobave ndërvepron nëpërmjet shkëmbimit elektronik të të dhënave me bazën e të dhënave shtetërore:

- a) Regjistri tregtar;
- b) Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile;
- c) Sistemi elektronik i gjobave të Policisë së Shtetit;
- ç) Sistemi *e-Inspektimi*;
- d) Sistemi elektronik e-DPSHTRR;
- dh) Regjistri elektronik i tatimpaguesve;
- e) Regjistri i pronarëve përfitues.

10. Pagesa e gjobave do të bëhet *online* në portalin *e-Albania* nëpërmjet shërbimit të dedikuar elektronik, i ndërlidhur me platformën e pagesave elektronike, si dhe me mandatpagesë.

11. Ngarkohen Inspektorati i Përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe institucionet shtetërore përgjegjëse për vendosjen e masës administrative “gjobë” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 160, datë 19.3.2026

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 858, DATË 29.12.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE E TË DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6 e 29, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3, e aneksit nr. 3, që i bashkëlidhet vendimit nr. 858, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Lista e shteteve, shtetasit e të cilave hyjnë pa vizë për motive turistike në Republikën e Shqipërisë dhe me dokumentin “pasaportë” për një periudhë të kufizuar, nga data 15 prill deri më 31 dhjetor 2026.”.

Nr.	Shteti
1.	Arabia Saudite
2.	Katar

2. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 161, datë 19.3.2026**

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
DHE TË MASËS SË KOMPENSIMIT TË
USHTARAKUT TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, KUR EMËROHET OSE
KOMANDOHEËT NË DETYRË JASHTË
VENDBANIMIT TË TIJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 25, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i kriterëve dhe i masës së kompensimit të ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, kur emërohet ose komandohet në detyrë jashtë vendbanimit të tij.

2. Ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura, kur emërohet ose komandohet jashtë vendbanimit të tij, në rast se nuk i sigurohet transporti, strehimi apo nuk trajtohet me kompensim për qira banese nga Ministria e Mbrojtjes, përfiton kompensim për transport, si më poshtë vijon:

a) Nga 5 km deri në 25 km, në masën 4 400 (katër mijë e katërqind) lekë në muaj;

b) Nga 26 km deri në 50 km, në masën 8 800 (tetë mijë e tetëqind) lekë në muaj;

c) Nga 51 km deri në 100 km, në masën 13 200 (trembëdhjetë mijë e dyqind) lekë në muaj;

ç) Mbi 101 km, në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj.

3. Përfitimi i pagesës, sipas pikës 2 të këtij vendimi, ndërpritet kur:

a) ushtaraku emërohet në vendbanimin e tij;

b) përfundon periudha e komandimit jashtë vendbanimit të tij;

c) sistemohet me banesë në bashkinë/njësinë administrative, ku ndodhet vendi i shërbimit.

4. Për të përfituar pagesën, sipas pikës 2 të këtij vendimi, ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura paraqet, në strukturën ushtarake, ku emërohet ose komandohet, dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) Kërkesën me shkrim pranë njësisë shpenzuese, ku trajtohet financiarisht ushtaraku;

b) Fotokopjen e kartës së identitetit;

c) Vërtetimin nga organi publik përgjegjës, nëse ka banesë në pronësi ose në proces legalizimi në bashkinë/njësinë administrative, ku emërohet ose komandohet.

5. Struktura ushtarake, ku është emëruar ose komanduar ushtaraku aktiv:

a) bën vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur brenda 5 (pesë) ditëve punë;

b) njofton ushtarakun për rregullimin e pasaktësive ose mungesën e dokumentacionit dhe kërkon rregullimin/plotësimin e tyre;

c) në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit, i përcjell njësisë shpenzuese dokumentacionin për kompensim.

6. Me qëllim përfitimin e kompensimit të transportit sipas këtij vendimi, ushtaraku aktiv paraqet, çdo vit, dokumentacionin e përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, pranë strukturës ushtarake, ku është emëruar ose komanduar.

7. Ushtaraku i Forcave të Armatosura, që emërohet me detyrë jashtë vendbanimit të tij dhe në të njëjtën kohë transferon edhe familjen, përfiton transport falas për familjen dhe materialet e shtëpisë me mjetet e Ministrisë së Mbrojtjes.

8. Vendimi nr. 435, datë 25.6.2004, i Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe masën e kompensimit të ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, kur emërohet ose komandohet në detyrë jashtë vendbanimit të tij”, shfuqizohet.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

10. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 162, datë 19.3.2026****PËR MIRATIMIN E TAVANEVE
PËRGATITORE TË SHPENZIMEVE TË
PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
2027–2029**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2027–2029, sipas lidhjes nr. 1, “Tavanet e ministrive dhe institucioneve buxhetore”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



Tavanet përgatitore 2027–2029, SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE (NË 000/LEK)

Tab. 1

Viti 2027							Viti 2028							Viti 2029						
Kodi	Emërtimi i institucionit/Programit	Totali i shp. korrente	Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale	Totali i shpenzimeve buxhetore	Totali i shp. korrente	Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale	Totali i shpenzimeve buxhetore	Totali i shp. korrente	Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale	Totali i shpenzimeve buxhetore				
1	Presidenca	348,574	106,000	0	106,000	454,574	349,720	170,000	0	170,000	519,720	351,720	100,000	0	100,000	451,720				
01120	Veprimtaria e Presidentit	348,574	106,000	0	106,000	454,574	349,720	170,000	0	170,000	519,720	351,720	100,000	0	100,000	451,720				
2	Kuvendi	1,907,782	48,000	0	48,000	1,955,782	1,915,010	65,000	0	65,000	1,980,010	1,947,010	50,000	0	50,000	1,997,010				
01110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	760,477	48,000	0	48,000	808,477	763,420	65,000	0	65,000	828,420	765,420	50,000	0	50,000	815,420				
01120	Veprimtaria ligjvënëse	1,147,305	0	0	0	1,147,305	1,151,590	0	0	0	1,151,590	1,181,590	0	0	0	1,181,590				
3	Kryeministria	809,309	50,000	0	50,000	859,309	812,578	30,000	0	30,000	842,578	814,578	30,000	0	30,000	844,578				
01110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	809,309	50,000	0	50,000	859,309	812,578	30,000	0	30,000	842,578	814,578	30,000	0	30,000	844,578				
4	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit	39,637,109	1,283,960	533,000	1,816,960	41,454,069	40,417,852	1,470,617	533,000	2,003,617	42,421,469	41,084,104	1,372,000	533,000	1,905,000	42,989,104				
01110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	535,022	10,000	0	10,000	545,022	537,282	20,000	0	20,000	557,282	539,282	10,000	0	10,000	549,282				
01150	Mbështetje për inovacionin dhe teknologjinë	562,196	0	0	0	562,196	563,524	0	0	0	563,524	563,524	0	0	0	563,524				
04130	Mbështetje për zhvillim ekonomik	467,729	30,170	3,000	33,170	500,899	469,060	30,170	3,000	33,170	502,230	519,060	20,000	3,000	23,000	542,060				
04160	Mbështetje për Mbikëq. e tregut, infrast. e cilës. dhe pron. industr.	413,699	12,000	0	12,000	425,699	415,501	12,000	0	12,000	427,501	465,501	10,000	0	10,000	475,501				
10220	Sigurimi shoqëror	29,517,684	0	0	0	29,517,684	30,190,717	0	0	0	30,190,717	30,702,969	0	0	0	30,702,969				
10550	Tregu i punës	3,613,845	88,000	50,000	138,000	3,751,845	3,698,711	128,000	50,000	178,000	3,876,711	3,698,711	130,000	50,000	180,000	3,878,711				
04170	Inspektimi në Punë	288,570	2,000	0	2,000	290,570	289,929	2,000	0	2,000	291,929	289,929	2,000	0	2,000	291,929				
09240	Arsimi i Mesëm (profesional)	3,493,364	641,790	480,000	1,121,790	4,615,154	3,508,128	778,447	480,000	1,258,447	4,766,575	3,558,128	700,000	480,000	1,180,000	4,738,128				
06190	Strehimi	745,000	500,000	0	500,000	1,245,000	745,000	500,000	0	500,000	1,245,000	745,000	500,000	0	500,000	1,245,000				
5	Ministria e Bujësisë dhe Zhvillimit Rural	11,216,997	3,361,365	1,977,539	5,338,904	16,555,901	11,237,995	4,503,572	3,186,831	7,690,403	18,928,398	11,537,995	5,065,863	3,269,423	8,335,286	19,873,281				
01110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	595,288	4,000	0	4,000	599,288	597,546	4,000	0	4,000	601,546	597,546	4,000	0	4,000	601,546				
04220	Siguria ushqimore dhe mjedisi dhe konsumatori	2,453,665	190,502	80,708	271,210	2,724,875	2,463,237	383,209	90,000	473,209	2,936,446	2,513,237	385,000	90,000	475,000	2,988,237				
04240	Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujërës	1,127,624	2,240,000	0	2,240,000	3,367,624	1,130,059	2,739,500	0	2,739,500	3,869,559	1,180,059	2,750,000	0	2,750,000	3,930,059				
04250	Zhvillimi Rural dhe mbësht. prodh. bujq. blet. agroind. dhe market.	5,987,537	806,863	1,517,408	2,324,271	8,311,808	5,989,877	1,206,863	2,517,408	3,724,271	9,714,148	6,189,877	1,756,863	2,600,000	4,356,863	10,546,740				
04860	Këshilli dhe informacioni bujqësor	780,411	20,000	0	20,000	800,411	783,857	20,000	0	20,000	803,857	783,857	20,000	0	20,000	803,857				
05470	Menaxhimi i qëndrësive të tokës bujqësore	25,000	0	0	0	25,000	25,000	0	0	0	25,000	25,000	0	0	0	25,000				
04230	Mbështetje për peshkimin	247,472	100,000	379,423	479,423	726,895	248,419	150,000	579,423	729,423	977,842	248,419	150,000	579,423	729,423	977,842				
6	Ministria e Infrastruktursë dhe Energjisë	7,280,548	55,374,258	18,001,895	73,376,153	80,656,701	7,441,530	49,316,942	17,437,507	66,754,449	74,195,979	7,494,580	43,949,066	22,659,079	66,608,685	74,103,265				
01110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	757,741	11,000	0	11,000	768,741	760,521	13,000	0	13,000	773,521	762,521	5,000	0	5,000	767,521				
04520	Transporti rrugor	4,281,854	29,027,040	4,853,930	33,880,970	38,162,824	4,434,018	29,295,336	4,493,323	33,788,659	38,222,677	4,484,018	27,000,000	5,000,000	32,000,000	36,484,018				
04540	Transporti detar	187,524	14,848,116	10,000	14,868,116	15,035,640	188,440	8,000,000	10,000	8,010,000	8,198,440	189,440	6,000,000	10,000	6,010,000	6,199,440				
04550	Transporti hekurudhor	538,671	2,400,000	7,092,202	9,492,202	10,030,873	538,836	3,475,000	7,092,202	10,567,202	11,106,038	538,836	3,505,000	9,092,202	12,597,202	13,136,038				
04560	Transporti ajror	26,690	2,000	0	2,000	28,690	26,782	2,000	0	2,000	28,782	26,832	2,000	0	2,000	28,832				
04610	Mbështetje për rrjetet e komunikacionit	0	50,000	20,000	70,000	70,000	0	50,000	20,000	70,000	70,000	0	30,000	20,000	50,000	50,000				
06370	Furnizimi me ujë dhe kanalizime	500,603	8,267,102	3,012,914	11,280,616	11,780,619	501,145	7,761,102	2,812,914	10,574,016	11,075,161	501,145	6,761,102	5,327,809	12,088,911	12,590,056				
04320	Mbështetje për energjinë	123,948	500,000	3,000,000	3,500,000	3,623,948	124,244	441,504	3,000,000	3,441,504	3,565,748	124,244	441,504	3,200,000	3,641,504	3,765,748				
04430	Mbështetje për burimet natyrore	363,727	97,000	12,849	109,849	473,576	367,375	97,000	9,068	106,068	473,443	367,375	77,000	9,068	86,068	453,443				
04440	Mbështetje për industrinë	395,259	78,000	0	78,000	473,259	397,178	78,000	0	78,000	475,178	397,178	58,000	0	58,000	455,178				
06180	Planifikim urban	102,531	104,000	0	104,000	206,531	102,991	104,000	0	104,000	206,991	102,991	70,000	0	70,000	172,991				
10	Ministria e Financave	9,722,342	2,569,301	404,000	2,973,301	12,695,643	9,752,251	3,638,500	404,000	4,042,050	13,794,301	9,852,251	2,483,220	104,000	2,587,220	12,439,471				
01110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	1,088,518	145,547	400,000	545,547	1,634,065	1,093,600	179,830	400,000	579,830	1,673,430	1,093,600	25,000	100,000	125,000	1,218,600				
01120	Menaxhimi i shpenzimeve publike	521,959	0	0	0	521,959	524,327	0	0	0	524,327	524,327	0	0	0	524,327				
01130	Ekzekutimi i pagesave të ndryshme	604,000	2,200,000	0	2,200,000	2,804,000	604,000	3,200,000	0	3,200,000	3,804,000	604,000	2,200,000	0	2,200,000	2,804,000				
01140	Menaxhimi i të ardhurave tatimore	2,885,233	98,534	0	98,534	2,983,767	2,896,613	133,000	0	133,000	3,029,613	2,946,613	133,000	0	133,000	3,079,613				
01150	Menaxhimi i të ardhurave doganore	4,415,917	123,220	4,000	127,220	4,543,137	4,426,008	123,220	4,000	4,553,228	4,476,008	123,220	4,000	127,220	4,603,228	4,603,228				
01160	Lufta kundër transaksioneve financiare jologjore	206,715	2,000	0	2,000	208,715	207,703	2,000	0	2,000	209,703	207,703	2,000	0	2,000	209,703				
11	Ministria e Arsimit	59,999,438	5,274,000	600,000	5,874,000	65,873,438	60,293,265	5,874,000	750,000	6,624,000	66,917,265	60,593,265	6,445,000	750,000	7,195,000	67,788,265				
01110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	1,102,003	45,000	0	45,000	1,147,003	1,107,400	45,000	0	45,000	1,152,400	1,107,400	15,000	0	15,000	1,122,400				
09120	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	35,377,573	1,837,500	0	1,837,500	37,214,573	35,560,902	2,137,000	0	2,137,000	37,697,902	35,660,902	2,300,000	0	2,300,000	37,960,902				
09230	Arsimi i mesëm (i përgjithshëm)	10,447,998	1,762,000	0	1,762,000	12,209,998	10,502,932	1,862,000	0	1,862,000	12,364,932	10,602,932	2,100,000	0	2,100,000	12,702,932				
09450	Arsimi Universitar	11,850,000	980,000	300,000	1,280,000	13,130,000	11,900,000	980,000	300,000	1,280,000	13,180,000	11,950,000	980,000	300,000	1,280,000	13,230,000				
09770	Fonde për shkencën	1,221,864	650,000	300,000	950,000	2,171,864														



Viti 2027										Viti 2028										Viti 2029									
Kodi	Emërtimi i institucionit/Programit	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale		Totali i shp. kapitale	Totali i shpenzimeve buxhetore	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale		Totali i shp. kapitale	Totali i shpenzimeve buxhetore	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale		Totali i shp. kapitale	Totali i shpenzimeve buxhetore	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale		Totali i shp. kapitale	Totali i shpenzimeve buxhetore								
			Financim i brendshëm	Financimi i huaj				Financim i brendshëm	Financimi i huaj				Financim i brendshëm	Financimi i huaj				Financim i brendshëm	Financimi i huaj										
10430	Përkujdesja sociale	28,066,961	50,240		100,240	28,167,201	28,672,469	50,240		100,240	28,772,709	29,072,469	50,240		100,240	28,873,149	29,172,469	50,240		100,240	28,973,389	29,272,469							
01190	Rehabilitimi i të përndjekurve politikë	2,048,851	0	0	0	2,048,851	2,048,851	0	0	0	2,048,851	2,048,851	0	0	0	2,048,851	2,048,851	0	0	0	2,048,851	2,048,851							
14	Ministria e Drejtësisë	13,774,247	1,151,914	0	1,151,914	14,926,161	14,319,980	829,350	0	829,350	15,149,330	16,612,980	654,700	0	654,700	17,267,680	17,267,680	654,700	0	654,700	17,922,380	17,922,380							
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	651,614	595,000	0	595,000	1,246,614	653,887	197,500	0	197,500	851,387	673,887	27,500	0	27,500	701,387	701,387	27,500	0	27,500	728,887	728,887							
03310	Ndihma Juridike	130,706	2,000	0	2,000	132,706	131,137	2,000	0	2,000	133,137	131,137	2,000	0	2,000	135,137	133,137	2,000	0	2,000	137,137	135,137							
01120	Publikimet zyrtare	71,096	5,000	0	5,000	76,096	71,357	5,000	0	5,000	76,357	71,357	5,000	0	5,000	76,357	71,357	5,000	0	5,000	76,357	71,357							
01130	Mjekësia Ligjore	116,251	21,000	0	21,000	137,251	116,649	21,000	0	21,000	137,649	116,649	10,000	0	10,000	126,649	126,649	10,000	0	10,000	136,649	126,649							
03440	Sistemi i burgjeve	9,284,217	518,714	0	518,714	9,802,931	9,321,795	593,650	0	593,650	9,915,445	9,374,795	600,000	0	600,000	9,974,795	9,974,795	600,000	0	600,000	10,574,795	10,574,795							
03350	Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor	423,553	5,000	0	5,000	428,553	425,544	5,000	0	5,000	430,544	445,544	5,000	0	5,000	440,544	445,544	5,000	0	5,000	445,544	450,544							
01160	Shërbimet për qeshjet e brendshme	19,147	200	0	200	19,347	19,233	200	0	200	19,433	19,233	200	0	200	19,433	19,233	200	0	200	19,433	19,233							
01180	Shërbimi i Kërkimit dhe Kompensimit të Pronave	2,829,046	3,000	0	3,000	2,832,046	3,330,533	3,000	0	3,000	3,333,533	5,530,533	3,000	0	3,000	5,533,533	5,533,533	3,000	0	3,000	5,536,533	5,536,533							
03490	Shërbimi i Proves	248,617	2,000	0	2,000	250,617	249,845	2,000	0	2,000	251,845	249,845	2,000	0	2,000	251,845	249,845	2,000	0	2,000	251,845	249,845							
15	Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme	3,644,054	35,100	0	35,100	3,679,154	3,652,773	35,100	0	35,100	3,687,873	3,669,773	15,100	0	15,100	3,684,873	3,684,873	15,100	0	15,100	3,699,973	3,699,973							
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	359,994	35,100	0	35,100	395,094	361,165	35,100	0	35,100	396,265	363,165	15,100	0	15,100	378,265	378,265	15,100	0	15,100	393,365	393,365							
01120	Mbështetje diplomatike jashtë shteti	2,945,926	0	0	0	2,945,926	2,952,188	0	0	0	2,952,188	2,962,188	0	0	0	2,962,188	2,962,188	0	0	0	2,962,188	2,962,188							
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPI-së	338,134	0	0	0	338,134	339,420	0	0	0	339,420	344,420	0	0	0	344,420	344,420	0	0	0	344,420	344,420							
16	Ministria e Punëve të Brendshme	30,996,889	2,189,396	500,000	2,689,396	33,686,285	31,132,692	1,843,113	2,000,000	3,843,113	34,975,805	31,382,692	1,765,000	2,000,000	3,765,000	35,147,692	35,147,692	1,765,000	2,000,000	3,765,000	36,912,692	36,912,692							
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	1,721,983	64,793	0	64,793	1,786,776	1,730,085	118,000	0	118,000	1,888,085	1,730,085	120,000	0	120,000	1,850,085	1,850,085	120,000	0	120,000	1,970,085	1,970,085							
03140	Policia e Shtetit	25,215,109	1,979,603	500,000	2,479,603	27,694,712	25,324,048	1,580,113	2,000,000	3,580,113	28,904,161	25,524,048	1,600,000	2,000,000	3,600,000	29,124,048	29,124,048	1,600,000	2,000,000	3,600,000	30,724,048	30,724,048							
03150	Garda e Republikës	2,704,204	10,000	0	10,000	2,714,204	2,716,524	10,000	0	10,000	2,726,524	2,726,524	10,000	0	10,000	2,736,524	2,736,524	10,000	0	10,000	2,746,524	2,746,524							
01160	Prefekturat dhe funksionet e Delegruara të Pushtetit Vendor	697,409	5,000	0	5,000	702,409	700,734	5,000	0	5,000	705,734	700,734	5,000	0	5,000	705,734	700,734	5,000	0	5,000	705,734	700,734							
01170	Shërbimi i Gjenezës Civile	658,184	130,000	0	130,000	788,184	661,301	130,000	0	130,000	791,301	661,301	30,000	0	30,000	691,301	691,301	30,000	0	30,000	721,301	721,301							
17	Ministria e Mbrojtjes	29,383,040	19,159,705	14,512,050	33,671,755	63,054,795	29,745,494	25,049,295	14,512,050	39,561,345	69,306,839	31,874,445	27,149,295	14,512,050	41,661,345	73,535,790	73,535,790	27,149,295	14,512,050	41,661,345	75,347,340	75,347,340							
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	1,437,910	120,000	0	120,000	1,557,910	1,441,883	120,000	0	120,000	1,561,883	1,441,883	120,000	0	120,000	1,561,883	1,441,883	120,000	0	120,000	1,561,883	1,441,883							
02120	Forcat e luftimit	9,744,161	14,597,205	12,500,000	27,097,205	36,841,366	10,067,721	20,286,795	12,500,000	32,786,795	42,854,516	11,067,721	22,386,795	12,500,000	34,886,795	45,954,516	45,954,516	22,386,795	12,500,000	34,886,795	48,141,290	48,141,290							
09430	Armsi ushtarak	902,498	457,000	0	457,000	1,359,498	906,209	457,000	0	457,000	1,363,209	956,209	457,000	0	457,000	1,413,209	1,413,209	457,000	0	457,000	1,460,209	1,460,209							
02150	Mbështetje e luftimit	8,901,805	1,765,500	0	1,765,500	10,667,305	8,926,820	1,965,500	0	1,965,500	10,892,320	9,955,771	1,965,500	0	1,965,500	11,471,271	11,471,271	1,965,500	0	1,965,500	12,436,771	12,436,771							
07340	Mbështetje për shëndetësinë	1,636,761	500,000	0	500,000	2,136,761	1,641,317	500,000	0	500,000	2,141,317	1,641,317	500,000	0	500,000	2,141,317	2,141,317	500,000	0	500,000	2,141,317	2,141,317							
10270	Mbështetje sociale për ushtarakët	5,200,000	0	0	0	5,200,000	5,200,000	0	0	0	5,200,000	5,200,000	0	0	0	5,200,000	5,200,000	0	0	0	5,200,000	5,200,000							
10910	Emergjencat civile	1,559,905	1,720,000	2,012,050	3,732,050	5,291,955	1,561,544	1,720,000	2,012,050	3,732,050	5,293,594	2,061,544	1,720,000	2,012,050	3,732,050	5,298,594	5,298,594	1,720,000	2,012,050	3,732,050	5,298,594	5,298,594							
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	2,803,550	150,000	0	150,000	2,953,550	2,816,210	150,000	0	150,000	2,966,210	2,828,210	150,000	0	150,000	2,978,210	2,978,210	150,000	0	150,000	2,978,210	2,978,210							
03520	Veprimtaria informatike shtetërore	2,803,550	150,000	0	150,000	2,953,550	2,816,210	150,000	0	150,000	2,966,210	2,828,210	150,000	0	150,000	2,978,210	2,978,210	150,000	0	150,000	2,978,210	2,978,210							
19	Drejtoria e Radiotelevizionit	840,000	0	0	0	840,000	840,000	0	0	0	840,000	840,000	0	0	0	840,000	840,000	0	0	0	840,000	840,000							
08310	Shërbimet për shqiptarët jashtë kufirit	319,000	0	0	0	319,000	319,000	0	0	0	319,000	319,000	0	0	0	319,000	319,000	0	0	0	319,000	319,000							
08520	Projekte teknike për futen e teknologjive të reja	200,000	0	0	0	200,000	200,000	0	0	0	200,000	200,000	0	0	0	200,000	200,000	0	0	0	200,000	200,000							
08330	Produktet filmike ose veprimtari artistike mbarekomb																												



Kodi	Emërtimi i institucionit/Programit	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore
			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale	
50	Instituti i Statistikës	1,169,879	35,600	100,000	135,600	1,305,479	1,175,162	15,600	100,000	115,600	1,290,762	1,180,162	20,000	100,000	120,000	1,300,162
01320	Veprimtaria Statistikore	1,169,879	35,600	100,000	135,600	1,305,479	1,175,162	15,600	100,000	115,600	1,290,762	1,180,162	20,000	100,000	120,000	1,300,162
55	Shkolla e Magistraturës	408,022	36,400	0	36,400	444,422	408,604	13,840	0	13,840	422,444	409,104	5,000	0	5,000	414,104
09820	Veprimtaria Arsimore	408,022	36,400	0	36,400	444,422	408,604	13,840	0	13,840	422,444	409,104	5,000	0	5,000	414,104
56	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	0	13,618,212	8,080,236	21,698,448	21,698,448	0	13,018,404	7,921,178	20,939,582	20,939,582	0	13,024,139	8,000,000	21,024,139	21,024,139
06210	Programe Zhvillimi	0	7,747,118	8,080,236	15,827,354	15,827,354	0	7,237,411	7,921,178	15,158,589	15,158,589	0	7,524,139	8,000,000	15,524,139	15,524,139
06220	Infrastruktura Vendore dhe Rajonale	0	4,700,167	0	4,700,167	4,700,167	0	3,922,636	0	3,922,636	3,922,636	0	4,000,000	0	4,000,000	4,000,000
04230	Programi "100 Fshatra"	0	1,170,927	0	1,170,927	1,170,927	0	1,858,357	0	1,858,357	1,858,357	0	1,500,000	0	1,500,000	1,500,000
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	179,298	1,000	0	1,000	180,298	179,415	1,000	0	1,000	180,415	180,415	1,000	0	1,000	181,415
08220	Mbështetja e veprimtarisë kinematografike	179,298	1,000	0	1,000	180,298	179,415	1,000	0	1,000	180,415	180,415	1,000	0	1,000	181,415
63	Institucionet e sistemit të drejtësisë	319,362	5,500	0	5,500	324,862	321,725	5,500	0	5,500	327,225	324,725	5,500	0	5,500	330,225
03320	Veprimtaria e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë	319,362	5,500	0	5,500	324,862	321,725	5,500	0	5,500	327,225	324,725	5,500	0	5,500	330,225
03340	Veprimtaria e apelimit të nvlërësimit kalimtar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
66	Avokati i Popullit	207,579	3,000	0	3,000	210,579	208,554	3,000	0	3,000	211,554	209,554	4,000	0	4,000	213,554
03320	Shërbimi i avokatisë	207,579	3,000	0	3,000	210,579	208,554	3,000	0	3,000	211,554	209,554	4,000	0	4,000	213,554
67	Komisioneri për Mbrojtjen e Shërbimit Civil	99,975	2,000	0	2,000	101,975	100,425	2,000	0	2,000	102,425	100,925	2,000	0	2,000	102,925
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	99,975	2,000	0	2,000	101,975	100,425	2,000	0	2,000	102,425	100,925	2,000	0	2,000	102,925
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	353,448	1,500	0	1,500	354,948	354,470	1,500	0	1,500	355,970	356,470	11,500	0	11,500	367,970
01610	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	353,448	1,500	0	1,500	354,948	354,470	1,500	0	1,500	355,970	356,470	11,500	0	11,500	367,970
01620	Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
76	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	247,347	63,000	0	63,000	310,347	248,429	63,000	0	63,000	311,429	250,429	25,000	0	25,000	275,429
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	247,347	63,000	0	63,000	310,347	248,429	63,000	0	63,000	311,429	250,429	25,000	0	25,000	275,429
77	Autoriteti i Konkurrencës	118,697	1,000	0	1,000	119,697	119,271	1,000	0	1,000	120,271	120,271	2,000	1,000	3,000	123,271
04120	Mbrojtja e tregut dhe garancitë të konkurrencës	118,697	1,000	0	1,000	119,697	119,271	1,000	0	1,000	120,271	120,271	2,000	1,000	3,000	123,271
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	18,501	1,000	0	1,000	19,501	18,573	1,000	0	1,000	19,573	19,073	1,000	0	1,000	20,073
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	18,501	1,000	0	1,000	19,501	18,573	1,000	0	1,000	19,573	19,073	1,000	0	1,000	20,073
87	Institucione të tjera qeveritare	12,136,669	5,659,208	1,783,780	7,442,988	19,579,657	12,154,257	6,426,036	2,124,766	8,550,802	20,705,059	12,317,257	6,063,749	3,117,780	9,181,529	21,498,786
01320	Shërbime qeveritare	400,000	599,956	0	599,956	999,956	400,000	366,749	0	366,749	766,749	530,000	666,749	0	666,749	1,196,749
01130	Shërbimi i prokurimit publik	112,421	1,000	0	1,000	113,421	112,970	1,000	0	1,000	113,970	113,970	1,000	0	1,000	114,970
05640	Administrimi i ujërave	149,240	10,000	33,000	43,000	192,240	149,951	10,000	26,986	36,986	186,937	151,951	10,000	20,000	30,000	181,951
03310	Shërbimi i avokatisë shtetërore	347,935	2,000	0	2,000	349,935	349,724	2,000	0	2,000	351,724	351,724	2,000	0	2,000	353,724
01150	Shërbime të tjera	1,380,259	68,000	80,780	148,780	1,529,039	1,380,954	68,000	80,780	148,780	1,534,734	1,390,954	68,000	80,780	148,780	1,539,734
01140	e-Qeverisja	9,292,892	4,962,252	1,670,000	6,632,252	15,925,144	9,300,688	5,962,287	2,017,000	7,979,287	17,279,975	9,320,688	5,300,000	3,017,000	8,317,000	17,637,688
01330	Menaxhimi dhe zhvillimi i administratës publike	280,523	15,000	0	15,000	295,523	281,458	15,000	0	15,000	296,458	283,458	15,000	0	15,000	298,458
08480	Mbështetje për kultet fetare	173,399	1,000	0	1,000	174,399	173,512	1,000	0	1,000	174,512	174,512	1,000	0	1,000	175,512
88	Mbështetje për shoqërinë civile	137,440	1,000	0	1,000	138,440	137,590	1,000	0	1,000	138,590	138,590	1,000	0	1,000	139,590
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	137,440	1,000	0	1,000	138,440	137,590	1,000	0	1,000	138,590	138,590	1,000	0	1,000	139,590
89	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	173,723	1,000	0	1,000	174,723	174,472	1,000	0	1,000	175,472	175,472	1,000	0	1,000	176,472
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	173,723	1,000	0	1,000	174,723	174,472	1,000	0	1,000	175,472	175,472	1,000	0	1,000	176,472
90	Komisioni i Prokurimit Publik	117,923	2,000	0	2,000	119,923	118,445	2,000	0	2,000	120,445	119,445	2,000	0	2,000	121,445
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	117,923	2,000	0	2,000	119,923	118,445	2,000	0	2,000	120,445	119,445	2,000	0	2,000	121,445
91	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	77,699	2,000	0	2,000	79,699	78,045	2,000	0	2,000	80,045	79,045	2,000	0	2,000	81,045
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	77,699	2,000	0	2,000	79,699	78,045	2,000	0	2,000	80,045	79,045	2,000	0	2,000	81,045
92	Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit	61,663	1,000	0	1,000	62,663	61,902	1,000	0	1,000	62,902	62,902	1,000	0	1,000	63,902
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	61,663	1,000	0	1,000	62,663	61,902	1,000	0	1,000	62,902	62,902	1,000	0	1,000	63,902
95	Autoriteti për të Drejtën e Informimit	180,790	3,000	0	3,000	183,790	181,578	3,000	0	3,000	184,578	182,578	3,000	0	3,000	185,578
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	180,790	3,000	0	3,000	183,790	181,578	3,000	0	3,000	184,578	182,578	3,000	0	3,000	185,578
TOTALI		325,212,160	118,122,000	48,300,000	166,422,000	491,634,160	328,082,815	120,818,500	50,797,000	171,615,500	499,698,315	335,623,635	117,503,500	57,297,000	174,800,500	510,424,135

**VENDIM****Nr. 165, datë 19.3.2026****PËR AUTORIZIMIN E NËNSHKRIMIT
TË MARRËVESHJES SË
BASHKËPUNIMIT NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KOMUNITETIT MYSLIMAN TË
SHQIPËRISË, PËR RINDËRTIMIN E
XHAMISË NË QYTETIN E SHIJAKUT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 20, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, për rindërtimin e xhamisë në qytetin e Shijakut, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama****Nr. ____ prot.****Tiranë, më ____ .2026****MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KOMUNITETIT MYSLIMAN TË
SHQIPËRISË, PËR RINDËRTIMIN E
XHAMISË NË QYTETIN E SHIJAKUT**

Sot në datën ____ .2026 lidhet kjo marrëveshje ndërmjet:

Këshilli të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë,

bashkësi fetare, e regjistruar me vendimin nr. 5331, datë 20.6.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në adresën: Rruga “George W. Bush”, nr. 50, Tiranë, me përfaqësues ligjor z. Bujar Spahiu, lindur më 26.2.1976, në Kolesjan, Kukës, shtetas shqiptar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. 030280992/nr. personal H60226034S, banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, referuar më poshtë si “Donatori”, të cilëve bashkërisht iu referohet si “Palët”, dhe secilit prej tyre si “Pala”,

duke qenë se:

A. Në mëngjesin e datës 26 nëntor 2019 në Shqipëri u regjistrua një ndër tërmetet më të fuqishëm të dekadave të fundit, nga i cili u dëmtuan rëndë qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë. Për përballimin e situatës së krijuar nga tërmeti është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore me vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, dhe me vendimin nr. 751, datë 29.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa në vendimin nr. 750, datë 27.11.2019”, është përfshirë dhe qarku Lezhë.

B. Ligji nr. 97/2019, “Për miratimin e aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, ka përcaktuar kuadrin e nevojshëm ligjor, organet përgjegjëse, si dhe një sërë masash që do të mundësojnë rimëkëmbjen e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore, ku ndër të tjera ka përcaktuar mundësinë e palëve të treta, të cilat nëpërmjet donacioneve, të kontribuojnë në funksion të përballimit të këtyre pasojave.

Me vendimin nr. 119, datë 15.10.2025, të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit është miratuar donacioni në masën prej 114 139 916 (njëqind e katërmbydhjetë milionë e njëqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekësh, i mbledhur nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, për rindërtimin e xhamisë në qytetin e Shijakut.

C. Në përgjigje të kërkesave për mbështetje të qeverisë së Republikës së Shqipërisë janë solidarizuar edhe shumë shoqëri tregtare, organizata të ndryshme joqeveritare, individë, vendës ose të huaj, të cilët kanë shprehur vullnetin për të ofruar donacione të natyrave të ndryshme në natyrë, në ndihmë të procesit të rindërtimit dhe të zhvillimit të zonave të reja të shpallura.



D. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi rregullon parimet themelore për realizimin e “Projektit”, në funksion të procesit të rindërtimit në një nga territoret e zonave të prekura, për rindërtimin e xhamisë në qytetin e Shijakut, në masën 114 139 916 (njëqind e katërmëdhjetë milionë e njëqind e tridhjetë e nëntëmijë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë (referuar në vijim si “Projekti”), sipas kushteve teknike të pranuar nga Palët dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.

E. Ky donacion është miratuar me vendimin nr. 119, datë 15.10.2025, të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit.

Palët, në referim të ligjit nr. 97/2019, “Për miratimin e aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, bien dakord, si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i marrëveshjes

1.1 Objekt i kësaj marrëveshje është rindërtimi i xhamisë në qytetin e Shijakut, sipas propozimit të Donatorit.

1.2 Në kuadër të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, detyrën e njësisë zbatuese për rindërtimin e xhamisë në qytetin e Shijakut do ta kryejë shoqëria “Fjora Construction” sh.p.k., sipas propozimit të Donatorit.

Detyrën e njësisë zbatuese për mbikëqyrjen e punimeve do ta kryejë shoqëria “Illyrian Consulting Engineers” sh.p.k., sipas propozimit të Donatorit.

Kolaudatori i punimeve do të caktohet nga Donatori.

Neni 2

Masa e donacionit

2.1 Masa e donacionit sipas kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi është 114 139 916 (njëqind e katërmëdhjetë milionë e njëqind e tridhjetë e nëntëmijë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë.

2.2 Donacioni sipas kësaj marrëveshjeje do t'i nënshtrohet të gjitha parashikimeve ligjore në fuqi për përjashtimet fiskale përkatëse, në rastet e fatkeqësive natyrore, në kuadër të procesit të rindërtimit.

Neni 3

Detyrimet e palëve

3.1 Midis donatorit dhe bashkisë Shijak do të lidhet marrëveshja përkatëse e bashkëpunimit me Faqe| 4286

qëllim zbatimin e objektit të parashikuar në nenin 1, të kësaj marrëveshjeje, në përputhje kjo edhe me legjislacionin në fuqi.

3.2 Projekti i zbatimit, për objektin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit, do të hartohet nga Donatori në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, do të miratohet nga Palët me konsensus të përbashkët.

3.3 Normat e projektimit dhe të zbatimit për ndërtimet do të jenë sipas standardeve të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, si dhe të konfirmuara me certifikatën CE.

3.4 Zbatimi i projektit do të bëhet nga vetë Donatori.

“Projekti” do të realizohet nga kontraktori, shoqëria “Fjora Construction” sh.p.k., e cila është përzgjedhur nga Donatori.

Mbikëqyrja e punimeve do të realizohet nga shoqëria “Illyrian Consulting Engineers” sh.p.k., e cila është përzgjedhur nga Donatori.

Kolaudatori i punimeve do të caktohet nga Donatori.

3.5 Bashkia Shijak do të marrë përsipër të garantojë vendosjen në dispozicion të Donatorit të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm (leje, licenca autorizime etj.) për realizimin e “Projektit”.

3.6 Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, i cili është pronar i truallit ku do të kryhen punimet për rindërtimin e xhamisë, Shijak, do të vërë në dispozicion të kontraktorit sheshin e ndërtimit.

3.7 Donatori, sipas kësaj marrëveshjeje, do të përfitojë lehtësirat fiskale në përputhje me aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, dhe parashikimet e legjislacionit fiskal në kuadër të procesit të rindërtimit.

3.8 Në përfundim të realizimit të projektit, Donatori përgatit listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të projektit të realizuar dhe ia përcjell Këshillit të Ministrave.

3.9 Të gjitha procedurat (veprimet) përfundimtare të pranimit të “Projektit”, do të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi nga bashkia Shijak dhe Donatori.

Neni 4

Njoftimet dhe komunikimet

4.1 Çdo njoftim që do t'i jepet një Pale dhe çdo komunikim tjetër në lidhje me këtë kontratë do të



bëhet me shkrim. Çdo ndryshim i adresës së njëres palë do të duhet t'i njoftohet me shkrim palës tjetër.

Neni 5 Ndryshimet

5.1 Çdo ndryshim i rregullimeve apo i kushteve të kësaj marrëveshjeje do të bëhet me shkrim me një amendament të kësaj marrëveshjeje, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesit ligjorë të Palëve.

Neni 6 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

6.1 Të gjitha mosmarrëveshjet e mundshme që do të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi do të zgjidhen me bisedime mes Palëve në kuadër të vullnetit të mirë.

Neni 7 Konfidencialiteti

7.1 Informacionin, dokumentacionin dhe plan-projektet që Palët do të shkëmbejnë me njëra-tjetrën në lidhje me realizimin e Projektit do t'i përdorin vetëm për qëllimet e përcaktuara dhe nuk do t'i transferojnë ato te një palë e tretë pa marrë pëlqimin me shkrim të Palës që i ka siguruar ato.

Neni 8 Hyrja në fuqi dhe vlefshmëria

8.1 Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj dhe është e vlefshme deri në realizimin e objektit.

Përfundimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi nuk do të ndikojë në projektet dhe aktivitetet në vazhdim ose të përfunduara.

Për sa më sipër, Palët, kanë nënshkruar marrëveshjen në 4 (katër) origjinale.

Nënshkruar në Tiranë
më 2026
.....
MINISTRIA E
INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

Enea Karakaçi

Nënshkruar në Tiranë
më 2026
.....
DONATORI
PËR KOMUNITETIN
MYSLIMAN TË
SHQIPËRISË
Bujar Spahiu

VENDIM Nr.166, datë 19.3.2026

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË FSHATRA PODGORIE, SOVJAN, POJAN, ZËMBLAK DHE VLOÇISHT”, BASHKIA MALIQ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave publike në fshatrat Podgorie, Sovjan, Pojan, Zëmbak dhe Vloçisht”, Bashkia Maliq.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Maliq.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 3 545 124 (tre milionë e pesëqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e njëzet e katër) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 3 545 124 (tre milionë e pesëqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e njëzet e katër) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Maliq.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Maliq.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Maliq.



8. Bashkia Maliq kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Maliq.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë–Devoll–Kolonjë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Maliq për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri

në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Maliq për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Maliq, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë–Devoll–Kolonjë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE TË TË CILËVE PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË FSHATRAZ PODGORIE, SOVJAN, POJAN, ZËMBLAK DHE VLOÇISHT", TË BASHKISË MALIQ														
Nr.	TË DHËNAT E PRONËSISË			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)						VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM, SIPAS LLOJIT TË PASURISË				SHËNIME
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. Totale (m²)	Arë (m²)	Arë			VLERA TOTALE (lekë)	
										Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/ m²)	Vlera (lekë)		
1	Esat	Bedri	Hadri	Podgorie	3010	99/6	Arë	2083	2083	2083	100	208,300	208,300.0	
2	Tahir	Hysen	Bezan	Podgorie	3010	99/7	Arë	2074	2074	2074	100	207,400	207,400.0	
3	Hysen	Tahir	Bezan	Podgorie	3010	99/8	Arë	2501	2501	2501	100	250,100	250,100.0	
4	Nesti	Dhori	Kozmallari	Sovjan	3496	1635/1	Arë	2475	2475	2475	100	247,500	247,500.0	
5	Niko	Dhori	Kozmallari	Sovjan	3496	1635/2	Arë	3182	3182	3182	100	318,200	318,200.0	
6	Iovan	Nuni	Kozmallari	Sovjan	3496	1635/3	Arë	3286	3286	3286	100	328,600	328,600.0	
7	Hiqmet	Emin	Mullall	Zëmbllak	3903	141/3	Arë	1685	1685	1685	100	168,500	168,500.0	
8	Erion	Ditron	Mullall	Zëmbllak	3903	141/4	Arë	560	560	560	100	56,000	56,000.0	
9	Shkëlzen	Ibrahim	Mullall	Zëmbllak	3903	141/6	Arë	1690	1690	1690	100	169,000	169,000.0	
10	Nefail	Rushan	Mullall	Zëmbllak	3903	141/7	Arë	1055	1055	1055	100	105,500	105,500.0	
11	Hekuran	Xhezar	Mullall	Zëmbllak	3903	141/8	Arë	1210	1210	1210	100	121,000	121,000.0	
12	Edson	Osman	Mullall	Zëmbllak	3903	141/31	Arë	165	165	165	100	16,500	16,500.0	
13	Ardian Erkeva	Osman Nestan	Mullall Mullall	Zëmbllak	3903	141/32	Arë	495	495	495	100	49,500	49,500.0	
14	Xhevalir	Dalip	Xhihani	Pojan	3014	92/29	Arë	1357	1357	1357	248	336,536	336,536.0	
15	Xhelal	Sali	Xhihani	Pojan	3014	92/30	Arë	1856	1856	1856	248	460,288	460,288.0	
16	Suat	Myrteza	Xhihani	Pojan	3014	92/31	Arë	2025	2025	2025	248	502,200	502,200.0	
VLERA TOTALE													3,545,124	

VENDIM

Nr. 167, datë 19.3.2026

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIM I RRUGËS 'BEXHET HYTI' NË ZONËN KADASTRALE 2654", BASHKIA ELBASAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtim i rrugës 'Bexhet Hyti', në zonën kadastrale 2654", Bashkia Elbasan.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Elbasan.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "arë" dhe "truall", me një vlerë të përgjithshme prej 936 355.66 (nëntëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 936 355.66 (nëntëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e treqind



e pesëdhjetë e pesë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Elbasan.

8. Bashkia Elbasan kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Elbasan.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për

hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Elbasan për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Elbasan për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Elbasan, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE, TË CILËT SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTTI “NDËRTIM I RRUGËS ‘BEXHET HYT’ NË ZONËN KADASTRALE 2654”, BASHKIA ELBASAN

NR.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM							SHËNIME(D+E)) Kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)
	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja Totale	"Arë" (m²)	"Trrall" (m²)	"Ndërtesë" (m²)	Volumi	Faqe	ARË			"TRUALL"			VLERA TOTALE (lekë)	
														Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera(lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
1	Servet	Musa	Tanushi	Elbasan	2654	1157/3	Trrall	250		250.00	104.50	3	89				13.50	269	3,631.50	3,631.50	
2	Ilmie	Zenel	Tanushi	Elbasan	2654	1157/2	Trrall	250		250.00	88.80	3	88				8.00	269	2,152.00	2,152.00	
3	Faik	Musa	Tanushi	Elbasan	2654		Trrall	250		250.00	88.80	3	88				8.00	269	2,152.00	2,152.00	
	Ramazan	Musa	Duka	Elbasan	2654	1214	Arë+Trrall	1000		172.73	152.60	1	97	3.80	222	843.60			843.60		
4	Haxhire	Mustafa	Duka	Elbasan	2654		Trrall	289.5		289.50	128.10	1	33				9.44	269	2,539.36	2,539.36	
5	Figjret	Jakup	Muzhaqi	Elbasan	2654	6/2	Trrall	289.5		289.50	128.10	1	33				9.44	269	2,539.36	2,539.36	
5	Petraq	Pandi	Guxho	Elbasan	2654	1480	Trrall	20287		20,287.00	10,854.30	3	237				992.80	269	267,063.20	267,063.20	- Regj. 00820, datë 11.8.2021. Hipotekë ligjore së kredisë së dhënë nga institucionet bankare. Nr. kont. 2010/945, datë 11.8.2021, 20 vjet. Banka e parë e investimeve Albania First Investment. - Regj. 00821, datë 14.6.2023. Hipotekë ligjore së kredisë së dhënë nga institucionet bankare. Nr. kont. 3283/1988, datë 14.6.2023, 20 vjet. Banka e parë e investimeve Albania First Investment. - Regj. 00826, datë 14.10.2024. Hipotekë ligjore së kredisë së dhënë nga institucionet bankare. Nr. kont. 5678/3353, datë 11.10.2024, 20 vjet. Banka e parë e investimeve Albania First Investment.
6	Durim		Peshitani	Elbasan	2654	1590	Trrall	15364		15,364.00	875.00	3	222				2,454.00	269	660,126.00	660,126.00	
	Drita	Kadri	Gedaj																		
	Doraida	Flamur	Kafexhiu																		
	Ervin	Flamur	Gedaj																		
VLERA TOTALE														843.60			935,512.06			936,355.66	

**VENDIM****Nr. 168, datë 19.3.2026**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 20, DATË 17.1.2024,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT ‘LIDHJA E
RRUGËS TRANSBALLKANIKE ME
PORTIN DETAR VLORË’”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 20, datë 17.1.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga

realizimi i projektit ‘Lidhja e Rrugës Transballkanike me Portin Detar Vlorë’”, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë vijon:

a) Në pikat 3 dhe 4, fjalët “... prej 200 831 026.08 (dyqind milionë e tetëqind e tridhjetë e një mijë e njëzet e gjashtë pikë zero tetë) lekësh ...” zëvendësohen me “... 204 401 080.58 (dyqind e katër milionë e katërqind e një mijë e tetëdhjetë pikë pesëdhjetë e tetë) lekë ...”;

b) Në tabelën bashkëlidhur vendimit shtohen pasuritë me numrat rendorë 56-57, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i Bashkisë Vlorë.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama**



LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “LIDHJA E RRUGËS TRANSBALLKANIKE ME PORTIN DETAR VLORE”

NR	Pronari			ZK	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë	Volum	Faqe	Truall m²	Ndërtesë m²	Adresa	Sipërfaqe truallit për shpronësim	Çmimi i truallit lekë/m²	Vlera e truallit lekë	Sipërfaqe ndërtimi për shpronësim	Çmimi i ndërtimit lekë/m²	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera e truallit dhe ndërtesës	Shënime
56	Arben	Ramadan	Mamanaj	8604	32/134+1-13	Apartament	74	39		18	Vlore			-	18	52,296.00	941,328.00	941,328.00	Konfirmuar nga ASHK-ja. Pasuna e llojit apartament. Kartela është e vlefshme vetëm për shpronësim.
	Emiljana	Ramadan	Xhaferaj																
	Marinela	Ramadan	Mamanaj																
	Gentjan	Ramadan	Mamanaj																
57	Fatmir	Remzi	Idrizi	8604	32/33+1-7	Apartament	74	48	47.5	44	Vlore	47.50	6,899.00	327,702.50	44	52,296.00	2,301,024.00	2,628,726.50	Konfirmuar nga ASHK-ja. Te seksioni E - për këtë apartament është privatizuar edhe sipërfaqja e truallit prej 47.5 m². Lëshohet për efekt shpronësimi.
	Vjollca	Brahim	Idrizi																
	Lumtur		Dine																
	Sheme	Remzi	Berati																
	Dylbere	Remzi	Sako																
	Suzana	Remzi	Idrizi																
	Feta	Remzi	Idrizi																
	Armida	Sezai	Sinani																
	Luçjana	Sezai	Rubino																
	Gentjan	Sezai	Sinani																
	Shpendi	Sezai	Sinani																
	Lira	Remzi	Idrizi																
	Astrit	Ali	Avdulla																
	Vlera totale shtesë e shpronësimit																	3,570,054.50	

**VENDIM****Nr. 169, datë 19.3.2026**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË
SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKET NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION
TROUARI PERIMETRAL, SHKOLLA 9-
VJEÇARE “NDRE MJEDA”,
BASHKIA SHKODËR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikonstruksion trotuari perimetral, shkolla 9-vjeçare “Ndre Mjeda”, Bashkia Shkodër”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Shkodër.

3. Pronari i pasurisë të paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 749 932.10 (një milion e shtatëqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy pikë dhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 1 749 932.10 (një milion e shtatëqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy pikë dhjetë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Shkodër.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Shkodër.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Shkodër.

8. Bashkia Shkodër kryen procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Shkodër.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Shkodër për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Shkodër për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Shkodër, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE E TË CILËVE SHPRONËSOHET NGA REALIZIMI I PROJEKTTT “RIKONSTRUKSION TROTUARI PERIMETRAL SHKOLLA 9-VJEÇARE “NDRE MJEDA”, BASHKIA SHKODËR

Nr.	PRONARI			TË DHËNA KADASTRALE									VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM					VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)
													Truall			Ndërtesë social-ekonomike			
	Emri	Atësia	Mbiemri	Qyteti	Zona kadastrale	Indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m2)	Truall (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Vlera (lekë)		
1	REMZI	EJUP	ZENELI	Shkodër	8591	N-6	1/701	TRUALL	55.1	55.1	22	217	55.1	8511	468,956.10	49.92	1,280,976	1,749,932.10	
VLERA TOTALE									55.1				55.1		468,956	49.92	1,280,976	1,749,932.10	



VENDIM

Nr. 171, datë 19.3.2026

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË
PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIMIN
E INSPEKTIMEVE E TË
METODOLOGJISË SË VLERËSIMIT TË
RISKUT DHE PËRCAKTIMIN E
PERIUDHËS MAKSIMALE TË
INSPEKTIMEVE VJETORE DHE TË
MËNYRËS SË LLOGARITJES SË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32, pika 8, e 34, të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. QËLLIMI DHE FUSHA E ZBATIMIT

1. Ky vendim ka për qëllim krijimin e kuadrit rregullator të përgjithshëm për programimin e inspektimeve, metodologjinë e vlerësimit të riskut në veprimtarinë inspektuese, përcaktimin e periudhës maksimale të lejuar të inspektimeve vjetore për çdo kategori të subjekteve të inspektimit.

2. Ky vendim është i zbatueshëm nga ministrinë përgjegjëse, Inspektorati i Përgjithshëm, inspektoratet qendrore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe inspektoratet vendore, të përcaktuara sipas dispozitave në fuqi të ligjit për inspektimin.

II. PËRKUFIZIME

Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

1. **“Sektor inspektimi”**, zona/fusha e veprimit tematik, në bazë të kompetencave ligjore të inspektorateve, mbi të cilën ushtrohet funksioni i inspektimit, ku vlerësohet zbatimi i legjislacionit në fuqi, me qëllim garantimin e zbatimit të ligjit, rregulloreve dhe standardeve përkatëse.

2. **“Subjekt inspektimi”**, çdo person juridik dhe fizik, publik apo privat, ndaj të cilit ushtrohet inspektimi për të verifikuar zbatimin e ligjit, rregulloreve dhe standardeve përkatëse në një fushë të caktuar, të identifikuar nga çdo inspektorat.

3. **“Objekt inspektimi”**, veprimtaria, procesi, dokumentacioni, sendi apo një veprim specifik e konkret, që është në fokus të kontrollit dhe vlerësimit gjatë një inspektimi, për çdo fushë inspektimi.

4. **“Gjasat për papërputhshmëri”**, niveli i pritshëm i rrezikut që një subjekt, sektor apo veprimtari mund të paraqesë në drejtim të mosrespektimit të kërkesave ligjore dhe rregullatore. Vlerësimi i këtyre gjasave ndihmon në përcaktimin e prioriteteve në programimin mbi bazë risku të inspektimit.

5. **“Efektet për papërputhshmëri”**, pasojat negative që mund të rezultojnë nga mosrespektimi i kërkesave ligjore, rregullatore apo standardeve përkatëse nga një subjekt apo sektor inspektimi.

6. **“Faktor risku”**, një element, rrethanë ose karakteristikë që ndikon në nivelin e rrezikut për papërputhshmëri me legjislacionin, rregulloret apo standardet në fuqi. Faktorët përdoren për të vlerësuar probabilitetin dhe ndikimin e papërputhshmërisë për të përcaktuar prioritetet e programimit të inspektimit.

7. **“Sistem pikëzimi”**, shumatore e përgjithshme e vlerës së treguesve për secilin faktor risku, për të matur dhe kategorizuar nivelin e riskut të subjektit të inspektimit, si një vlerësim kompleks që përfshin shumë faktorë dhe ndryshon në bazë prioritetesh dhe objektivash sektorialë.

8. **“Tregues të faktorëve të riskut”**, elemente të matshme, specifike dhe të verifikueshme që përdoren për të identifikuar dhe vlerësuar praninë dhe nivelin e një faktori risku.

9. **“Matrica e vlerësimit të riskut”**, një mjet analitik që përdoret për të vlerësuar dhe kategorizuar nivelet e riskut për subjektet e inspektimit, duke kombinuar gjasat e papërputhshmërisë me efektet e mundshme që ato mund të shkaktojnë. Matrica është një mjet që lejon një përmbledhje të qartë dhe vizuale të rrezikut që ndihmon në programimin e veprimtarisë inspektuese.

III. RREGULLAT E PËRGJITHSHME BAZË TË PROGRAMIMIT TË INSPEKTIMIT

1. Veprimtaria inspektuese e inspektorateve qendrore dhe vendore bazohet në programin vjetor dhe mujor të inspektimit. Programi i inspektimeve është mjeti që përdor inspektorati



qendror dhe vendor për planifikimin e inspektimeve në subjektet, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën përkatëse të inspektimit.

2. Inspektoratet qendrore dhe vendore hartojnë program vjetor dhe mujor të inspektimit.

3. Programi vjetor i inspektimit të inspektorateve qendrore është plani i detajuar mbi bazë tematike, mbështetur në metodologjitë e vlerësimit të riskut, si dhe prioritetet dhe politikat e fushës përkatëse të inspektimit, mbështetur në politikat e ministrisë përgjegjëse.

4. Programi mujor i inspektimit i inspektoratit qendror është i detajuar me subjekte inspektimi, i mbështetur në metodologjitë e vlerësimit të riskut dhe në detyrimin ligjor për inspektimin periodik të subjekteve të inspektimit.

5. Programi vjetor i inspektimit të inspektoratit qendror hartohet nga inspektorati qendror dhe, pas dhënies së mendimit këshillimor nga Inspektori i Përgjithshëm, miratohet nga ministri përgjegjës.

6. Inspektorati i Përgjithshëm miraton programin mujor të inspektimit, të hartuar nga inspektorati qendror ose strukturat e tjera inspektuese.

7. Programi vjetor i inspektimit të inspektoratit vendor hartohet nga inspektorati vendor dhe miratohet nga kryetari i bashkisë, pas dhënies së mendimit këshillimor nga Inspektorati i Përgjithshëm.

8. Programi mujor i inspektimit për çdo inspektorat vendor hartohet nga inspektoratet përkatëse vendore dhe i dërgohet për mendim Inspektoratit të Përgjithshëm.

9. Inspektorati i Përgjithshëm mbikëqyr zbatimin e programeve vjetore dhe mujore pas miratimit të tyre sipas kërkesave ligjore. Këto programe mbikëqyren edhe nga ministri përgjegjës.

10. Në miratimin e programeve mujore, sipas përcaktimit në pikën 6, dhe në dhënien e mendimit këshillimor, sipas përcaktimit në pikat 5, 7 dhe 8, të këtij kreu, Inspektorati i Përgjithshëm synon të shmangë mbivendosjen e trupave inspektuese në inspektime, përsëritjen e inspektimeve pa shkak të arsyetuar, koordinimin midis inspektimeve qendrore dhe inspektimeve vendore.

IV. PROCEDURA E PROGRAMIMIT TË VEPRIMTARISË INSPEKTUESE MBI BAZË RISKU

1. Programi vjetor i inspektimit për inspektoratet qendrore hartohet mbi bazë

tematike, mbështetur në metodologjitë e vlerësimit të riskut, si dhe prioritetet, politikat e objektivat vjetorë, afatmesëm dhe strategjikë të ministrisë përgjegjëse.

2. Inspektorati qendror apo vendor i paraqet, përkatësisht, ministrit përgjegjës apo kryetarit të bashkisë, si dhe Inspektorit të Përgjithshëm, brenda datës 15 tetor të vitit paraardhës, programin vjetor tematik të inspektimit.

3. Inspektorati i Përgjithshëm jep mendim këshillimor për programin vjetor të inspektimit për inspektoratet qendrore dhe inspektoratet vendore brenda 5 (pesë) ditëve punë.

4. Inspektoratet qendrore dhe inspektoratet vendore reflektojnë mendimin këshillimor të dhënë nga Inspektorati i Përgjithshëm, në rast të kundërt, duhet të kthejnë përgjigje të motivuar.

5. Programi vjetor i inspektimit miratohet nga ministri përgjegjës për inspektoratet qendrore apo nga kryetari i bashkisë për inspektoratet vendore brenda datës 24 dhjetor të vitit paraardhës, në sistemin “*e-Inspektimi*”.

6. Inspektorati qendror harton programin mujor në sistemin “*e-Inspektimi*” dhe e dërgon për miratim pranë Inspektoratit të Përgjithshëm, brenda datës 15 të muajit paraardhës.

7. Inspektorati i Përgjithshëm miraton në sistemin “*e-Inspektimi*” programin mujor të inspektimit të inspektoratit qendror brenda datës 18 të muajit paraardhës, mbi bazën e metodologjive të vlerësimit të riskut, në çdo rast jo më vonë se 3 (tri) ditë nga data e paraqitjes ose hedhjes së programit në sistemin “*e-Inspektimi*”.

8. Programi mujor i inspektimit për çdo inspektorat vendor hartohet në sistemin “*e-Inspektimi*” nga inspektorati përkatës dhe i dërgohet për mendim Inspektoratit të Përgjithshëm, brenda datës 10 të muajit paraardhës.

9. Në rast se një subjekt inspektimi është programuar nga dy a më shumë inspektorate, Inspektorati i Përgjithshëm identifikon në sistemin “*e-Inspektimi*” inspektoratet qendrore dhe vendore që e kanë programuar. Inspektorati i Përgjithshëm cakton afatin kohor të përbashkët për fillimin e procedurës së inspektimit dhe njofton inspektoratet përkatëse. Afati kohor i përbashkët për fillimin e procedurës së inspektimit është i detyrueshëm për inspektoratet përgjegjëse.



10. Inspektorati i Përgjithshëm, në bashkëpunim me inspektoratet qendrore dhe vendore harton treguesit e programit vjetor dhe mujor të inspektimeve dhe i rishikon ato në mënyrë periodike në sistemin “e-Inspektimi”.

11. Inspektoratet qendrore dhe vendore kryejnë edhe inspektime jashtë programit të inspektimit, por në përputhje me ligjin për inspektimin.

12. Numri i inspektimeve të kryera jashtë programit nuk duhet të kalojë masën 25% të numrit të inspektimeve, të përcaktuar në programin vjetor të inspektimit, me synim uljen e kësaj mase nga viti në vit. Në rastet kur rrethanat kërkojnë tejkalimin e këtij numri, merret miratimi i Inspektorit të Përgjithshëm.

13. Inspektorati qendror apo vendor përfshihet në veprimtari inspektuese në kuadër të strukturave të posaçme dhe të përkohshme me funksione të caktuara inspektimi task-force, të krijuara nga Këshilli i Ministrave, të cilat janë pjesë e inspektimeve jashtë programit të inspektimit. Në çdo rast të pjesëmarrjes në task-forcë, procedura e inspektimit kryhen nga trupat e inspektorateve qendrore dhe vendore, sipas dispozitave të ligjit për inspektimin.

14. Inspektorati i Përgjithshëm përshtat metodologjinë e programimit vjetor të veprimtarisë së inspektimit për inspektoratet qendrore dhe vendore për inspektimet e programuara dhe inspektimet jashtë programit, duke respektuar parimin e programimit vjetor të veprimtarisë së inspektimit, në përputhje me metodologjinë e riskut sipas fushëveprimit të çdo inspektorati qendror dhe vendor.

15. Numri i inspektimeve të planifikuara në programin vjetor të inspektimit përcaktohet nga inspektoratet qendrore dhe vendore, në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të riskut dhe duke marrë në konsideratë:

- a) numrin e subjekteve të identifikuar në fushën përkatëse të inspektimit;
- b) kategorizimin e tyre sipas nivelit të riskut;
- c) detyrimet ligjore për kryerjen e inspektimeve periodike;
- ç) kapacitetet organizative dhe numrin e trupës inspektuese.

16. Numri i përgjithshëm i inspektimeve të planifikuara në programin vjetor përbën bazën për hartimin e programeve mujore të inspektimit dhe

duhet të sigurojë prioritet për subjektet me risk të lartë.

17. Inspektorati i Përgjithshëm mbikëqyr përputhshmërinë e këtij programimi me metodologjinë e vlerësimit të riskut dhe me kërkesat e legjislacionit në fuqi për inspektimin.

V. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË RISKUT PËR PROGRAMIMIN E VEPRIM-TARISË INSPEKTUESE

1. Vlerësimi i riskut në veprimtarinë inspektuese është një procedurë sistematike dhe e vazhdueshme e inspektorateve qendrore dhe vendore, e cila ka për qëllim shqyrtimin, identifikimin, përcaktimin dhe kategorizimin e sektorëve, subjekteve dhe objekteve të inspektimit në bazë të riskut që ato prodhojnë ndaj interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë.

2. Metodologjia e vlerësimit të riskut hartohet nga inspektoratet dhe miratohet nga ministri përgjegjës për inspektoratet qendrore dhe nga njësia e vetëqeverisjes vendore për inspektoratet vendore.

3. Inspektoratet qendrore dhe vendore mbledhin informacion mbi riskun e përgjithshëm sipas fushës së veprimit të tyre, të përbërë nga:

- a) sektorët e inspektimit në fushën e veprimtarisë së tyre;
- b) subjektet e inspektimit të identifikuar nga çdo inspektorat;
- c) objektet e inspektimit për çdo fushë inspektimi.

4. Inspektorati i Përgjithshëm, në bazë të informacionit të mbledhur rreth subjekteve të inspektimit, kategorizon këto subjekte për renditjen e tyre sipas vlerësimit të riskut, të shprehur nëpërmjet treguesve individualë të riskut.

VI. FAKTORËT E RISKUT PËR VLERËSIMIN E SUBJEKTEVE TË INSPEKTIMIT

1. Ministri përgjegjës miraton treguesit dhe faktorët e riskut të sektorëve, subjekteve dhe objekteve të inspektimit, të hartuar nga inspektorati qendror përkatës, në bashkëpunim me ekspertë të fushës së inspektimit, si dhe duke marrë si standard praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

2. Faktorët e riskut ndahen në faktorë risku të lidhur me gjasat për papërputhshmëri dhe në



faktorë risku të lidhur me efektin e papërputhshmërisë.

3. Gjasat për papërputhshmëri lidhen me historikun e përputhshmërisë dhe shprehin tendencën e sektorëve dhe subjekteve të inspektimit ndaj interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë.

4. Efekti i papërputhshmërisë lidhet me dëmin dhe lëndimin që do të shkaktohej në rast papërputhshmërie dhe shpreh ndikimin e sektorëve, subjekteve dhe objekteve të inspektimit ndaj interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë.

5. Faktorët e riskut të lidhur me gjasat për papërputhshmëri përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, në bazë të ndryshimeve të kërkesave ligjore për t'u respektuar nga sektorët, subjektet dhe objektet e inspektimit, si dhe tendencës që shfaqet për papërputhshmëri me to nga subjektet e inspektimit, pas çdo inspektimi të kryer.

6. Faktorët e riskut të lidhur me efektin e papërputhshmërisë përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, në bazë të evidencave të reja mbi ndikimin e sektorëve dhe subjekteve ndaj interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë.

7. Treguesit e faktorëve të riskut shprehin në mënyrë sasiore dhe/ose cilësore peshën e riskut brenda të njëjtit faktor të riskut dhe ndërmjet faktorëve të ndryshëm të riskut.

8. Treguesit e faktorëve të riskut mblidhen në një shumatore të përgjithshme për të gjithë faktorët e riskut.

9. Peshat specifike e treguesve të faktorëve të riskut përditësohet në bazë të historikut të inspektimeve të sektorëve, subjekteve dhe objekteve të inspektimit.

VII. PËRCAKTIMI I RISKUT TË PËRGJITHSHËM PËR VLERËSIMIN E SUBJEKTEVE TË INSPEKTIMIT

1. Risku i përgjithshëm i efektit për papërputhshmëri për çdo subjekt inspektimi përbëhet nga tre treguesit e mëposhtëm:

a) Treguesit (vlerat) e faktorëve të riskut të lidhur me gjasat për papërputhshmëri dhe efektin e papërputhshmërisë së sektorëve të inspektimit mblidhen në një shumatore të përgjithshme, duke përcaktuar vlerën e treguesit të përgjithshëm të riskut për çdo sektor inspektimi (Risku i sektorit).

b) Treguesit (vlerat) e faktorëve të riskut të lidhur me efektin e papërputhshmërisë së objekteve të inspektimit mblidhen në një shumatore të përgjithshme, duke përcaktuar vlerën e treguesit të përgjithshëm të riskut për çdo objekt inspektimi (Risku i objekteve).

c) Treguesit (vlerat) e faktorëve të riskut të lidhur me gjasat për papërputhshmëri të subjekteve të inspektimit mblidhen në një shumatore të përgjithshme, duke përcaktuar vlerën e treguesit të përgjithshëm të riskut për gjasat për papërputhshmëri për çdo subjekt inspektimi (Risku i gjasave për papërputhshmëri).

2. Treguesit (vlerat) e faktorëve të efektit për papërputhshmëri të subjekteve të inspektimit, risku i sektorit (vlera sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij kreu) dhe risku i objektit (vlera sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij kreu me të cilin/cilët subjekti i inspektimit është i lidhur, mblidhen në një shumatore të përgjithshme, duke përcaktuar vlerën e treguesit të përgjithshëm të riskut për efektin e papërputhshmërisë për çdo subjekt inspektimi (Risku i efektit të papërputhshmërisë).

VIII. VLERËSIMI I RISKUT NË VEPRIMTARINË INSPEKTUESE

1. Matrica e vlerësimit të riskut është sipas aneksit I, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Inspektoratet qendrore dhe vendore, në bashkëpunim me ekspertë të fushës së tyre të inspektimit dhe duke marrë si standard praktikat më të mira kombëtare e ndërkombëtare, përcaktojnë pesë intervale klasifikimi të vlerave të treguesve të përgjithshëm të riskut të gjasave për papërputhshmëri dhe riskut të efektit për papërputhshmëri, për t'iu përshtatur vlerave përkatëse të riskut të matricës së vlerësimit të riskut.

3. Inspektoratet qendrore dhe vendore përditësojnë dhe publikojnë në faqen e tyre zyrtare faktorët e gjasave për papërputhshmëri dhe faktorët e efektit për papërputhshmëri, peshën dhe treguesit e tyre, në mënyrë që subjektet e inspektimit të ndërgjegjësohen dhe të pozicionohen qartë për ndikimin e tyre ndaj interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë, si dhe për tendencën që duhet të kenë në respektimin e kërkesave ligjore.



4. Inspektoratet qendrore dhe vendore përcaktojnë koeficientët e riskut për fushën e inspektimit në matricën e vlerësimit të riskut në mënyrë periodike në varësi të specifikave të inspektoratit përkatës dhe ndryshimit të kërkesave ligjore, që prodhohen nga të dhënat e inspektimeve për të propozuar ndryshime apo shtim të koeficientëve ekzistues.

IX. PERIUDHA MAKSIMALE E LEJUAR E INSEKTIMEVE VJETORE PËR ÇDO KATEGORI TË SUBJEKTEVE TË INSEKTIMIT

1. Programimi i inspektimeve mbështetet edhe në periudhën maksimale të lejuar të qëndrimit në subjektin e inspektimit.

2. Periudha maksimale e lejuar e inspektimeve vjetore për çdo kategori të subjekteve të inspektimit për veprimtarinë e të gjitha inspektorateve qendrore përcaktohet në varësi të:

a) madhësisë së subjektit të inspektimit, sipas specifikës së fushës së inspektimit;

b) rrezikut të veprimtarisë që kryen subjekti i inspektimit.

3. Në përcaktimin e periudhës së inspektimit, inspektorati qendror përgjegjës duhet të parashikojë të gjithë faktorët që mundësojnë funksionimin e subjektit, i cili do të inspektohet, si dhe çdo element që bën të mundur ushtrimin e aktivitetit, si:

a) kategorinë tatimore ku bën pjesë subjekti i inspektimit, sipas kategorizimit që përcakton ligji për procedurat tatimore (xhiron vjetore);

b) llojin e licencës për ushtrim veprimtarie në fushën përkatëse (kategorizime sipas QKB-së);

c) sasinë e prodhimit ose të produkteve që hedh në treg (në rast shoqërie import-eksport) dhe ndikimin që ka kjo sasi në tregun e konsumit;

ç) karakteristikat specifike të aktivitetit të subjektit të inspektimit;

d) rrezikshmërinë që mund të vijë nga ushtrimi i aktivitetit të atij subjekti.

4. Periudha maksimale e lejuar e inspektimit vjetor është 5 (pesë) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë maksimalisht, në varësi të karakteristikave të përcaktuara në pikat 2 dhe 3, të këtij kreu.

5. Inspektorati qendror përgjegjës për programimin e inspektimit përcakton kohën e qëndrimit në subjekt, në varësi edhe të përcaktimeve ligjore për periodicitetin e vizitave inspektuese në subjekt, si dhe kohëzgjatjen e një

procedure inspektuese në subjekt për programimin e inspektimeve pranë subjektit të inspektimit, mbështetur në kriteret e parashikuara në pikat 2 dhe 3, të këtij kreu.

6. Periudha maksimale e lejuar e inspektimit vjetor, e ndarë sipas kategorive të subjekteve të inspektimit, të jetë, si më poshtë vijon:

a) Për subjektin e inspektimit, që, sipas kriterëve të parashikuara në pikat 2 dhe 3, të këtij kreu, është përcaktuar kategoria shumë e lartë mbi praktikatat normale të konstatuara në vazhdimësi, kohëzgjatja kohore e inspektimit të jetë nga 13 (trembëdhjetë) ditë deri në afatin maksimal prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.

b) Për subjektin e inspektimit, që, sipas kriterëve të parashikuara në pikat 2 dhe 3, të këtij kreu, është përcaktuar kategoria e lartë mbi praktikatat normale të konstatuara në vazhdimësi, kohëzgjatja kohore e inspektimit të jetë nga 9 (nëntë) ditë deri në afatin maksimal prej 12 (dymbëdhjetë) ditësh.

c) Për subjektin e inspektimit, që, sipas kriterëve të parashikuara në pikat 2 dhe 3, të këtij kreu, është përcaktuar kategoria e mesme mbi praktikatat normale të konstatuara në vazhdimësi, kohëzgjatja kohore e inspektimit të jetë 7 (shtatë) ditë deri në afatin maksimal prej 8 (tetë) ditësh.

ç) Për subjektin e inspektimit, që, sipas kriterëve të parashikuara në pikat 2 dhe 3, të këtij kreu, është përcaktuar kategoria e ulët mbi praktikatat normale të konstatuara në vazhdimësi, kohëzgjatja kohore e inspektimit të jetë në afatin maksimal prej 6 (gjashtë) ditësh.

7. Inspektoratet qendrore përcaktojnë kohëzgjatjen e qëndrimit në subjektet e inspektimit, sipas kategorive të tyre, në bazë të përcaktimeve të pikës 6, të këtij kreu.

X. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Rregullat dhe procedurat e përcaktuara në këtë vendim do të zbatohen pas funksionimit të sistemit “e-Inspektimi”, të përmirësuar.

2. Ngarkohen ministritë përgjegjëse, Inspektorati i Përgjithshëm, inspektoratet qendrore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe inspektoratet vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



ANEKSI I

VLERËSIMI I RISKUT TË SUBJEKTEVE TË INSPEKTIMIT

I. MATRICA E VLERËSIMI TË RISKUT

1. Vlerësimi i riskut në modulën e vlerësimit të riskut në sistemin elektronik të inspektimeve kryhet në bazë të matricës së vlerësimit të riskut, e cila kategorizon subjektet e inspektimit sipas sistemit të pikëzimit, më poshtë:

Efekti i papërputhshmërisë	Gjasat për papërputhshmëri					
	+	1	2	3	4	5
	5	6	7	8	9	10
	4	5	6	7	8	9
	3	4	5	6	7	8
	2	3	4	5	6	7
	1	2	3	4	5	6

1. Kategoria e riskut përcaktohet nga vlera e riskut të përgjithshëm të subjektit të inspektimit që përfshin numrat e plotë në intervalin 2-10.

2. Vlera e riskut të përgjithshëm përcaktohet nga shuma e vlerës së riskut të gjasave për papërputhshmëri dhe vlerës së Riskut të Efektit të Papërputhshmërisë.

3. Vlera e riskut të gjasave për papërputhshmëri përfshin numrat e plotë në intervalin 1-5.

4. Vlera e riskut të efektit për papërputhshmëri përfshin numrat e plotë në intervalin 1-5.

5. Në kuptimin e kësaj matrice, risku i përgjithshëm, risku i gjasave për papërputhshmëri dhe risku i efektit për papërputhshmëri rriten në varësi të rritjes së vlerës numerike, sipas:

- 2-3, i ulët;
- 4-5, i moderuar;
- 6-7, i mesëm;
- 8-9, i lartë;
- 10, ekstrem.



VENDIM

Nr. 172, datë 19.3.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 457, DATË 3.7.2019, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
PROCEDURAVE PËR PJESËMARRJE NË
QENDRËN E TRAJNIMEVE NË
FUSHËN E PRONËSISË INDUSTRIALE,
SI DHE PËRCAKTIMIN E TARIFAVE
PËRKATËSE DHE MASËN E
SHPËRBLIMIT TË LEKTORËVE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 193/d, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 457, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave për pjesëmarrje në Qendrën e Trajnimeve në Fushën e Pronësisë Industriale, si dhe përcaktimin e tarifave përkatëse dhe masën e shpërblimit të lektorëve”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 9 shfuqizohet.

2. Shkronja “b”, e pikës 13, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Trajnime *online*”.

3. Shkronja “a”, e pikës 18/1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë/orë 60-minutëshe trajnimi, për kontratat me lektorët, të cilët do të përmbushin kriteret e mëposhtme:”.

II. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, mbulohen nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.

III. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 173, datë 19.3.2026

**PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË
DHËNAVE SHTETËRORE TË
SISTEMIT TË PROVIMIT TË SHTETIT
DHE PROVIMEVE TË TJERA TË
DIGJITALIZUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Provimit të Shtetit dhe provimeve të tjera të digjitalizuara.

2. Institucioni administrues i bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Provimit të Shtetit dhe provimeve të tjera të digjitalizuara është Qendra e Shërbimeve Arsimore.

3. Të dhënat e kësaj baze ndahen në të dhëna parësore dhe në të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhënat parësore të sistemit konsiderohen të dhënat e mbledhura nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, që kanë të bëjnë me:

i. rezultatet e provimeve të shtetit dhe të provimeve të tjera të digjitalizuara, si dhe përgjigjet e dhëna nga kandidatët për çdo profesion/profil;

ii. fondet e pyetjeve dhe testet e provimeve të shtetit e të provimeve të tjera të digjitalizuara;

iii. të dhënat për praktikën profesionale dhe për licencat për ushtrimin e profesioneve të rregulluara;

iv. të dhënat mbi vlerësimin e dosjeve të kandidatëve për provimet e shtetit e të provimeve të tjera të digjitalizuara.

b) Të dhënat dytësore të sistemit konsiderohen të dhënat që merren nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, Regjistri Elektronik Kombëtar për të Huajt në Republikën e Shqipërisë, portali unik qeveritar *e-Albania* dhe Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL), si më poshtë vijon:

i. Emri, atësia, amësia, mbiemri;

ii. Numri i identifikimit personal;

iii. Datëlindja, gjinia, vendlindja;

iv. Statusi civil;



- v. Adresa e vendbanimit;
- vi. Shtetësia;
- vii. Të dhënat e kontaktit të aplikuesit;
- viii. Të dhënat personale të studentëve të huaj.
- 4. Dhënës të informacionit për sistemin janë:
 - a) Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA);
 - b) Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP);
 - c) Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP);
 - ç) drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP);
 - d) zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP);
 - dh) urdhrat profesionalë të profesioneve të rregulluara;
 - e) kandidatët për provim;
 - ë) institucionet publike dhe jopublike, që zhvillojnë provime të tjera të digjitalizuara pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
- 5. Sistemi i Provimit të Shtetit ndërvepron me:
 - a) bazën e të dhënave shtetërore të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile;
 - b) Sistemin e Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë;
 - c) Regjistrin Elektronik Kombëtar për të Huajt në Republikën e Shqipërisë;
 - ç) portalin unik qeveritar *e-Albania*.
- 6. Institucioni administrues i bazës së të dhënave siguron përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Institucioni administrues mbledh vetëm të dhënat personale të domosdoshme për realizimin e qëllimit të bazës së të dhënave dhe provimeve.
- 7. Të dhënat personale të transmetuara duhet të ruhen për aq kohë sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin janë grumbulluar. Pas përfundimit të këtij afati, të dhënat fshihen ose anonimizohen sipas procedurave të institucionit administrues.
- 8. Niveli i aksesimit të lejuar për përdoruesit e Sistemit të Provimit të Shtetit dhe provimeve të tjera të digjitalizuara bazohet në rolet e krijuara të përdoruesve dhe përcaktohet, si më poshtë vijon:
 - a) Qendra e Shërbimeve Arsimore:
 - i. menaxher përdoruesi sistemi, për:
 - i/1. krijimin e përdoruesve;
 - i/2. caktimin e roleve dhe të të drejtave të tyre;

- i/3. kontrollin e veprimtarisë së përdoruesve, si hedhës e gjenerues i të dhënave.
- ii. Administrator sistemi për:
 - ii/1. krijimin e sezonit të provimit;
 - ii/2. krijimin e strukturave të provimeve;
 - ii/3. ngarkimin e fondit të pyetjeve;
 - ii/4. krijimin e seancave për provime të përgatitura nga komisionet, si hedhës dhe gjenerues i të dhënave.
- iii. Administrator salle për renditjen e kandidatëve për provim, sipas listës emërore, si lexues e gjenerues i të dhënave;
- b) Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare:
 - i. menaxher aplikimesh, për:
 - i/1. verifikimin e dokumentacionit të aplikantit për provim shteti, si lexues;
 - i/2. përgatitjen e listës emërore të kandidatëve, e cila dërgohet pranë drejtorisë rajonale të arsimit parauniversitar përkatëse, si hedhës dhe gjenerues i të dhënave.
 - c) Urdhrat profesionalë/DRAP/institucionet publike dhe jopublike të interesuara, që zhvillojnë provime të tjera të digjitalizuara:
 - i. menaxher aplikimesh për:
 - i/1. verifikimin e dokumentacionit të aplikantit për provim shteti nga zyra vendore e arsimit parauniversitar vartës, si lexues;
 - i/2. përgatitjen e listës emërore të kandidatëve, e cila dërgohet edhe pranë QSHA-së në rrugë zyrtare, si hedhës dhe gjenerues i të dhënave.
- 9. Në bazë të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazën e të dhënave shtetërore”, rregulloret për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore përcaktohen nga institucioni administrues e miratohen nga titullari i tij.
- 10. Palët zbatojnë masat e duhura teknike dhe organizative për të siguruar një nivel sigurie të përshtatshëm ndaj rrezikut për çdo veprim në regjistrë lidhur me aksesin, ndryshimin, korrigjimin, përhapjen e të dhënave personale, me qëllim garantimin e gjurmueshmërisë, të konfidencialitetit e të integritetit, disponueshmërinë e qëndrueshmërinë e sistemeve dhe të shërbimeve të përpunimit.
- 11. Vendimi nr. 741, datë 3.12.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Provimit të Shtetit (SPSH)”, shfuqizohet.
- 12. Ngarkohen Ministria e Arsimit, ministritë sipas fushës së përgjegjësisë për profesionet e



rregulluara, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar, autoritetet kompetente të profesioneve të rregulluara dhe urdhrat profesionalë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 174, datë 19.3.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË
PROCEDURAVE, TË PERIODICITETIT,
TË METODOLOGJISË DHE TË
LLOJEVE TË MASAVE PËR
VLERËSIMIN E PËRMBUSHJES SË
KUSHTEVE DHE TË KRITEREVE TË
FUNKSIONIMIT TË INSTITUTEVE
DHE NJËSIVE TË VEÇANTA TË
KËRKIMIT SHKENCOR, TË CILAT
FINANCOHEN NGA FONDE PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 20, të ligjit nr. 109/2024, “Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton kriteret, procedurat, periodicitetin dhe metodologjinë e vlerësimit të përmbushjes së kushteve dhe të kriterëve të funksionimit të instituteve dhe njësive të veçanta të kërkimit shkencor, të cilat financohen nga fonde publike, si dhe llojet e masave në rast të mospërmbushjes së kushteve dhe të kriterëve të funksionimit.

2. Ky vendim zbatohet për të gjitha institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor, që janë krijuar në bazë të ligjit nr. 109/2024, “Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, dhe që financohen plotësisht ose pjesërisht nga fonde

publike apo sipas një marrëveshjeje të posaçme financimi.

3. Ky vendim zbatohet edhe për projektet e kërkimit të financuara nga programe të huaja, kur financimi kombëtar bashkëkontribuon në buxhet.

**II. KRITERET E VLERËSIMIT TË
PËRMBUSHJES SË KUSHTEVE DHE TË
KRITEREVE TË FUNKSIONIMIT TË
INSTITUTEVE DHE NJËSIVE TË VEÇANTA
TË KËRKIMIT SHKENCOR TË FINAN-
CUARA NGA FONDE PUBLIKE**

Kriteret e vlerësimit të përmbushjes së kushteve dhe të kriterëve të funksionimit të instituteve dhe njësive të veçanta të kërkimit shkencor, që kanë përfituar fonde publike, janë, si më poshtë vijon:

a) Vlerësimi institucional mbi funksionimin e strukturës së bordit shkencor dhe komitetit të etikës së bashku me rregulloren e tij;

b) Vlerësimi për menaxhimin financiar dhe kontrollin, në përputhje me ligjin nr. 9963, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

c) Vlerësimi për kapacitetet njerëzore dhe profesionale mbi numrin e punonjësve kërkimorë-shkencorë të instituteve dhe njësive të veçanta të kërkimit shkencor;

ç) Vlerësimi mbi përdorimin e fondeve publike, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për menaxhimin financiar e kontrollin;

d) Realizimi i vlerësimit të produktit kërkimor-shkencor mbi përdorimin e bazës së të dhënave dhe rezultatit shkencor, sipas standardeve dhe objektivave të përcaktuar në marrëveshjen e financimit dhe kontributit në fushën e politikave publike;

dh) Vlerësimi për zbatimin e rregullave të transparencës, të etikës, të parimeve të shkencës së hapur, të mbrojtjes së të dhënave personale gjatë realizimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore, sipas legjislacionit në fuqi.

**III. PROCEDURA E VLERËSIMIT TË
PËRMBUSHJES SË KUSHTEVE DHE TË
KRITEREVE TË FUNKSIONIMIT TË
INSTITUTEVE DHE NJËSIVE TË VEÇANTA
TË KËRKIMIT SHKENCOR TË FINAN-
CUARA NGA FONDE PUBLIKE**

1. Vlerësimi i përmbushjes së kushteve dhe kriterëve të funksionimit të instituteve dhe njësive të veçanta të kërkimit shkencor të financuara nga fonde publike realizohet nga ministria përgjegjëse



për çështjet e shkencës dhe kërkimit shkencor, sipas procedurës së ndarë në fazat e mëposhtme:

a) Faza e përgatitjes, e cila përfshin hartimin e planit vjetor të vlerësimeve nga ministria përgjegjëse për kërkimin shkencor, ngritjen e grupit të punës për vlerësim dhe njoftimin e instituteve dhe njësive të veçanta të kërkimit shkencor me shkrim 30 (tridhjetë) ditë para fillimit të vlerësimit. Pas njoftimit, instituti dhe njësia e veçantë e kërkimit shkencor, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit, paraqet:

- i. raportin vjetor teknik;
- ii. raportin financiar;
- iii. raportin e vetëvlerësimit;
- iv. dokumentet e kontrollit të brendshëm.

b) Faza e verifikimit, gjatë së cilës grupi i punës i ngritur për vlerësimin, brenda 20 (njëzet) ditëve nga marrja e dokumentacionit, realizon detyrat, si më poshtë:

- i. Analizën dokumentare;
- ii. Intervistën me drejtues dhe staf;
- iii. Verifikimet fizike (laboratorë, pajisje, aktivitete);
- iv. Auditimin e procedurave financiare dhe të prokurimit;
- v. Krahasimet ndër-institucionale (*benchmarking*).

c) Faza e analizës dhe e vlerësimit, gjatë të cilës grupi i punës i ngritur për vlerësim, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i fazës së dytë, përgatit matricën e vlerësimit, sipas kriterëve, të cilat pikëzohen nga 1–5. Pësia e kriterëve caktohet, si më poshtë:

- i. 40% - performanca shkencore;
- ii. 30% - performanca financiare;
- iii. 20% - kapacitetet institucionale;
- iv. 10% - transparenca dhe etika.

2. Grupi i punës i ngritur harton projektraportin e vlerësimit brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga fillimi i procedurës. Projektraporti i dërgohet institutit apo njësisë së veçantë të kërkimit shkencor për observime brenda 10 ditëve nga marrja e projektraportit. Raporti final publikohet me përjashtim të të dhënave konfidenciale.

IV. METODOLOGJIA PËR VLERËSIMIN E PËRMBUSHJES SË KUSHTEVE DHE TË KRITEREVE TË FUNKSIONIMIT TË INSTITUTEVE DHE NJËSIVE TË VEÇANTA TË KËRKIMIT SHKENCOR, QË FINANCOHEN NGA FONDE PUBLIKE

Metodologjia për kryerjen e këtij vlerësimi bazohet në instrumentet e mëposhtme:

a) Indikatorët metodologjikë:

- i. analizë statistikore;
- ii. analizë cilësore;
- iii. analizë krahasuese (*benchmarking*);
- iv. analizë e riskut;
- v. verifikim fizik;
- vi. raporte të auditimit të brendshëm e të jashtëm.

b) Indikatorët shkencorë:

- i. numri i botimeve, sipas kategorisë;
- ii. faktorët e ndikimit;
- iii. patentat;
- iv. projektet ndërkombëtare;
- v. nivelet e *technology readiness level*.

c) Indikatorët financiarë:

- i. përdorimi i buxhetit;
- ii. shmangiet nga plani i prokurimit;
- iii. rekomandimet e auditimeve;
- iv. përqindja e kostove joproduktive.

ç) Indikatorët institucionalë:

- i. funksionimi i organeve drejtuese;
- ii. rregulloret e brendshme;
- iii. procedurat e zbatimit të akteve.

d) Indikatorët e transparencës e të etikës:

- i. publikimet në faqet zyrtare;
- ii. raportimet periodike;
- iii. ankesat dhe trajtimi i tyre.

V. PERIODICITETI PËR VLERËSIMIN E PËRMBUSHJES SË KUSHTEVE DHE TË KRITEREVE TË FUNKSIONIMIT TË INSTITUTEVE DHE NJËSIVE TË VEÇANTA TË KËRKIMIT SHKENCOR, QË FINANCOHEN NGA FONDE PUBLIKE

1. Ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës e të kërkimit shkencor kryen vlerësimin e përmbushjes së kushteve dhe të kriterëve të funksionimit të instituteve dhe njësive të veçanta të kërkimit shkencor të financuara nga fonde publike të paktën një herë në çdo dy vjet për çdo projekt të financuar nga fonde publike dhe në përfundim të tij. Në rast se, sipas marrëveshjes së financimit, kjo kohëzgjatje është më pak se dy vjet, realizohet në përfundim të projektit.

2. Për projektet e kërkimit të financuara nga programe të huaja, kur financimi kombëtar bashkëkontributon në buxhet, kryerja e vlerësimit të përmbushjes së kushteve dhe të kriterëve të funksionimit të instituteve dhe të njësive të veçanta të kërkimit shkencor të financuara nga fonde



publike realizohet nga ministria përgjegjëse për shkencën dhe kërkimin shkencor për fondet e dhëna nga buxheti i shtetit, sipas kohëzgjatjes së përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu.

VI. LLOJET E MASAVE PËR VLERËSIMIN E INSTITUTEVE DHE TË NJËSIVE TË VEÇANTA TË KËRKIMIT SHKENCOR, QË FINANCOHEN NGA FONDE PUBLIKE

1. Ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës e të kërkimit shkencor, bazuar në raportin e vlerësimit, merr masa për institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor, sipas shkeljeve të konstatuara.

2. Shkeljet klasifikohen, si më poshtë:

a) Shkelje shumë të rënda, kur konstatohen shkelje e një apo më shumë prej kriterëve institucionale; merret masa e mosfinancimit nga fonde publike të asnjë projekti për një periudhë deri në 10 (dhjetë) vjet dhe ndërprerje e plotë ose e pjesshme e fondeve publike, nëse projekti nuk ka përfunduar;

b) Shkelje të rënda, kur konstatohet shkelje e një apo më shumë prej kriterëve të vlerësimit shkencor/produktit kërkimor-shkencor; merret masa e pezullimit të projektit deri në përmbushjen e kriterëve të paplotësuar;

c) shkelje të lehta, kur konstatohet mospërmbushje e kriterëve të etikës e të transparencës; merret masa e vendosjes së afateve të detyrueshme për përmbushjen e shkeljeve të konstatuara.

VII. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Rregullat teknike, në varësi të fushës së veprimtarisë kërkimore-shkencore, për monitorimin dhe vlerësimin e përmbushjes së kushteve dhe të kriterëve të funksionimit të instituteve dhe të njësive të veçanta të kërkimit shkencor të financuara nga fonde publike, përcaktohen në marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe, që lidhen ndërmjet institucioneve financuese dhe atyre përfituese, në përputhje me legjislacionin për kontrollin e menaxhimit financiar.

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor, institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 175, datë 19.3.2026

PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIZIMIT NË PAGË DHE SHPËRBLIMIT PËR PUNËN NË BAZË TË CILËSISË E TË RËNDËSISË SË REZULTATEVE TË KËRKIMIT SHKENCOR TË PERSONELIT TË INSTITUTEVE DHE TË NJËSIVE TË VEÇANTA TË KËRKIMIT SHKENCOR PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 23, të ligjit nr. 109/2024, “Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen punonjësit kërkimorë-shkencorë dhe punonjësit ndihmësteknikë dhe administrativë të instituteve dhe të njësive të veçanta të kërkimit shkencor publik.

2. Elementet përbërëse të pagës bruto mujore të punonjësve kërkimorë-shkencorë janë, si më poshtë vijon:

a) Paga për pozicion/kategori, që përcaktohet në lidhjet nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij. Për pozicionet drejtues i institutit ose drejtues i njësive të veçantë të kërkimit shkencor publik, paga është në përputhje me kategorinë, që zotëron punonjësi kërkimor-shkencor.

b) Shtesa për vjetërsi, në masën 1 (një) për qind, për çdo vit pune, por jo më shumë se për 25 (njëzet e pesë) vjet.

3. Klasat e pagave për punonjësit administrativë janë sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Elementet përbërëse të pagës bruto mujore të secilës klasë page (paga për pozicion, shtesa për vjetërsi në punë dhe shtesa e nivelit të kualifikimit) dhe vlerat e çdo elementi janë sipas përcaktimeve të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë të institucioneve të administratës shtetërore.



4. Klasat e pagave për punonjësit ndihmësteknikë janë sipas lidhjes nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Elementet përbërëse të pagës bruto mujore të secilës klasë page (paga për pozicion dhe shtesa për vjetërsi në punë) dhe vlerat e çdo elementi janë sipas përcaktimeve të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike.

5. Shpërblimi për punën kërkimore-shkencore jepet nga të ardhurat e siguruar nga veprimtaria e institutit ose njësisë së veçantë të kërkimit shkencor publik, deri në kufirin 20 për qind të nivelit të pagës minimale, për kategoritë e personelit kërkimor-shkencor. Shpërblimi jepet me vendim të drejtuesit të institutit ose njësisë së veçantë të kërkimit shkencor publik, bazuar në pikëzimin për kriteret e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore, të përcaktuara

me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e shkencës dhe kërkimit shkencor, sipas nenit 29, të ligjit nr. 109/2024.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet grant të miratuara në buxhetin e shtetit për institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor publik, fondet publike për kërkimin shkencor, si dhe nga të ardhurat e krijuara nga veprimtaria e tyre.

7. Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe kërkimit shkencor, institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LIDHJA NR. 1

VLERA E PAGËS PËR POZICION/KATEGORI PËR PUNONJËSIT KËRKIMORË-SHKENCORË

Pozicioni/kategoria	Vlera lekë/muaj
Drejtues kërkimor-shkencor	185 000
Kërkues shkencor i avancuar	170 000
Kërkues shkencor	137 000
Asistent kërkues-shkencor	105 000

LIDHJA NR. 2

VLERA E PAGËS PËR POZICION/KATEGORI PËR DREJTUESIT E INSTITUTIT DHE DREJTUESIT E NJËSISË SË VEÇANTË TË KËRKIMIT SHKENCOR PUBLIK

Titullari sipas institucionit dhe kategorisë	Vlera lekë/muaj
Drejtuesi institutit i kategorisë “Drejtues kërkimor-shkencor”	220 000
Drejtuesi institutit i kategorisë “Kërkues shkencor i avancuar”	204 000
Drejtuesi njësisë së veçantë të kërkimit shkencor i kategorisë “Drejtues kërkimor-shkencor”	203 500
Drejtuesi njësisë së veçantë të kërkimit shkencor i kategorisë “Kërkues shkencor i avancuar”	187 000
Drejtuesi njësisë së veçantë të kërkimit shkencor i kategorisë i “Kërkues shkencor”	150 700

LIDHJA NR. 3

KLASAT E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ADMINISTRATIVË

Pozicioni	Klasa e pagës
Drejtor drejtorie	II-2
Përgjegjës sektori	III-3
Specialist	IV-2

LIDHJA NR. 4
KLASAT E PAGAVE PËR PUNONJËSIT NDIHMËS TEKNIKË

Pozicioni	Klasa e pagës
Sekretar titullari	VII
Laborant	VI
Arkivist-protokollist	VI
Magaznier	V
Operator	IV
Shofer	III
Punëtor mirëmbajtjeje	III
Sanitar	I

VENDIM**Nr. 185, datë 19.3.2026****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 526, DATË 29.7.2022,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E AGJENCISË PËR DIALOG DHE
BASHKËQEVERISJE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të pikave 2 e 7, të nenit 14, të ligjit nr. 107/2021, “Për bashkëqeverisjen”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 526, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje”, bëhen këto ndryshime:

1. Në kreun I bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 3, fjalët “...”, si dhe të realizojë, të nxisë dhe të mbështesë nismat për një shoqëri të hapur dhe për institucione më pranë qytetarëve dhe shoqërisë civile” hiqen.

b) Shkronja “b”, e pikës 4, shfuqizohet.

2. Shkronja “b”, e kreut II, shfuqizohet.

3. Në kreun III bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në fjalinë e dytë të pikës 1, fjala “... janë ...” zëvendësohet me “... është ...”, ndërsa fjalët “... dhe “COD”” hiqen.

b) Në pikën 7 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

i. Shkronjat “dh”, “e”, “g”, “gj”, “h” dhe “i” shfuqizohen;

ii. Në shkronjën “o”, fjalët “... veprimtarinë dhe aktivitetet e COD-it” hiqen.

c) Pika 8 shfuqizohet.

4. Në logon zyrtare bashkëlidhur vendimit, të përmendur në pikën 10 të tij, hiqet logoja e COD-it.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama**UDHËZIM I PËRBASHKËT****Nr. 36, datë 27.2.2026****PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE,
TRAJTIMIT, ADMINISTRIMIT DHE
SHPËRNDARJES SË TË DHËNAVE
PERSONALE TË MBLEDHURA
NGA POLICIA**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 38, pika 2, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, dhe ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ministri i Punëve të Brendshme dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

UDHËZOJNË:

Neni 1

Objekti

Ky udhëzim ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe procedurave për trajtimin, administrimin dhe shpërndarjen e të dhënave që



përpunohen nga strukturat e Policisë së Shtetit, për qëllime policore.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Rregullat e këtij udhëzimi aplikohen për proceset e përpunimit të të dhënave personale të kryera në mënyrë manuale dhe përmes sistemeve elektronike të Policisë së Shtetit, për kryerjen e procedurave policore.

2. Strukturat e Policisë së Shtetit do të zbatojnë parashikimet e këtij udhëzimi vetëm për sa u përket të dhënave personale që përpunohen për qëllime policore.

3. Të dhënat e tjera personale, që përpunohen rreth stafit ose për qëllime që nuk lidhen drejtpërdrejt me ato të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, zbatohen në përputhje me parashikimet e pjesës I dhe II të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim “ligji nr. 124/2024”).

Neni 3 Përkufizime

1. Në këtë udhëzim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Anonimizim” është procesi i përpunimit të të dhënave personale, duke përdorur një grup teknikash që e bëjnë të pamundur identifikimin e një personi me çfarëdo mjeti. Të dhëna do të konsiderohen të anonimizuara në mënyrë efektive nëse subjektet e të dhënave personale, nuk bëhen më të identifikueshëm.

b) “E dhënë personale” është çdo informacion në lidhje me një subjekt të dhënash.

c) “Përpunim” është çdo veprim ose një grup veprimesh, që kryhet mbi të dhënat personale ose grupe të dhënash personale, pavarësisht nëse kryhen me mjete të automatizuara ose jo, të tilla, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, përdorimi, përhapja me anë të transmetimit, shpërndarjes ose vënies në dispozicion në ndonjë mënyrë tjetër, lidhja ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose shkatërrimi.

ç) “Kontrollues” është personi fizik ose juridik dhe çdo autoritet publik, i cili, vetëm ose së bashku

me të tjerët, përcakton qëllimet e mjetet e përpunimit të të dhënave personale.

d) “Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale” është autoriteti mbikëqyrës i pavarur dhe përgjegjës për monitorimin e mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.

dh) “Subjekt i të dhënave” është çdo person fizik i identifikuar ose i identifikueshëm.

e) “Fshirja e të dhënave” është procesi i heqjes ose zhdukjes së të dhënave personale të ruajtura në sistemet/regjistrat e Policisë së Shtetit, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Terma të tjerë të përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me ato të nenit 3, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit” (në vijim “ligji nr. 82/2024”) dhe nenit 5, të ligjit nr. 124/2024.

Neni 4 Parimet e përpunimit

Përpunimi i të dhënave personale nga Policia e Shtetit kryhet në përputhje me parimet e përcaktuara në ligjin nr. 124/2024, duke garantuar respektimin e të drejtave të individit dhe qëllimin e ligjshëm të veprimtarisë policore.

Neni 5 Kategoritë e të dhënave personale të përpunuara gjatë veprimtarisë policore

Gjatë veprimtarisë policore, strukturat e Policisë së Shtetit përpunojnë të dhënat e përcaktuara në nenin 36, të ligjit nr. 82/2024, si dhe të dhëna personale të tjera të lidhura drejtpërdrejtë me ushtrimin e veprimtarisë, të kategorizuara si më poshtë:

1. Të dhëna identifikuese të cilat përfshijnë:
 - emër;
 - mbiemër;
 - datëlindje;
 - NID;
 - gjinia.
2. Të dhëna kontakti të cilat përfshijnë:
 - adresë;
 - e-mail;
 - nr. tel./cel. ose rrjete sociale
3. Të dhëna profesionale të cilat përfshijnë:



- CV;
- arsimi;
- punësimi.

4. Imazhe të cilat përfshijnë foto dhe video.

5. Të dhëna sensitive, të cilat përfshijnë:

- shëndetësore;
- biometrike;
- penale;
- origjinë racore, etnike, bindje politike, besim fetar, orientim seksual, anëtarësim në sindikatë.

6. Të dhëna financiare dhe pronat të cilat përfshijnë:

- nr. llogarie bankare;
 - prona të paluajtshme/luajtshme, në pronësi/përdorim;
 - aktivitete ekonomike brenda dhe jashtë vendit.
7. Hyrje-daljet nga territori shqiptar që përfshijnë:
- datë, orë;
 - profil i krijuar;
 - dokument udhëtimi;
 - të dhëna identifikuese me foto;
 - të dhëna të automjeteve.

8. Të dhëna mbi lidhjet miqësore/shoqërore me interes.

9. Të dhëna me interes për ambientet që frekuentohen që mund të përfshihen, por pa u kufizuar në bare, lokale, hotele, objekte kulti etj.

Neni 6

Të drejtat e subjekteve të të dhënave

Subjektet, të dhënat e të cilëve përpunohen nga Policia e Shtetit, gëzojnë të drejtat për informim, akses, korrigjim, fshirje ose kufizim të përpunimit, si dhe të drejtën për rishikimin e përgjigjes, sipas ligjit nr. 124/2024, me kufizime të lejuara vetëm në raste të përcaktuara qartë nga ky ligj.

Neni 7

Regjistrimi dhe detyrimi për të dokumentuar

1. Çdo veprim përpunimi i të dhënave personale, duhet të regjistrohet në një mënyrë të përshtatshme, duke garantuar se ligjshmëria e përpunimit mund të monitorohet dhe të verifikohet, sipas kriterëve të parashikuara në nenin 62, të ligjit nr. 124/2024.

2. Të dhënat e regjistrimit, duhet të bëjnë të mundur përcaktimin e arsyes, të datës e të kohës së këtyre veprimeve dhe, për aq sa është e mundur,

identifikimin e personit që ka konsultuar ose përhapur të dhënat personale, si dhe identitetin e çdo marrësi të këtyre të dhënave personale.

3. Strukturat e Policisë së Shtetit duhet të administrojnë dokumentacionin përkatës që përmban të dhëna personale, me qëllim dokumentimin e veprimtarive të përpunimit, në përputhje me nenin 61, të ligjit nr. 124/2024.

4. Policia e Shtetit për regjistrimin dhe dokumentimin e të dhënave personale përdor sisteme elektronike dhe dokumente apo regjistra zyrtarë.

Neni 8

Masat e sigurisë

1. Në çdo rast, strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit përdorin sisteme të sigurta elektronike për regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave.

2. Sistemet garantojnë auditimin dhe gjurmueshmërinë lidhur me veprimet e kryera ndaj të dhënave personale të përpunuara, sipas nenit 62, të ligjit nr. 124/2024.

3. Strukturat e Policisë së Shtetit komunikojnë nëpërmjet ndërveprimit të sistemeve shtetërore të certifikuara, me protokolle të dokumentuara në zbatim të qëllimit të veprimtarisë së tyre.

4. Policia e Shtetit merr masat organizative për caktimin e personave të autorizuar që kanë të drejtë të aksesojnë të dhënat, trajnimin e punonjësve për mbrojtjen e të dhënave dhe ruajtjen e konfidencialitetit, si dhe masat e sigurisë fizike lidhur me ambientin.

Neni 9

Mekanizmat konfidencialë të raportimit

1. Policia e Shtetit krijon dhe përdor mekanizma, apo kanale të sigurta dhe konfidenciale, që garantojnë raportimin e shkeljeve të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Mekanizmat e raportimit të përdorura nga Policia e Shtetit janë:

- a) *e-mail* i dedikuar me qasje të kufizuar;
- b) platformë *online* për përdorim të brendshëm, sipas aksesit të autorizuar;
- c) pajisje fizike të dedikuara të raportimit, të vendosura në ambientet e institucionit;
- ç) raportim verbal me mbajtje protokolli në zyrë të caktuar;



d) çdo formë tjetër raportimi që përmbush kërkesat e ligjit;

3. Në çdo rast të raportimit, Policia e Shtetit duhet të garantojë konfidencialitetin e identitetit të raportuesit dhe personave të përfshirë.

Neni 10

Konfidencialiteti i të dhënave

1. Të gjitha strukturat policore, personat dhe punonjësit që zbatojnë këtë udhëzim, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave të përpunuara gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, edhe pas përfundimit të funksionit.

Neni 11

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale

Transferimet e të dhënave personale nga ana e Policisë së Shtetit kryhen vetëm në zbatim legjislationit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 12

Bashkëpunimi me Komisionerin

1. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron respektimin e rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim të përbashkët.

2. Çdo shkelje e dispozitave të këtij udhëzimi duhet të raportohet dhe të trajtohet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 124/2024.

Neni 13

Dispozita përfundimtare

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shteti dhe strukturat e saj për zbatimin e këtij udhëzimi.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas publikimit të tij në Fletoren Zyrtare.

PËR MINISTRINË E PUNËVE
TË BRENDSHME

MINISTËR
Albana Koçiu

PËR KOMISIONERIN PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE
KOMISIONER
Besnik Dervishi

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 272 lekë

